


BIBLIOTEKA  
SHTETIT

84-32  
T 88

LUAN H. TOTO

novelë



**SEZAIU**

814-56

T 88.

## LUAN HYSNI TOTO

S

SEZAU

E

The... nate, i përzic me sqotën e hidhur të jetë bente më të mundimshme shpërndajjen nga... i struktur në këmbët e malit. Por... dhetë te vodje me cdo kusht. Ishiq urdheri i qeverisë, i cili... që... këmbët e prisanin më këmbë, si... këtë do t'i tuet... Martin.

Z

A

U

(NOVELË)



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»

## S E Z A I U

### I

Thëllimi i asaj nate, i përzier me sqotën e hidhur të dëborës, e bënte më të mundimshme shpërnguljen nga fshati i strukur në këmbët e malit. Por ai duhej të nisej me çdo kusht. Ishte urdhëri i qeverisë. Kapteri dhe xandarët e prisin më këmbë, sikur donin t'i merrnin shpirtin.

«Na daltë për të mirë!» — deshi të thoshte Sezaiu, kur doli njëherë e përgjithmonë nga dera e përdheses në sheshin e shtruar me rrasa guri. As ai vetë nuk e kuptci në foli apo nuk foli, kurse Mershja diçka dëgjoi, një si gurgullimë të mbytur përrroi që vinte nga larg, shumë larg. Ngriti kokën, kur pa të shoqin që thithë papushim tym nga bishti i cigares, u drodh e u tërroq pak mënjanë për ta mbytur ngashërimin me cepin e jashmakut të bardhë.

— Mos na ndill zi! — u hakërrua Sezaiu e për një farë kohe mbeti si i ngrirë, me krahët gjysmë të hapur e me këmbët të ngjeshura fort në truallin e gurtë të oborrit.

Ajo u tremb nga gjëmimi i atij zëri.

— Kemi rrugë të gjatë përpara. Koha është e keqe... — dhe përsëri nuk lëvizi nga vendi; kurse ajo shikonte me shqetësim se si i dridheshin atij shpatullat e rëna.

Tërroqi frerin e mushkës dhe iu afroa më shumë atij.

Ai hodhi bishtin e cigares.

— As rruga s'duket...

— Vetëm ti mos m'u pikëllo kaq shumë — iu lut ajo.

Të dy ia ngulën sytë errësirës së pafund.

Sqota vinte me valë suferine.

Ai printe në ballë.

Pas tij ajo terhiqte mushkën e ngarkuar.

Terë pasurinë e tyre ajo e kishte qepur në dy velenxa të dhirta dhe e kishte lidhur në të dyja anët e samarit. Midis dengjeve ishte formuar një si furrik i vogël e në atë furrik, mbështjellë me shark, që mbledhur kruspull vogëlushi i tyre, që sapo kishte mbushur të pesë vjetët.

Shtegu i rrëpirëtë e lurdhiq nga balta e dëbora rrëshqiste, ngadalë nën këmbët e tyre.

— Mbështille mirë djalin!

— Urdhëro?

— Djalin... Mbështille mirë!

— E mbështolla.

Ai ktheu kokën dhe psherëtiti thellë.

— Mos m'u zemëro.

— Jo, jo.

— Ashtu de — dhe u fut i pari në shtegun e përroit.

...Në të dalë të fshatit, te Lugu i Dëllënjës, Sezaiu ndaloi. U kthyte dhe hodhi sytë tej bokërrimës së fshatit. Matanë përroit napar e sqotës kishte mbështjellë në gjirin e saj të cingërimtë çatinë me rrasa guri. Vetëm në dritaret e kullës, mbi shkëmbin rrëzë malit, buriste një dritë e mekur. Atij iu drodhën mollëzat e kërcyera e nofullat iu shtrënguan si nofulla dare. Urrejtja iu mblodhi lëmsh drize aty nën gropëzën e kraharorit e pushka i rëndoi si mal mbi sup.

Kulla majë shkëmbit iu bë si koka e një lubie me sy të zjarrtë, kurse masa mavi e malit, që fryhej si një gungë vigane aty pas kraheve të kullës, i shembellente me trupin e asaj lubte.

- Ah! Mos bëfshi prokopi!
- Po shtrëngon moti.
- Kur s'e vraval!
- Nxitojmë, Sezo! Kemi tërë atë rrugë përtë bërë.
- S'më bëjnë këmbët.
- Do të na ftohet djali.
- Nuk ftohet, jo.
- Mirë, si të duash ti — dhe ajo futi të dyja duart nën sqetulla.

Nëpër Lugun e Dëllënjës rriddnin rrëke uji. Bashkë me rrëketë, mali shtynte tatëpjjetë shtëllunga të përhimta mjegulle.

Nga shtëllunga e mjegullës u shkëput një ulërimë. Jehona e saj u përzie me suferinë. Sqota e mbështolli në gjirin e rrëmbyer dhe e përplasi tutje në grykat e honest e maleve karshi.

— Bisha! — klithi Merushja.

Mushka turfulloj e shqetësuar.

Ai ndaloi.

Pérpara tij nata nxinte si një pus i mister-shëm.

— Është afër — tha ai. — Afrohu te mushka dhe mbaja fort frerin!

— Mos m'u largo!

— Më duket se këtej erdhi.

— Sezo!

— Kujdes! djalin!

Mushka turfulloj përsëri.

— Është shumë afër, po ti mos u tremb!

— Jo, nuk trembem, po ti mos u largo!

— MBA djalin!

— Bisha! — klithi Merushja dhe u mblodh si lëmsh pas frerit të mushkës.

Tyta e zezë e pushkës zbrazi një kurorë verbuese flake.

Ujku u përplas nga ledhi në udhë me një rënkim të mytur ngërçi.

— Mos iu afro, se mbasse s'ka ngordhur.

— Jo, moj, se ka ngordhur.

— Mirë, mirë, po ti mos iu afro!

— Dua të shikoj ku e ka marrë.

— Ç'të duhet ajo punë! Ikkim!

— Rri aty ti!

— Sezo!

Ai e trazoi ujkun me majën e opingës, pastaj e shtyu me tërë forcën e këmbës.

— Ptfu! Fat qeni!

— Si?

— Fat qeni! — thirri Sezaiu.

— Mos u mërzit. Këtë rrësk na e preu perëndia.

— M'i preu krahët, katili!

- Perëndia do të na e marrë hakun.
- Ah, kur s'e vrava!
- Korba, ku të vete mendja
- Ai qen duhej vrarë!
- Le ta vrasë kush të dojë.

Sezaiu u përkul mbi ujkun e vrarë dhe futi gishtë-rinjtë nën trupin e tij.

U ngrit.

Në dorë mbante qime e pelte gjaku.

Një e ngjethur i kaloi si një gjarpër i akullt midis shpatullave.

— Sikur po teret moti — tha Merushja. —

Mbase duhet të nisemi.

— Ai ngriti kokën lart.

Mbi ta suferina përcillte re të përhimta dë-bore dhe shtëllunga mjegulle.

— Ikim!

Hodhi pushkën, në krah dhe zbriti tatëpjetë Lugut të Dëllënjes.

Rrëketë e malit rridhni me gurgullimë pas hapave të tyre.

— Hodhi pushkën, në krah dhe zbriti tatëpjetë Lugut të Dëllënjes.

Rrëketë e malit rridhni me gurgullimë pas hapave të tyre.

— Hodhi pushkën, në krah dhe zbriti tatëpjetë Lugut të Dëllënjes.

Rrëketë e malit rridhni me gurgullimë pas hapave të tyre.

— Hodhi pushkën, në krah dhe zbriti tatëpjetë Lugut të Dëllënjes.

Rrëketë e malit rridhni me gurgullimë pas hapave të tyre.

Më mirë shtruar, Zaim aga!  
Kalamajtë pinë e kërcasin gishterinjtë.  
Eh, more kapler Vizhdani! E njoh unë të  
Zaim aga! Tashmë që duam që  
duam që duam që duam që

## II

### K U L L A

Zaim aga Çika e zbrazi me fund duçen e rakisë.

Përplasi me kënaqësi gjuhën për qiellze, fshiu me të prapën e doreë shtëllungat e lëshuara të mustaqeve dhe, si buzëqeshi me kënaqësi, shqeu shtresën e dhijamit nga brinja e qengjit të pjekur që i kishin vënë në një tepsi përpara.

Edhe miqtë pinin, po atij iu duk sikur vetëm sa i çonin në buzë duçet e rakisë, e sikur me turp i çukitnin copat e mishit të pjekur.

— Po pini, more miq, pini ca, se kjo flamë kohë, raki do!.. More djem! Ka, apo s'ka raki në këtë shtëpi?

— Erdhi, baba!

— Duan të pinë miqtë.

— Kemi plot përpara, Zaim aga.

Kalamajtë pinë e kërcasin gishterinjtë.

— Më mirë shtruar, Zaim aga.

— Eh, more kapler Vizhdani! E njoh unë të

pirët e të ngrënët e tu. Ma nxitë faqen, more djem! Fiqtë e ftonjtë i patëm mirë sivjet.

— Peqe, baba! — dhe doli edhe një cjalë tjetër.

— I kam ca të leshtë lanetërit. S'u punon rrabadja fare. Më mbeti fjala si hosten në dorë!

— Djemtë i ke si do vetë perëndia, Zaim aga — tha kapter Vizhdani dhe liroi nja dy bira nga rripi i mesit. — Rrofshin e t'u shtofshin! — dhe

ngriti duçen që mbante midis shalëve. — Jetë e shëndet u dhëntë perëndia!

— Më rruash e të paça më ndër, more zoti kapter!

— Shëndeti dhe nderi i qofshin Lartmadhërisë së tij!

Xhandarët e tjerë me duçet e rakisë në duar u ngriten më këmbë me rrëmbim dhe përfnjë çast ngrinë me dorën në gjoks alla zog.<sup>1)</sup>

— Ashtu, burra! — u kënaq Zaim agai, i cili edhe vetë u gjend fnë këmbë. Në vend të duçes kishte marrë në dorë ibrikun me raki. Hapi këmbët anash, mbështeti grykën prej metalit të fitohtë në buzët e trasha dhe, pasi mbushi mushkëritë me aromë rakte, piu me gjillënkatë mëdhë. Shtëllungat e mustaqeve notuan sa notuan mbi lëngun e kristallë që sa vinte e fironte, pastaj rranë e tu ngjitën në çingon e zmaltuar të ibrikut.

— Aaaaah!

Në vatrë digjeshin trungje lisi.

Buxhaku i gjerë shpërndante nëpërdhomë drithë e ngrohtësi.

— More kapter Vizhdani, kam dëgjuar sikur

— 1) Mënyra e nderimit.

mbreti e ka me barrë të shoqen. E vërtetë është, apo duan e thonë?

— Allahu e gjëzofte me një djalë! — uroi kap-ter Vizhdani.

— Ashtu, të lumtë goja! Dy, ishallah, në qoftë ajo e racës! Mbretëria ka nevojë për djem. Raki, more djem!

— Erdhi damizani i rakisë.

— Hapë! — urdhëroi Zaim agai.

— Erdhi një kanistër me ftonjë e me fiq të thatë.

— Ashtu, de! Miku nderohet me të gjitha.

— Jua paçim borxh, Zaim aga! — uruan me një gëjë kapteri dhe xhandarët.

— Mos ma thoni atë fjalë! Ju e bëtë atë që juntakonte. Unë po lalj borxhin... — Po pikërisht ky «borxh» sikur e goditi si lemzë Zaim aganë.

Hodhi sytë nga dera. Tërhoqi qostekun e ar- gjentë dhe pa orën.

— Po Kamberi s'duket, a? — pyeti pa e shqi- tür gazin nga buza.

— Ende, baba.

— Hu!

Mori një ftua. E mbështeti nëvatëri dhe e ndau më dysh me një të goditur grushti.

— Po plaket Kamberi. S'i punojnë më si për- para, as këmba, as mendja.

— Është natë e keqe, baba.

— Mbylle ti! Hidhu raki miqve! Ajo është

puna jote!

— Peqe, baba!

— Aji duhej të kishte ardhur tanë.

— Të na kishit thënë neve, e kishim mbaruar

që në vend edhe atë punë — tha kapter Vizhdani.

— U plak Kamberi, u plak... Po pini, more miq, se muhabeti bëhet edhe duke pirë... More djem! Ka kohë që s'ju kam dëgjuar zérin; apo prisni nga unë? Merrjani, more, një herë, asaj së Hankos!

«Hanko, dy tase në dorë.»

Një me akull një me borë.»

Bëjë kombeje ebbë qëndol Dibrët iepo rohë.

Vec Zaim vaga Çikës sikur si njëngjiti kënga kësaj here.

Iu duk sikur djemtë e zvarritën atë, sikur si dëgjojë mirë fjalët ne saj, prandaj edhe ngiriti kokën. Ai ishte mësuar që kënga ta mbushtë dhomën cep më cep, të ngjishej, të ngjishej pas mureve, të shpërthente dyert e, duke marrë të tatëpjetën, të lëshohej si një ortek gjigant spërbim qatitë me rrasha guri të përdheseve të fshatit. Por kësaj radhe ajo u mblohdhi si një iriq aty te praku i derës. Zaim aga iti erdhin të pështirë. Uli kokën dhe rrudbi vetullata. Si u shkruan që është përkakorët e kësaj radhe.

Mollëza e faqës së majtë iu ngjeth dhe një pshetëtimë që gërvishi kafazin e kraharonit.

— Erdhi Kamberi! — thirri dikush që jashtë dhomës, ovut i Johnës e Shës i Shën Drorit.

Zaim vaga Çika shqetëdhe inje copëtjetër dhjami nga brinja e qengjit të pjeturit të tashme.

Kamberi hyri në derë, duke sjellës me vete thëllimin e natës me sqotës.

E? — pyeti Zaim agai.

— Iku! Te Lugjësi Dallënjes qëllotinjë herë me pushkë, pastaj zbriti rrëzës. Ingsi sprijti — Me pushkë, the?

— Po. Nuk ia mbajta mendatë të flamosur pushkë.

— Ikë, Kamber, rrudhe! Kamberi uli kokën.

— Ajo pushkë i duhet marrë atij qeni! Si thua, zoti kapter?

— Faji është juaji. Pse s'na thatë? E kishim vëtë në dorë.

Zaim agai ngriti kokën dhe picërroi sytë i trondituri.

— Ajo pushkë i duhet marrë!

— **Kollaj, Zaim aga, pse bëheni merak?** E kryejmë edhe atë punë.

Dhe kapter Vizhdani i bëri një shenjë me kokë njërit prej xhandarëve. Xhandari u gjend më këmbë në çast e po kopsiste pullat e bakërtatë uniformës.

— C'do të bëni, zoti kapter? — Zaim agart i qeshën mustaqet.

— Do t'i dërgoj rrreshter Dules një copë pusullë në postë dhe t'i dalë me xhandarët t'ia marrë atë hekur që na paska me vete. S'ka niga të shkojë. Ai, do s'do, tek ura do të dalë.

Atje është posta jonë dhe unë po urdhëroj rrreshter Dulen.

— Zoti ju dhëntë jetë e shëndet juve e Lartmadhërisë, o zoti kapter! Po s'është nevoja të lohdhet zoti xhandar.

— **Kamber!**

— Urdhëro, Zaim aga!

— Merr letrën e zotit kapter, kalo në va dhe mba fushës! Në të ftotë kali ngjet mirë.

— Peqe, aga!

— Bisedoje punën me ata të postës edhe me

gojë! Ata e kanë për detyrë. Çoju edhe ca mish e ca raki! Të ngrohen pak, se janë buzë lumit. — Ngriti gotën dhe uroi me zë kumbues: — Ymër allahu Lartmadhërised!

... Pas pak nga porta e kullës doli një kalorës.

Trokthi i kalit në revan shkau tatëpjetë fshatit dhe humbi tutje fushave të buzës së lumit.

Në dritaret e kullës<sup>majë</sup> shkëmbit vazhdonte të bururiste një dritë e mëkur.

19. VITI I 17. 7. 1931.

Na, nuk ka qytet me shumicët e vajzave që kanë është  
nëpër. E gjeti dhjetë zotë e vjedhjeve që e bëjnë  
një gjë këndore, të cilat bëjnë një vajzë me zë.  
Zotët këndore bëjnë që vajza që e bëjnë  
një gjë këndore bëjnë që e bëjnë një vajzë me zë.  
Vajza që e bëjnë një gjë këndore bëjnë  
një gjë këndore, që e bëjnë një vajzë me zë.  
Na, nuk ka qytet me shumicët e vajzave që kanë është  
nëpër. E gjeti dhjetë zotë e vjedhjeve që e bëjnë  
një gjë këndore, të cilat bëjnë një vajzë me zë.  
Zotët këndore bëjnë që vajza që e bëjnë  
një gjë këndore bëjnë që e bëjnë një vajzë me zë.  
Vajza që e bëjnë një gjë këndore bëjnë  
një gjë këndore, që e bëjnë një vajzë me zë.  
Na, nuk ka qytet me shumicët e vajzave që kanë është  
nëpër. E gjeti dhjetë zotë e vjedhjeve që e bëjnë  
një gjë këndore, të cilat bëjnë një vajzë me zë.  
Zotët këndore bëjnë që vajza që e bëjnë  
një gjë këndore bëjnë që e bëjnë një vajzë me zë.  
Vajza që e bëjnë një gjë këndore bëjnë  
një gjë këndore, që e bëjnë një vajzë me zë.  
Na, nuk ka qytet me shumicët e vajzave që kanë është  
nëpër. E gjeti dhjetë zotë e vjedhjeve që e bëjnë  
një gjë këndore, të cilat bëjnë një vajzë me zë.  
Zotët këndore bëjnë që vajza që e bëjnë  
një gjë këndore bëjnë që e bëjnë një vajzë me zë.  
Vajza që e bëjnë një gjë këndore bëjnë  
një gjë këndore, që e bëjnë një vajzë me zë.  
Na, nuk ka qytet me shumicët e vajzave që kanë është  
nëpër. E gjeti dhjetë zotë e vjedhjeve që e bëjnë  
një gjë këndore, të cilat bëjnë një vajzë me zë.  
Zotët këndore bëjnë që vajza që e bëjnë  
një gjë këndore bëjnë që e bëjnë një vajzë me zë.  
Vajza që e bëjnë një gjë këndore bëjnë  
një gjë këndore, që e bëjnë një vajzë me zë.

ë qëndrojnë së përmes qytetit që, është e vërtetë që  
— qëndrojnë qëndri i shkollave shqipe të Gjirokastrës, që  
nëpër këtë — iku qëndrueshëm i cili kemi përzgjedhur si përgjegjësi  
i këtij qyteti. Në këtë qytet e gjithëve që jetojnë, këtë  
— qëndrueshëm i cili kemi përzgjedhur si përgjegjësi i këtij qyteti  
— qëndrojnë qëndri i shkollave shqipe të Gjirokastrës.  
**III** është e jashtëzakonshme që këtij qyteti e  
meritet e është qëndri i shkollave shqipe.

## M E R U S H J A

Buzë lumit, sqotës së thëllimitë sikur iu prenë  
krahët.

Vetëm mbi kokat e tyre saçi sterrë i reve  
varej si një masë kolovitëse vigane. Lumi gurgullonte me tërsëllimë e përcillte në zallishtet tërë  
gëmusha rrepesh shtëllunga të turbullta valësh.

Një pjesë të gjatë të rrugës ata ecën pa ndërruar asnjë fjalë.

Ai bluanë në kokë tërë atë që shkoi, e përpinqej  
të kapte, të paktën, një fije nga ajo që e  
priste.

Vërtet që kishte vendosur të përplasej në derë  
miku, po miku ç'do të thoshte pér këtë? A kishte  
ku ta mbante e me se ta mbante? I vinte keq që  
vetëm tani po i vinin në mend këto pyetje. Më  
parë mbasë do të bënte si të bënte e do të rregullohej  
në ndonjë rrëzë fshati, apo te ndonjë fshatar.  
Po tani? Tani ku të mbytej? Ku ta fuste  
kokën?! Ku ta mbante frymën, sikur edhe miku të  
ishte keq? Me çfarë të ushqëhej? Ku të punonte?

Kërkonte apo s'kërkonte punëtorë Vlorë? Po, sai s'dinte asnjë zanat tjetër veç atij të par mendës e të kërrabës, kurse në Vlorë sikur s'para i q hante meraku pér parmenda e pér kërraba. Të kishte bërë nga i kunati? Jo, jo!.. Atje nuk mund të shkonte, sikur... nuk mund të shkonte kollovar, jo! Ç'do të thoshin ata pér të? Ç'do të mendonte fshati i së shoqes? Kush i duronte rromuzet e tyre?

«Jo, jo!.. — vazhdonte vargu i gjatë i mendimeve të tij. — Më mirë kështu. Kështu, të paktën, bëj si dua vetë. Jam kryelartë para derës së gruas. Miku do të më presë të paktën një dy ditë sa të shes sharkun e mushkën. Të zë pak para dhe me para pastaj çaj dynjanë. Edhe punë do të gjej, përsë të mos gjej? Do të gjej që ç'ke me të. Mos jam më i metë nga të tjerët unë?... — dhe vargu i gjatë i mendimeve të tij zvarritej njëshume rrugën, që gjarpëronte herë rrëzës së zallit të lut mit e herë ngjitej përpjetë kodrinave e priste shkëmbinje të zhveshur përi t'u rrokullisur pastaj prej tyre nëpër çarjet e errëta të përenjve.

Rrugë.

Natë.

Mendime.

Nata përpinte rrugën dhe mendimet.

Po mendimet s'kishin të mbaruar.

Shpërthenin e shpërthenin si flakë të ndezura në gjirin e zibët natës, tulateshin e përsëri shpërthenin pér të dalë tej kufive ndrydhës të saj.

Karvani i vogël çante natën, duke shkelur mbi brinjët e saj të cingërimta.

.....  
— Ke ftohtë? — e pyeti të shqen, kurse

asaj, meqë ishte mësuar me heshtjen e gjatë, iu duk si krismë zëri i tij. Po e mbledhi veten shpejt e; saj përtiq dhënë zemër të shqit, u përgjegj:  
— U ngroha pak.  
— Po djali? —  
— Po file.  
— Mos, nái e rrëzon mushka.  
Sot, — S'ëlënë dengjet të objerë. E kam futur si nienfurrik saty, i njegj veshi bisev —  
— Dëg. M... mirellë mëndafshim s'm —  
ës ës... Mos do të clodhesh?  
— Nuk jam clodhur.  
— Clodhu pak, se kemi rrugë të gjatë.  
— Natën nuk ndihet rruga.  
— Ashtu është. Gjatë kësaj, kohe Sezaiu, kishte mbushur çibukun, kishte shkrepur shkëndijat, në strallë, me masat dje po shtypte me gishtin e madh eshkën mbi duhan. I mbushi dy-tri herë bulcitë me tymin e wakët, të duhanit, pastaj e thithi me duf.

- Kyndjalik sikur të clodh,
- Kush?
- Çibuku. Cigarja s'më ngop hiç.
- Aha.

... Tanimë rrugë çante midis gërbonjave xhunga-xhunga të trapishtës. Ata ecnin, Era shtynte refë tutje nga lindja.

Në opinga balta e kuqe u përzie me gjethet e kalburat e më rërëni e buzës së lumit.

- Po në Vlorë bie borë?
- Mbase bie.
- Si pështë Vlora?
- E madhe.

— Plot me njerëz? —  
— S'i bëhet hesapi.

— Bobo! —  
— C'pate?

— Po sikur të mos e gjejmë? —

— Do ta gjejmë. Mësuesit i njohin të gjithë.  
— Do të na pranojë?

Aty edhe rrjedha e lumiit ngushtohej e rryma çante në rrjedhën e ngushtë me gurgullimë. Valët shtynin njera-tjetrën me forcë e pak më tej binin përsëri në qetësi.

— Doemos — u përgjegj Sezaiu, po në zërin e tij u ndje shqetësimi.

— Ishallah! — tha Merushja. Bashkë me këtë fjalë nxori edhe një psherëtimë të zgjatur, të thellë.

... Nata harronte orët nën këmbët e tyre.

Fshati në rrëzë të malit dhe kulla si kokë lubie mbi shkëmbin në krye të fshatit kishin mbetur tutje në gjirin e thellë të natës.

Maleve e shtigjeve të thepisura e gërxhe-gërxhe ua kishin zënë vendin ca kodra të buta tërë xina e driza.


Udha buzë lumit ngiste shtruar e gjerë, tamam si lumi, se aty edhe lumi ashtu rriddhte; më lirisht, më shtruar, më gjerë.

Në qiellin e pérëndimit u pre një shirit i mugët. Në mugëtirën e tij buburiste me dritë të mekur një yll.

— U ça — tha Sezaiu.

— Do të kemi ditë të kthjellët.

— S'i zihet besë janarit. Është hileqar ky.



- Janë punët e zotit ato.  
 — Kusuret e robit.  
 — Harroi kusuret! Ishallah na vete mbarë në Vlorë.  
 — Jo, moj, se s'harrohen të shkretat. Janë bërë plagë këtu brenda ato.  
 — Ah, more Sezo!  
 — E di si? — dhe ai mbajti këmbët për t'u ndodhur më afër së shoqes. — Le të kishte kusure, po pa dhembje ama, se kusuri kalon, po dhembja mbetet e të drobit çikë e nga një çikë. Ja. Këtë nuk e duron dot njjeriu.  
 — Do t'i durojmë.  
 — Po pse të jetë kështu? Përse vetëm dhembje për njerinë?  
 — Kështu ështëjeta — deshi ta qetësonte ajo.  
 — Po nuk vuajnë të gjithë ama.  
 — Mbaze.  
 — Po ne pse të vuajmë?  
 — Këtë fat kemi.  
 — Ky fat s'na ra nga qielli.  
 — Është hyqmi i perëndisë.  
 — Pse, moj, ku na gjeti ne në rrëzë të Çikës hyqmi i perëndisë?  
 — E po si të them?  
 — Si të thuash? — Merushja ngriti supet.  
**I rëntë zjarri perëndisë edhe cdo gjëje që bëri ajo!**  
 — Estafkurllah!  
 — Si the?  
 — Mos truaj, se është natë e ligë!  
 — Në djall, të vejë nata e ligë me gjithë hyqmin e perëndisë! — dhe u nis.

— Ruana zot! — dhé ajo e ndoqi prapa, duke tärhequr më forcë frerin e mushkës.

.... Shiriti i mugët i qiellit të perëndimit kishte marrë ngjyrë vjollce të çelur.

Diku matanë lumit këndoi gjeljoi parë.

— Sezo!.. Gjithnjë me të hakërruar ti.

Ai nuk e ngriti kokën, po hapi i tij sikur u topit e nuk e ndoqi dot më atë ritmin e mëparshëm.

— S'më fole një herë me të mirë!

Ai fërkoi ballin me shuplakën e ashpër.

— Mos u zemëro! S'e kam unë fajin. Jeta më ka bërë ca të ashpër.

— Bashkë po e jetojmë këtë jetë — tha ajo, duke u munduar që të mos i lëshonte rrugë ngashërimit që iu mblodh si lëmsh në fyt.

— Po ti je grua. Hallet bien mbi mua. Unë duhet të robëtohem për ta mbajtur shtëpinë më këmbë. E kuption ti, apo jo? Emrin dhe nderin e saj duhet t'i ruajnë këtò duar e kjo kokë.

Ajo ngashërehej mbyturazi.

— Kot që qan. Unë e kam fajin. Nuk e mendova se ai qen, duhej vrarë me kohë. Më dëgjon ti, apo jo? Duhej vrarë! Unë duhej ta vrisja, unë!

— Jo, jo! Po ta vrisje, më keq do të bëhej, do të të vrisnin edhe ty.

— Po të më gjemin, le të më vrisnin.

— Do të gjemin djalin.

— Djali është foshnjë. S'është bërë ai të lajë haqet tona. E kuption ti, apo jo?

— E kuptoj.

— Ashtu de! Unë duhej ta vrisja atë qen!

Qielli po gahej mbi kokat e tyre.

Copat e qielilit e copat e reve dukeshin si  
nuanca tē sē njejtēs ngjyrē.

Nē copat e qielilit vezullonin yje.

Yje tē ftohta.

Yje tē ngrira.

Qielli po gahej mbi kokat e tyre.  
Copat e qielilit e copat e reve dukeshin si  
nuanca tē sē njejtēs ngjyrē.  
Nē copat e qielilit vezullonin yje.  
Yje tē ftohta.  
Yje tē ngrira.  
Qielli po gahej mbi kokat e tyre.  
Copat e qielilit e copat e reve dukeshin si  
nuanca tē sē njejtēs ngjyrē.  
Nē copat e qielilit vezullonin yje.  
Yje tē ftohta.  
Yje tē ngrira.  
Qielli po gahej mbi kokat e tyre.  
Copat e qielilit e copat e reve dukeshin si  
nuanca tē sē njejtēs ngjyrē.  
Nē copat e qielilit vezullonin yje.  
Yje tē ftohta.  
Yje tē ngrira.  
Qielli po gahej mbi kokat e tyre.  
Copat e qielilit e copat e reve dukeshin si  
nuanca tē sē njejtēs ngjyrē.  
Nē copat e qielilit vezullonin yje.  
Yje tē ftohta.  
Yje tē ngrira.  
Qielli po gahej mbi kokat e tyre.  
Copat e qielilit e copat e reve dukeshin si  
nuanca tē sē njejtēs ngjyrē.  
Nē copat e qielilit vezullonin yje.  
Yje tē ftohta.  
Yje tē ngrira.

## IV

### P U S H K A

Sezaiu dhe Merushja u futën në rrapishten e dendur që të conte tek ura. Udhë e mbuluar nga degët e rrepevë i ngjante një labirinti të frikshëm. Midis degëve të pleksura dendur vezullimet e akulla ta të yjeve dukeshin si ca feksje të largëta buburrecash.

- Eeej!
- Dikush thërret! — u tremb Merushja.
- Dale! — dhe vuri veshin të dëgjonte.
- Eeeej, ti!
- Mos u përgjegj! Kthehem i prapa!
- Eeeej! — u përgjegj Sezaiu.
- Kush je ti?
- Njeri.
- Pa hajde këtej!
- A?
- Luaj këmbët këtej nga unë!
- Ahal.. S'jam vetëm.
- Frriiiu! — fryu një bilbil.
- Alarm!
- Si the, more?
- Alarm, thashë, po ti mos luaj nga vendi, se ta mbështolla kokës!

Merushja kapi Sezainë nga mënga.

Ai hoqi pushkën nga supi.

Matanë krisi një pushkë.

— Qyqja!

— Mba djalin!

— Aman, Sezo, ikim!

— Mos ki frikë! Qëllojnë në hava. Merre mushkën dhe hiq mënjanë!

— Po ti?!

— Kam pushkën.

— Aman, Sezo! S'rrihet më këtu!

— Ikë, mës më prish mendjen!

— Ezëza, q'mi gjeti!

— Moji po mës më prish mendjen, të thashë!

— Janë shumë, Sezo! S'kel punë më ta tilbimi

— Tre janë. S'kënd ne ka nindur evoli

— Katër.

— Tre, të thashë!

— Po mua m'u dukën katër!

— Le të jenë sa të duan. Ruaj djalin ti! Hiqe mushkën mënjanë! — dhe bëri përpara me pushkën në dorë.

— Eeej! — thirrën që matanë.

Labirinti i ftohtë i rrugës me dégët e përthura rura të rrapishtes kumboi.

— Eeeej! — u përgjegj Sezaiu në vend që të thoshte: «këtu, këtu jam!»

— Luaj, de!

— Kush je ti?

— Qeveria!

— Jo, more! C'dreqin do qeveria nga unë?!

— Dreqi të theftë qafën! S'e paske marrë vesh

ti që është e ndaluar të bredhësh natën këtyre anëve?

— Pse, more? Edhe rruga qenka ndaluar këtej?

— Rruga bëhet kur ka bërë urdhër Lartmadhëria e tij, Zogu i parë.

Zëri sa vinte e afrohej nëpër atë labirint.

— Nga e keqja edhe ne, a derëzi, pa kush u marros ta bëjë për qejf tërë këtë rrugë kësaj mavrinat!

— E keqja jote të rruat ty, kurse ligji është një për të gjithë... More ti!.. Ç'dreqin mban ashtu në dorë?

— Pushkën — u përgjegj menjëherë Sezaiu.

— Ule... Ule dreqin se, për perëndi, ta kripa kokën! Ziko! Syrja! Eeeej! Gati, ta hajë dreqi! Gati për zjarr!

Sezaiu u mbështet në trungun e një rrapi. Hoqi qylafin dhe ngrehu shulin.

— Aman, Sezo! Hajde! — iu lut Merushja.

— Mos m'u afroni, se jám me fëmijën!

— Vetëm ule tytën, pa s'të gjen gjë e keqe.

— Pa marrë vesh kush jeni, nuk e ul tytën, jo!

— Qeveria jemi.

— S'ma mbushni dot mendjen.

— Për perëndi, qeveria!

— Sos u marros qeveria, të sorollatet natën rrapishteve e zallishteve!

— More! Lidhe, more, atë zagare gjuhë, se ma prure mu në majë të hundës!

— Goxha burrë po më dukesh, po dil njëherë të ta shoh surratin! Mua do të ma hedhësh ti?

— Për emër të zotit, s'të gënjej!

— Dilni një herë pa, po të jeni qeveria, nuk qëlloj, jo!

Që prapa rrapishtes u stërzgjat një siluetë. Sezaiu ndiqte lëvizjet e saj me tytën e pushkës.

Ktheu edhe një herë kokën prapa.

Nën të, buzë udhës, Merushja kishte ndaluar mushkën.

— Bëj më tutje ti!

— Mirë jam këtu. Mos u mërzit ti.

— Ule, ule pushkën! — thirri Sezaiu.

Silueta matanë u bind.

— Afrohu, se nuk të shoh mirë!

— Luaj, Ziko!... Syrja, more!.. Luani, de!

Tri hije u radhitën në labirintin e ftohtë të rrapishtes.

— Xhandarë? — pyeti Sezaiu.

— Ashtu, more burrë! Xhandarmëria jemi.

— Aha! Po ç'djall doni nga unë?

— Duam të marrim vesh kush jeni e ku shkon.

— Popull jam. Shkoj në punën time.

— Pse natën?

— Kështu deshi qeveria. Kështu deshën agai dhe kapteri juaj.

— Shumë mirë!

Zikua dhe Syrjai ndezën nga një cigare. Rresh-ter Dulja hodhi pushkën në krah e tha:

— Rregulli e do të vish deri në postë! Nuk është larg e s'do të të mbajmë shumë,

— Ç'të bëj unë në postë?

— Këtej është zonë e ndaluar.

— S'e dija.

— E mora vesh, po, që të të lëshojmë shpejt, do të bëjmë një procesverbal të vogël.

- Çfarë përshesti the, more?  
 — Një shkresë, shkresë.  
 — Aha!.. Mirë, mirë. Shkon përparrë ju.  
 — Shkojmë bashkë.  
 — Nisuni ju, se arrita unë. Sa të thérres  
 gruan.  
 — Vetëm mos u vono! — dhe u nisen.  
 Sezaiu u afrua te Merushja.  
 Sytë e saj shkrepnin me një frikë të brend-  
 shme.  
 Mushka qëmtonte fije të thata bari.  
 — Mos shko, Sezo!  
 — Duhet vajtur. Janë njerëz të qeverisë. Ti  
 hajde pas meje!  
 — Mos shko! Nuk i besohet të huajit natën.  
 Mua diç po më ndjell zemra.  
 — Hajde pas meje ti!  
 — Sezo!  
 — Hajde, hajde!  
 Hodhi pushkën në krah dhe u nis.  
 Merushja i shkoi pas.  
 Tutje hingëlliti një kalë.  
 Sezaiu ndaloi.  
 — Hingëllimë kali — tha Merushja për të  
 qetësuar veten.

Qëkur kishte nisur të ecë pas tij nëpër atë  
 labirint degësh të përthurura, ajo kishte provuar  
 një ndjenjë të bezdissħme ndrydhjeje. Nën barrën  
 e asaj ndrydhjeje Merushes i bëhej sikur gjithshka  
 që e rrëthonte kishte dy fytyra. Atë që shihte (po  
 kjo nuk e shqetëson) dhe atë që ndoshta fshihej  
 pas asaj që shihte. Prandaj edhe çdo tingulli, çdo  
 lëvizjeje, çdo zhurme ajo përpinqej t'i gjente një  
 domethënie.

- Moj, po, janë tre, këta lanetër, apo katër?
- Nuk e di unë e varfëra! Herë më duken tre e herë katër.
- Hej dreq! Ja!.. Apo më bënë sytë?.. Ptfu!
- Le të janë sa të duan. Ç'më duhet mua sa janë ata.
- Katër!
- Ku?
- Kështu m'u bë.

Te derë e postës prisnin rreshter Dulja dhe dy xhandarët.

Njëri i gjatë, sa prekte më kokë kreun e derës. Dy tjetër rrash me supet e tij.

Të tre pinin cigare.

Të tre i kishin pushkët në krah me tytat drejt qelliit.

Qelli ishte plasaritur si ugari pas thatësirës. Nëpër ato plasaritje vezullonin yje. Yje tëngrira. Yje të ftohta.

— Afroje mushkën! — i tha së shoqës. — Aty qëndro!

— Hajde brenda! — e thirri ai që prekte me kokë kreun e derës së postës. U thye në mes dhe hyri i pari në postë.

Sezaiu u kthye edhe një herë nga e shoqja, pastaj shkoi pas tij:

Në atë dhomë të vogël rreshteri po varte pushkën në njerën nga gozhdët e varëses së drunjëtë murit.

— Ja! — i tha Sezaiut pa e thyer kokën — vare këtu pushkën!

— Si the, more?

— Këtu është zyrë.

— Qoftë shëndoshë!  
— Në zyrë arma varet.  
— Zyra është jotja.  
— Eshtë e mbretërissë, dhe Lartmadhëria e tij,  
Zogu i parë, ka urdhëruar të varet arma në zyra.  
— Edhe pér mua e ka lëshuar këtë urdhër?  
— Pér tërë popullin.  
Sezaiut nuk i pëlqeu ky urdhër i Lartmadhë-  
risë së tij.

Prapë po ai shqetësim i ngrohu tëmthat.  
Hija e katërt po i rëndomte si mal mbi kokë,  
mbi tru.

Ktheu kokën.

«Djall, o punë!»

Vetëm dy xhandarë.

Të dy të ngrirë.

Të dy me mustaqe si bisqe të zeza mbi buzët e  
puthitura.

I vërejti me kujdes.

Përballë vështrimit të tij dy palësy të aksullt, por  
prapë ju duk sikur diçkë si një e fshehtë shqetë-  
suese i lidhte këta tre xhandarë. Xhandari që fliste  
gjithnjë, rrështer Dulja, kur vuri re shqetësimin e  
Sezaiut, vuri buzën në gaz.

— Po ti mos na turpëro, more burri i dheut.  
Shqiptar jemi e shokë të njëri-tjetrit. Vare armën!

— Njëlloj është. Ju e varët në gozhdë, unë e  
kam varur në sup. Mua nuk më rëndon.

Xhandar Zikua mbylli derën.

— Hape, se kam fëmijën jashtë!

— Lëre hapur! — urdhëroi nga mesi i dho-  
mës rrështeri i gjatë. Prapa buzëqeshjes së tij u  
shtjellua një zinxhir dhëmbësh të zverdhur nga ty-  
mi i duhanit.

Merushja shtrëngonte frerin. Koka e saj ishte mbështetur te qafa e mushkës. Sytë e saj ishin mbërthyer në katërkëndëshin e derës së postës.

Sezaiu qëndronitë më këmbë. Ajo i shikonte vetëm profilin. Flokët, që dilnin nga ana e qylafit mbi ballë, balli i drejtë, vetullat e trasha, hunda me pak kurriz, mollézat e kërcyera, nofullat e shtrënguara, buzët e puthitura mirë dhe mjekra katërkëndëshe, të cilat ajo nuk i kishte parë kurrë me aq kujdes, iu dukën aq të dashura e të afërtë, sa ajo nuk mundi ta shkëpuste dot shikimin prej tyre.

Mendja i punonte vetëm për atë.

Nuk i vinte mirë që ai u fut në atë dhomëz të vogël me ata tre të panjohur.

Ai ishte një, ata tre.

Midis degëve murake grivëronte lumi.

Nën këmbët e urës gurgullonin valë.

Merushja e zembrapsi mushkën nga shiriti i vërdhë i dritës që lëshonte feneri, nëpër derën e postës, në sheshin para saj, po sytë s'i ndau nga dera.

Dera i bëhej aq e madhë, sa konturet e saj sikur shkriheshin me hapësirën, kurse Sezaiu rrëmbente tërë shikimin e saj, sikur të ishte një pikë e vetme tërë ajo largësi që i ndante nga njëri-tjetri.

Ai e vari pushkën.

Ajo afroi edhe ca mushkën.

Një valë e re shqetësimi ia ngjethi muskujt.

Nën urë gurgullonte lumi valë-valë.

Ai sillte nga grykat e largëta të maleve bashkë me rrjedhën e ujit edhe një vorbull të cingërimtë ajri. Vorbulla e cingërimtë e ajrit përlapsej në rrobat e lagura të Merushes, depërtonte nëpërmjet tyre deri në mishrat po të lagura të saj e ia vishte tërë trupin me një cipë ftohtësire të çuditshme, kurse

trupi i lodhur nga tërë ajo rrugë e gjatë i përgjegjej me ca të ngjethura të hidhura e me ca kërkëllitje të shfrenuara dhëmbësh.

Në postë qetësi.

Te dera e postës dy xhandarët mbështetën krahet në të dyja anët e saj.

Sezaiu shquante midis dy trupave të tyre.

Ata, si dy shkëmbinj të zinj.

Ai, si një gur i rënë në shtegun midis tyre.

Ktheu kokën.

Ata të dy thithnin cigaret me qetësi.

— Si e ke emrin? — u dëgjua zëri i rreshter Dules.

— Ç'e dó? — e pyeti Sezaiu.

— E do ligji, — u përgjigj me përtim Sezaiu.

— Sezo! — u dëgjua si klithmë nga jashtë zëri i tmerruar i Merushes.

Ai ktheu kokën me rrëmbim.

Ajo po e shikonte që jashtë me ca sy të shqyer.

Ai shtangu.

Hija e katërt, që tërë kohën i kishte rënduar si mal mbi kokë e mbi tru; po materializohej, po merrte formë muratty prapa krahëve të tij, e ai po e shikonte me ca sy të çapëlyer nga habia.

Qylafi i bardhë, vetullat e mbërthyera mbi shtegun e ballit, hunda krrutë, xhaketa prej shajaku të zi me jakën të rrahur kadife të butë, qillotat e qepura të xhokaxhiu më me emër i Vlorës, çizmet e verdha... po ajo kriesë që e kishte përzënë asaj nate nga shtëpia!..

— Kamberi?!

Jashtë u dëgjua përsëri hingëllima e kalit.

— Llagapin? — pyeti më tej ai që pyeste gjithnjë.

— Si shumë avaze paska ky përsheshi juaj!  
— Jo përsheshi, po procesi! — thirri rreshteri  
dhe u ngrit me rrëmbim më këmbë, duke përplasur  
me tërë forcën grushtin mbi syprinën e drunjtë të  
tryézës.

Sezaiu u gjend menjëherë më këmbë dhe zgjati  
dorën të merrte pushkën, por pushka ishte zhdu-  
kur. Në varësen e drunjtë të murit nxinin kokat e  
ndryshkura të gozhdëve.

— Pushka! Ç'm'u bë pushka?!

Qehajai i Zaim agait qeshte nën buzë. Qeshte i  
krekosur.

Një dorë e mbante në brez, mbi dorezën prej  
çeliku të zi të pistoletës. Me tjetrën uli qylafin mbi  
ballë.

— Sezai Hajrullahu — i tha ai rreshterit. —  
Shkruaj, shkruaj! I biri i Zenun Hajrullahut nga  
Çika.

Rreshteri qeshi më një zë si gurgullimë lumi.

— Pushkën kërkon? — e pyeti Kamberi Se-  
zainë.

Ai edhe mund të bënte diçka, por... jashtë e  
prisnin Merushja mestë birin. Ata ishin vetëm, kur-  
se ai nuk kishte të drejtë t'i linte ashtu rrugëve  
pa izot.

Kollaj ajo punë — iu përgjegj Kamberit —  
gjejenjë tjeter, po të më duhet.

— Ke të fala nga Zaim është Çika. Ai më dërgoi  
për pushkën tënde. Unë e kisha harruar fare — e  
ngacmoi më tej Kamberi.

— Shëndoshë e paça Zaim aganë — sa, ta shoh  
edhe një herë.

Merushja u afroa te dera.

Sezai ktheu kokën nga ajo.

- U zgjua djali.  
 — Mos e lërë të zbulohet!  
 — Ai do të hajë.  
 — Jepi.  
 — Mirë, mirë, po hajde edhe ti!  
 — Sezai Zenun Hajrullahu nga Çika, ku e ke gjetur këtë pushkë?  
 — E kam patur.  
 — Pse nuk e ke dorëzuar? Mbretëria kabuixjerrë digje pér armët.  
 — Nuk ma ka kërkuar njeri.  
 — Ç't'i them Zaim maga i Çikës? — e ndërpreu Kamberi.

Sezai u kthyte me rrëmbim. Sy më sy përballë njëri-tjetrit.

- Kamberi priste përgjegje.  
 — Kur s'e vrava, qenin!  
 Kamberi shqeu sytë.  
 Mbi shtegun e ballit iu ngrit si shkop një damar dhe pëllëmba e tij u përplas fare papritur mbi faqen e parruar të Sezaiut.  
 — Mos, t'u thaftë dora! — thirri Merushja dhe u sul te dera e postës, por te dera s'çahej.

Duart e Sezaiut u zgjatën si kthetha hekuri drejt fytit të Kamberit dhe sytë e tij kërcyen në çast si arrë me shark.

— Ia mori shpirtin! — ulériu rreshter Dulja nga vendi ku qe dhe të tre xhandarët i kërcyen Sezaiut përsipër. Fyti i Kamberit u lirua, por s'mundi të mbahej më këmbë e u platin në dysheme pér një kohë, pastaj pak nga pak zuri t'i vinte fityra e parë dhe nën mustaqet, që vareshin në të dyja skajet e buzëve të tij, feksën dy dhëmbë të veshur me këllëfë ari.

— Lëshomëni! — thirri Sezaiu.

— Sezo!

— Largohu ti!

— Hajde të ikim!

— Te djali.ti!

ed Kamberi doli nga dera e postës.

— Lëshomëni! — thirri pér të dytën herë Sezaiu dhe u shkund me tërë peshën e trupit, po krahët e xendar Zikos e të xendar Syrjait s'epeshin. Trupi i tij u mblodh si lëmsh rrëth atyre krahëve që e mbanin si të gozhduar mu aty té prakù i derës së postës së xhandarmërisë mbretërore.

Një trokth i rëndë tronditi kokën.

Një hingëllimë e fortë prëu si teh thike hapësirën.

Sezaiu ngriti kokën! — Ah, qen, qen! Të shpëtuan, pa nuk dilje i gjallë nga duart e mijë!

Kali i bardhë i qehajait të Zaim aga Cikës u zhduk si vetëtima në ëdhëzën e ngushtë midis rrapishteve të buzës së lumit,

Prapa rrapishteve lumi rrëdhte e rrëdhte me gurgullima.

Sezaiu e ndjeu veten të cliruar.

Uli mëngët e xhaketës dhe u kthyesh andejë nga kishte mbetur xhandari i gjatë — rrështer Dulja.

— Po të të duhet pushka — i tha ai — shko në Vlorë e takohu me zotin Menduh Rushiti. Ai i ka në dorë këto punë.

Sezaiu doli me rrëmbim nga dera e postës.

— Nuk të gënjej, jo!! — Vazhdoi rrështeri i gjatë e u duk te dera e postës midis dy të tjerëve.

— Ashtu do të bëj. Është jetë e gjatë kjo. Do të piqemi!

Tre xhandarët u shkrehën në një të qeshur të shfrenuar.

Gurgullima e valëve të lumiit kumboi mbi gazin e tyre.

Lindja ishte thërmuar në plisa të purpurt.

Në perendim po shuheshin yjet e fundit.

# V

## L A M Ç J A

...Karvani i vogël arriti në Qafën e Koçiut atëherë, kur pas krahëve të tyre dielli ishte ngritur një dy hostenë mbi kodrat e Armenit.

Në qafë ndaluan.

Sezaiu u ul në trungun e një ulliri.

Merushja rregulloi të birin në shark aty pranë tij.

— Ja edhe Vlora! — i tha së shoqes.

— Ku?

— Nën këto kodra. Rrëzë tyre. Ajo është fusha e Vlorës. Ai është deti.

... deti i shpresës për të gjetur një copë strehë dhe një kothere bukë.

Ata do të rrëshqisnin nga e përpjeta e Qafës së Koçiut si një ngastër e shtrydhur jete e fshatit të struktur në këmbët e malit, do të ngecnin në qytetin rrëzë kodrinave, do të shkriheshin me rrugicat e përdheset e tij e në zymtinë e tyre do të kërkonin një rreze jete.

— Deti?! — pyeti e çuditur Merushja, që s'kishte parë kurrë det.

— Po, deti.

— Sa i madh!

... lumin ajo e njihte mirë, se atje lante, atje mbushte bucelat, atje merrte ujë me vedra për të vaditur misërishten në kohë thatësire; ia dinte të mirat e të këqiat. E kishte parë të qetë, të kristaltë, tek shkiste si një gjarpër argjendi ditëve të freskëta të pranverës, po e kishte parë edhe të tërbuar, të zhurmë e shkumë në ditët e egra të dimrit, kur rrëmbente në gjirin e tij të shkumëzuar trungje, gjerdhe, ndonjë dorë apo ndonjë djep fëmije... po detin?!

...Mendimet po e përkundnin Sezainë si në një shtrat të rehatshëm, e ai gajasi në krahët e asaj përkundje. Në bebzat prapa qerpikëve të shtrënguar regëtiti një qiell i verdhë. Në atë qiell të verdhë u derdhën miliarda shkëndijëza shumëngjyrëshe. Ato u pleksën në një lëmsh me njera-tjetrën, shkrepën me një gjëmim të fuqishëm e, duke lënë prapa një shigjetë të zjarrtë vetëtime, ikën e humbën në pafundësinë e verdhë.

Ai s'e ndjeu më tokën nën vete.

Me krahë të shtriqu iu duk sikur po qëndronte pezull në hava, si ai sqifteri që i ka kthyer gjoksin erës.

U tremb dhe hapi sytë.

Ullishtat nën këmbët e tij shkrepnin me xixëllima të kristalta, xixëllima të ftohta, xixëllima të ngrira. Pikat e shiut, që ishin mbérthyer fort te majat e gjetheve gjelbëroshe të ullishtave, feksnin nën rrezet e para të diellit mëngjezor.

— Ullishtat e Vlorës,

- Sa shumë! .
- Thonë se këtu u vra Selam Salaria.
- Ajo ktheu kokën në të tatëpjetën e mbuluar me kurora ullinjsh.
- Edhe babai këtu luftoi — vazhdoi ai.
- Ajo ktheu kokën nga ai.
- Është bërë luftë e madhe këtu. Janë vrarë shumë. Po Vlorën e fituan... Ai është Sazani. E ka Italia... .
- ... Pas pak Qafa e Koçiu u mbush me grupe fshatarësh që vinin në Vlorë për ditë pazari.
- Aty në atë qafë ata ishin mësuar të uleshin pak, sa për të marrë veten nga lodhja e rrugës.
- Pranë tyre, në gérboin e trungut të një ulliri, u ul një plak thinjosh me bigën e mustaqeve deri te veshët. Pak më tej, tre të rinj e më tej ende, tri-katër grupe të tjera.
- Tungjatjeta! — përshtendeti thinjoshi. Sezaiu e pa vëngër.
- Ai u ul këmbëkryq, hapi grykën e torbës, theu një copë buke të misërt, nxori gjizë e qepë e filloj të mbillaçitej.
- Nga ju kemi? — pyeti thinjoshi me bulçitë plot, pa e ngritur kokën.
- Nga larg — u përgjegj pa qejf Sezaiu.
- Dua bukë! — u ndie zëri i vogëlushit të mbështjellë me shark aty në prehrin e Merushes.
- Bujrum! — tha thinjoshi përsëri pa i ngritur sytë dhe bëri pak mënjanë, sa për të hapur vend. — Bujrum, me ç'na dha perëndia!
- Pëllëmba e Sezaiut kërciti në faqen e vogëlushit.
- Jazëk! — turfulloi thinjoshi duke ngritur kokën me rrëmbim. — Jazëk!.. Fëmijën?!.. për një

kafshatë bukë?! Për të ngrënë e pér të fjetur asnjëherë nuk është turp. Hajde te baba Lamçja ti!

— Vogëlushi u ngjesh në gjoksin e së emës.

— Thuaji fëmijës të ulet të hajë!

— Lëre, djallin, se ka ngrënë!

— Dy të ngrëna s'të bëjnë keq — dhe plaku u afrua me gjithë torbën pranë vogëlushit.

Ai fërkoi faqen me doçkën njomëzake.

Në sytë e Merushes u mblodhën dy pika lot.

— Merre! — u hakërrua Sezaiu.

— Avash! — e qortoi Lamçja Sezainë. — Mos iu hakërro!

Sezaiu shkundi çibukun.

Vogëlushi mori me drojtje copën e bukës e pulqerin me gjizë dhe u mbllaçit duke parë tinëz nga i ati.

Dy pikat e lotit në sytë e Merushes u rritën, u mjegulluan dhe u rënduan si dy sferëza plumbi. Ajo mbylli sytë. Lotët rrëshqitën te poshtë, duke lëruar mbi faqet e saj dy brazda të lagështa, të vakëta. Ktheu kokën mënjanë dhe fshiu sytë në cepin e jashmakut të bardhë.

— Na lodhi kjo natë — ndërhyri Lamçja.

— Ka marrë ca si ters moti! — tha Sezaiu.

— E, ashtu vërtet, po ku durojmë dot në! U plakën e na bitisi vlaga. Iku ajo kohë, kur të merrnim gjak në vetull.

Merushja ledhatonte flokët e të birit.

Sezaiu mbushte çibukun.

Lamçja e vogëlushi mblloçitnin bukë e gjizë.

Një maqinë ngjiste me gulçimë të përpjetën e Qafës së Koçiut.

Mbi gropën e Vlorës po derdheshin prezet e para të diellit mëngjezor.

Ora e qytetit ra shtatë herë. Pas pak gjëmuan kambanat. Tërë gropë e Vlorës kumbonte.

— Kambanat e kishave — tha Lamçja.

— Avaz i rëndë — shtoi pas pak Sezaiu.

Kumbimet e bronxëta, duke përshkuar ajrin e freskët të mëngjezit, përplaseshin në kodrat me ullishta.

Një pykë patash të egra çante qiellin e ftohtë.

— Hej bela! — dhe tundi kokën Lamçe Hyseni.

Sezaiu picërrroi sytë dhe nxori nëpërmjet buzëve pak të zgjatura përparrë një fjollë të hollë tymi.

— Kambanat, kambanat...

— Rrënkan gjatë! — dhe Sezaiu ktheu kokën andej nga vinte kumbimi i kambanave.

— Ehë!.. Po ai avaz! Tamam si atëhere... atë ditë...

— ...  
— Si vjen vërdallë kjo e shkretë rrötë! ..

— ... ?

— Mblidhet e mblidhet ai i shkretë lëmsh, pa ardhka një ditë që, për bela, do të shmbështjellësh po s'ke çfarë të shmbështjellësh.

— ... !

— Po ja... isha unë një kohë i ri, punova sa më hëngri krahu, provova në jetë të mira e të liga, gëzime e hidhërimë e u rrita e u rrita derisa u zbarëdha... Hedh sytë prapa e shikoj, po asgjë s'ka mbetur.

— Kështu e ka kjo botë.

— Nuk duhet të jetë kështu. Kur mbetet diçka pas njeriut, do të thotë se njeriu diçka ka bërë.

— Pas nesh do të mbetet ajo që mbeti pas të tjerëve.

— Varfi?!

— Doemos!

— Si e ke emrin ti?

— Sezai.

Lamçja ia ngüli mirë sytë fytyrës së tij. Tjetri uli kokën. Në baltën mu përpëra këmbëve të tij kishte ngecur një kokërr ulliri. Sezaiu é trazoi me majën e opingës.

— Ti, Sezai, ke një hall.

Sezaiu trazonte e trazonte kokrrën e kalbur të ullirit.

— Ke bërë rrugë të gjatë?

— Po.

— Tërë natën?

— Po — u përgjegj pa vetëdije Sezaiu, ndërsa me mendje mundohej të gjente c'ë shtynte këtë të panjohur të hynte kaq thellë në hallet e tij. Po shikimi i pastër e i kulluar i Lamçe Hysenit sikur i thosh: «Kur mbetet diçka pas njeriut, do të thotë se njeriu diçka ka bërë».

— Ke vrarë njeri?

— ...!

Sezaiu mbështeti shpatullat në trungun e ftohtë të ullirit

Psherëtiti dhe ktheu kokën andej nga vinte zhurma e motorit të maqinës.

Maqina i ngjitej së përpjetës së Qafës së Koçiut.

Motori gulçonte si një astmatik.

Gulçima e tij godiste si vare në kokën e Sezaiut.

Merushja e shkundi nga gjumi.

— Jo... Nuk kam vrarë njeri. Nuk munda... Tani nuk do të mundem kurrë... tërë jetën... se edhe pushkën ma morën.

Sezaiu dridhej. Dridhej edhe zëri i tij.

— Unë...

- Të lëndova, more bir. Dridhe një cigare!  
— S'e dredh dot. Më dridhen duart.  
— Merre një nga këto që kam dredhur për vete!  
— Do të mbush çibukun.  
— Merre! — dhe i zgjati cigaren e dredhur.  
— Qëllove në shenjë, o xha Lamçe.  
— Ndize!  
— Po e djeshmja u mblodh. Ajo nuk shmbë-shtillet më.  
— Si të duket duhanin?  
— I mirë. I fortë.  
— E kam bërë vetë.  
— Edhe unë vetë e bëja. Pak e sak. Një pjesë ma merrte Zaim aga Çika.  
— Të gjithëve ashtu ua marrin.  
— Po pse të jetë kështu?!
- Lamçe Hyseni thithi llullën.  
Sezaiu shtrëngoi tëmthat.
- Unë them se s'duhet të jetë kështu — vazhdoi Sezaiu. — Nuk më besohet të ketë qenë gjithmonë kështu.
- Sa mbaj mend unë, kështu ka qenë.  
— Po para teje?  
— Kështu thosh edhe im atë.  
— Po më përparrat?  
— S'e di.  
— Kush e vuri këtë rrregull?
- Lamçe Hyseni vuri buzën në gaz.
- Fuqia, more bir, fuqia.  
— Cila fuqi?  
— Fuqja e tyre që kanë të drejtë të venë rrëgulla.  
— Kush ua dha këtë të drejtë?

Bużęqeshja nē skajet e buzëve tē Lamče Hyse-nit u hidħerua.

Térē grupi i udħetarëve qē pushonin nē atē qafé merrte frymë me njē gojē, me njē kraharon, shikonte me njē sy tē vetēm, dëgjonte me njē vesh tē vetēm, mendonte me njē tru tē vetēm.

— Ti ua dhe.

— Unē?! — u habit Sezaiu.

— Po, ti! Ti, unē, ky, ky, ai... tē gjithē ne. Heshtje.

Heshtje e thellē, e rēndē, e ċorodituri.

— I shikon kēto troje? Janē tonat — vazħdoi Lamče Hyseni.

— Tē tē gjithiёve, se i kemi mbrujtur me gjakun tonē. Po prapē mbi gjakun tonē s'jemi zotér. Ai det ēshtē i Vlorës. Ajo fushë ēshtē e Vlorës, po Vlora ēshtē e ngjeshur pas kodrave, sikur tē ketē frikē nga fushā e nga deti i saj. Se ai det ka qenē gjithmonē portē e hapur pēr tē keqen e Vlorës. Andej ka ardhur gjithmonē e keqja. Pó ne gjithnjé e kemi bérē zap. Kēto kodra kanē qenē krahé tē ngrohtē pēr Vlorën. Qē nga kēto kodra ē merrte vrullin ajo, pēr tē kyçur atē portē tē hapur. Kētu ēshtē derdhur gjithnjé gjak, nē kēto troje ulli-shtash. Kētu e kaniē provuar takatiñ tonē. Nā dinin pēr leshko, po hm... Unē kisha njē nusķe stambo-lie, qē edhe nē bythiё tē gjilpérës e kalonte plu-mbin, pa le pastaj nē kokēn me taqin tērē xhufka tē dushmanit. Ne dolém nē qafé.

Ata morën vrapin tatępjietē.

Ishte vrapi i fundit i tyre.

Nuk dinin tjetér veç tē ulerinin e tē bridhnin.

Kush tē shpētoni me parë. Kush tē soste nē skelē mē parë.

« — Dale, more tutkun! » — i thirra një breshkaxhiu që mbante në kokë një taç tërë bishtore këndezi e që ia mbathi vravit kur pa grykën e stambollies sime, po ku dëgjonte ai.

Dyfekun e la rehem përpara këmbëve të mia. Rrugës hodhi gjerdanin. Më tej iu rrrokullis taçi. Brodhi e brodhi, pastaj iu morën këmbët e më t'u rrrokullis edhe vetë si rrrotë mokre tatëpjetë asaj bokërrime. Mua më hipi një gaz që, për perëndi, kush të më shikonte, do thoshte: luajti Lamçja.

« — Lamçë, shkallove?! » — më thirri Zenuni që po merrte nishan nga tre hapa larg meje.

« — Jo, a derëzi — i thashë — po nuk e shikon si po rrrokulliset mavria? Tuaf njeri! Mendon se ashtu do të më shpëtojë. »

« Bjeri, more, malunit, se të iku! » — më tha Zenuni.

« — Jo, a de, se s'ka ku vete » — i thashë e një t'ia drejtar grykën e nuskës. Kaauu! — sokelliti gryka e nuskës.

Atje poshtë më t'u bë burri sa një kokërr arre e pëlltyq pastaj sa gjatë gjerë mu në pellgaçen e bythës së ullirit... Vlorën e shpëtuam, po gjë s'fituam se ne, që ishim, ne mbetëm.

Na përcollën me nga një kile rrush e me nga një qylaf të bardhë në kokë... .

... Po Sezaiu nuk po e dëgjonte më.

Në pulqerët e gishterinje të dorës së majtë, me sytë të shtrënguar si në një gjumë të shqetësuar, po shtypte shtegun e ballit.

Ai nuk i kishte dëgjuar pushkët e luftës.

Ai nuk e kishte parë vallen e vdekjes nëpër illogoret e luftës.

Po ai kishte dëgjuar këngët e fshatit, kur përcollën luftëtarët.

Po ai kishte ndjerë gëzimin e fitoreve, kur e sillte fresku i tymosur i veriut për të hedhur vallë hareje mbi çatinë me rrasa guri të fshatit rrëzë Çikës.

Fresku i veriut mbante erë baruti, prandaj edhe vallet e haresë mbanin erë baruti, prandaj edhe këngët që ngrinte fshati mbanin erë baruti.

Këngët e vogla sollën këngën e madhe.

Vallet e vogla sollën vallen e madhe.

Me këngë e me valle këndonin për trimërinë.

Me këngë e me valle kënduan për fitoren.

Me këngë e me valle e thanë edhe vdekjen e Zenunit.

Sezaiu dëgjonte këngën, e zemra i queshte e i qante.

Sezaiu dëgjonte këngën, e sytë i qeshin e i qanin.

Se Zenuni nuk do të vinte më, po fitorja erdhi.

Se Zenuni s'do të këndonte më, po kënga e tij do të këndohej sa herë që të hidhej fara në tokë, sa herë që të mblidheshin burrat në lëmë për të shirë, sa herë që të lindte ndonjë djalë në fshat, sa herë që të bëhej dasmë fshati.

— C'ke kështu ti? — e pyeti Lamçe Hyseni.

Sezaiu shqiti pulqerët nga shtegu i ballit.

— Për cilin Zenun më fole ti?

— Për Zenun Hajrullahun të fola. E ke dëgjuar?

Merushja uli kokën. Pala e jashmakut të bardhë iu var mbi ballë.

— Eshtë babai.

Dhe Sezaiu mori frymë thellë.

Lamçe Hyseni rrahu verigat e mustaqeve.

— Ngrije kokën ti, nuse! Për trimat duhet mbajtur koka lart.

Ajo mbështolli të birin me palën e sharkut.

— Ishte trim Zenuni. S'e bënte hesap kokën në luftë ai. I pari ngrihej më këmbë e i pari hidhej në sulm. S'e mbante vendi, sa të ngrinim edhe në Vlorë flamurin tonë, sa të hidhnik edhe në Vlorë vallen e fitores.

— Ai nuk e gjëzoi fitoren.

— As ne nuk e gjëzuam.

Rrudhat në ballin e Lamçe Hysenit u thelluan edhe më tepër.

— U kthyem nga lufta me këngë. Shtruam sofra, hodhëm valle e shkrehëm pûshkë, po prapë mbetëm ata që ishim. Se iku i huaji, po mbeti yni. Mbeti ai që ishte. Eh, more djem. Iku ajo kohë e bashkë me të edhe fuqitë tona. Ne u plakëm, kurse ju të rinxjtë na keni mësuar ca zakone të reja. Jeni shkoqur, kokrra-kokrra si kokrrat e misrit e s'dini veç të thoni — ah, të mjerët ne, ç'po heqim!» Jua them këto se më pëlqet zemra, kur shikoj që s'jeni të zot as pér vete.

Na u zu një ditë Afëzi i Meçes me Canen e Ramazan agait. S'ka as tre-katër muaj. E u dërmuan e u gjakosën me njëri-tjetrin si mos më keq. Një çomage i njëjsh pastaj Afëzi Canes, e lë kulaç në mes të sheshit, e frys në pyllin e fshatit. Kur e mori vesh Ramazan agai, i doli shkumë nga tërbimi. U sulën qehajallarët në të katër anët pér të gjetur Afëzin e Meçes, po ku gjendej ai.

«— Të zhduket soji i tij nga faqja e dheiut!» —

Sa pa mbaruar mirë fjalën Ramazan agai, që hajallarët u derdhën në shtëpinë e Meçes.

Plasi kuja e ulërima.

Tërë mëhallë doli nëpër porta. Shikonin e s'luante njeri nga vendi.

«— Jazëk, ju qoftë! — u thashë dy çunave që rrinin duarkryq para shtëpisë së Meçes. — Luani, derra, se sot e kanë radhën ata, nesër e keni ju!» — dhe u sula vetë i pari nga dera e Meçes. Aq duhej, kur s'të shikoje. U shkul tërë djemuria e fshatit e kush me sfurk, kush me sëpatë, kush me hu e kush me dyfek. Qehajallarëve u ngeci veza kryq e nuk dinin nga t'ia mbanin. Sa hap e mbyll sytë, ia behu Ramazan agai mbi dori. E çirrej, e hakërrrehej, e shkumonte agai, sikur t'i kishte rënë ajo e fëmijëve, po kush ia vinte veshin. Rrinte djemuria me ç'kishte në duar gati për t'iu hedhur agait.

E pa pisk mavria.

«— Do të më shihni!» — tha.

Pas dy ditësh redhën xhandarët, po edhe fshati i priste. U bënë të gjithë bashkë e më t'i vunë përpara me hunj e me sokëllima si kope derrash. Shkrehën edhe ata ca pushkë po më hava; sa për emër, se kujt ia mbante ta kthente kokën prapa...

Lamçe Hyseni tregonte, po Sezaiu sikur nuk po e dëgjonte. Se ai kishte humbur larg, larg qafës ku pushonte grumbulli i udhëtarëve, atje te Lugu i Dëllénjës e që aty përpinte me sy kullën mbi shkëmb. Ndryshe nga ç'i ishte dukur herët e tjera i bëhej tani ajo kullë. Prandaj, edhe në kokë i buçisnin ca mendime që s'i kishte përkëdhelur kurrë... «Kulla mbi shkëmb. Shkëmbi mbi fshat. Fshati mbante mbi vete kullën dhe shkëmbin. Kulla lëshonte mbi fshat një hije të rëndë. Porta e madhe e kullës përpinte si një gojë e madhe lubie djersën

dhe jetën e fshatit rrëzë Çikës. Po kush ia dha këtë të drejtë?! Fuqia?! Cila fuqi?! Ku i ka rrënjet kjo fuqi?!

— Fat qeni! — thirri Sezaiu.

— Si the, more?

— Ti ke të drejtë, xha Lamçë.

— S'jeni kader, jo! Si ti janë katandisur të gjithë. Na griu e na çau sherri e hasmëria.

— Ashtu, ashtu vërtet.

Bashkë me këto fjalë Sezaiu përpiquej të rroku-lliste tutje edhe një mal të madh marazi.

— I keni kthyer kurrizin njëri-tjetrit, po për-se? Që të mos jeni për njëri-tjetrin. Që të mos keni kohë e mendje të mëreni me atë që duhet. Po duhen zhdukur këto... dëgjon ti, apo jo? Duhen zhdukur. Po nuk është kollaj ama. Një Selam ishte për këtë punë, po ai shkoi e vate. Një krah tjetër si krahu i Selamit do të na bashkonte ne...

... Vogëlushin e kishte zënë gjumi në krahët e Merushes.

Lamçja soditi një copë herë atë dhe copëzën e vockël të bukës së misrit që shtrëngonte në grusht dora e tij njomëzake. Theu një copë tjetër, e ngjeshi me gjizë dhe ia zgjati Merushes.

— Na! Merre për djalin!

Merushja nuk dintë ç'të bënte.

— Kemi në torbë — i tha ajo.

— Merre, po të them!

— Po më bën borxhli, o xha Lamçë — tha Sezaiu.

— As mos e zërë në gojë!

— Të paça më nder!

— I nderuar qofsh!

Sezaiu u ngrit.

— Rregulloje djalin — i tha së shoqes. — Do të ikim.

— Ju vonova ca, apo jo? — tha Lamçja.

— Mirë bëmë që u vonuam.

— Falmë, në të lëndova!

Merushja po rregullonte djalin në mushkë.

— Mushka jote, apo jo?

— Po, imja, tani s'më duhet më. Do ta shes.

— Ashtu, ë? — dhe Lamçja iu afrua mushkës.

Ajo lëvizi pak më tej.

— Se dua të mbaj shpirtin gjallë — u shpreh hapur Sezaiu.

— Unë për të blerë ndonjë mushkë zbrita.

Sezaiu e mati një herë me sy të picërruar.

— Sa ta marrë ndonjë tjetër, më mirë merre ti.

— Sa do?

— Unë s'di sa bën. S'kam shitur ndonjëherë.

Lamçja vuri dorën në qafën e mushkës.

— Qenka e re.

— Pesë vjeçe.

— Edhe e shëndoshë.

Sezaiu kapërdiu pështymën. Nxori shubekun dhe e mbushi çibukun me duhan.

— Samari qenka ca i vjetëruar.

— I vjetër është. Në një dy vende e kam kapur me strufe.

— S'ka gjë, se më rrëgulón Rexha mua — tha Lamçja dhe nxori qesen që kishte varur në një gjalmë në qafë.

... Bashkë me ata u nisën edhe fshatarët e tjerë, që zbrisnin në Vlorë për ditë pazari.

Grumbulli i tyre shkau si nëpër një shteg të ri në rrugën dredha-dredha që të conte për në hyrje të qytetit.

## VI

### NE PRAK TE VLORES

Në hyrje të qytetit, të parin bërryl rruge e zë spitali që ndërtuan italianët pér t'u shëruar plagët që u hapën lebërit varganëve të tyre.

— Spitali — tha Lamçe Hyseni. — Thonë se aty kanë ardhur e punojnë ca italianë e ca italianka.

— Si, more?! — u çudit njëri prej udhëtarëve.

— Mos u çudit kaq shumë ti! — ia priti një tjetër. — Do të shohësh edhe të tjerë. I ka prurë mbreti si ustallarë.

— Këtu e mbyllën edhe Zenunin, që rahmet i pastë shpirti! Donin ta shëronin e ta varnin pastaj në qytet pér t'u kallur frikën vlonjatëve. Hej, se ç'dif që ishte, mavria! Natën e asaj dite që luftuam në qafë, erdhëm fshehurazi këtu që të merrnim barëra pér të plagosurit e çetës. Në diktyuan kur po dilnim nga spitali dhe na qëlluan. Zenuni na dha urdhër që të iknim në me barërat, kurse vetë mbeti pér të na ruajtur krahët. E plagosën në bark. Ne e pamë kur ra, po ai edhe i plagosur urdhëra

jepte e pushkë bënte. Barërat i çuan në çetë, po ai mbeti aty pranë telave me gjemba të gardhit të spitalit. Në sallën e thikës i çanë barkun, siç na tregonte një italian që e kapëm rob më pas, i nxorën plumbin dhe e qepën prapë. E vunë në një dhomë me roje te dera e me infermier te koka. Doktori hynte e dilte, kurse Zenuni bënte sikur s'i kishte dalë bari i thikës. Iku ajo natë, erdhi dita tjetër. Iku ajo ditë e po vinte prapë nata, po ai në gjumë. Doktori e oficerët u tronditën. U turrën të gjithë në dhomën e tij më gjilpëra e barëra në duar. Kur e zbuluan, ç'të shihnin! Plaga ishte shqyer e gjaku i ngrirë kishte mbuluar krevatën. Duart e Zenunit kishin ngrirë në të dyja anët e plagës së shqyer, kurse ai sikur flinte, pa një rrudhë dhembeje në fytyrë.

Sezaiu ktheu kokën prapa.

Godinat e bardha të spitalit, dafinat e dendura dhe gardhi me telat e lidhur nëpër hunj të nxirë, që zinin atë bërryl rruge, iu përzien.

Ai kishte dëgjuar edhe më parë që i ati ishte plagosur e kishte vdekur në spital, po asnjëherë nuk i kishin thënë se si kishte vdekur, asnjëherë nuk i kishin thënë se si i kishte mposhtur ai italiannët, asnjëherë nuk i kishin thënë se si u madhërua ai mbi vdekjen.

— O nëno, i ziu! — klithi një zë fëmije përpara grumbullit që zbriste pér në Vlorë.

— Frrau!.. Frrau! Frrau!.. — kërciti pëllëmba e xhandarit në faqen e tij të zeshkët e të rrreshkur si lëkurë fiku.

— Hë, pa tanë ta tregoj unë ty, more këlysh evgjiti, se si rrëmohet në plehrat e spitalit! Frrau! frrau! Frrau!

— O-o-o, i ziu!

— Ç'ke me tē, more xhandar? Lëshoje, se ia more shpirtin!

— Hajde, more, shiko rrugën tēnde ti e mos m'u bëj kismet pér ca ditë tē mira nē birucë!

— Po ç'të bëri, xhamën, që e rreh ashtu? — dhe Lamçen s'e mbajti më vendi.

Sezaiu bëri një hap pérpara. Vogëlushi i tij ia plasi tē qarit nē majë tē mushkës. Lamçja ia rrëmbeu djaloshin xhandarit nga duart. Tërë grupi i udhëtarëve ishte bërë si gardh rrëth Lamçe Hysenit e xhandarit.

— Ç'të keqe tē bëri, që e rrahe?

— Pse i trazon plehrat?

— Kér - kér- kérkoja kothere buke! — u ngashërye fëmija.

— Prandaj e rrahe ti?

— Mbretëria ka rregulla.

— Ne s'kishim bukë. Ne gjithnjë s'kemi bukë. Unë gjithnjë kam mbledhur kothere këtu. Ne... Ne kemi uri...

— Mirë, mirë. Ikë tani! Ikë nē shtëpi e mos rrëmo më nē këto pisllëqe! Hë, djali i xhaxhait! Ikë tani! — urdhëroi Lamçe Hyseni, duke mos e përbajtur dot zemërimin ndaj xhandarit.

Vogëlushi u nis pak me drojtje, duke fshirë sytë me noçkën tërë lyrë tē dorës.

Rrohdhkat e zeza tē flokëve i ishin varur deri poshtë qafës së hollë e tē gjatë. Shojet e këmbëve tē zbatura i qenë bërë plasa-plasa, si lëkura e rrekur e një kokrrë fiku.

Ai ikte e herë pas here kthente kokën prapa, derisa më nē fund u lëshua nē vrap.

— Veç mos tē më bjerë më në duar! — shfreu xħandari dhe ktheu kokën nga gardhi i burrave e, si skermiti një herë dhembet e rënë vende-vende, i pērshendeti me një «hajd njatjeta» dhe béri pēr-pjetè rrugës së spitalit.

— Kush ka dru pēr tē çarë? Kush ka dru pēr tē çarë? — kumboi aty pranë një zë i fuqishém, që mēshonte me tērē forcën mbi fjalën «kush», sikur zéri i tij tē ishte səpata, e fjalà «kush» një trung i trashë lisi.

... Lagjja me shtepitē pērdhese dredhonte buzës së kalldrëmit, që zvarritej rrëzë kodrinave sikur tē kishte frikë nga e tatēpjeta e qytetit.

Shtëpi tē ulëta.

Strehët e varura deri afér një metér mbi kall-drëmin e rrugës si ca krahë tē lodhur e tē pa-fuqishém. Mure tē dobëta tē ndërtuara me gurë gipsi e baltë argjile. Porta tē kalbura, tē mballosura me ca copëza tē ndryshkura llamarinash.

Tek-tuk mbi muret prej gurësh gipsi e argjile tē bardhë zgjateshin ca skelete degësh fiku tērë zgjebë.

— Këtej rri ti? —

Djaloshi që pyeti Sezaiu mbajti këmbët.

— E, këtej.

— E njeh një Qani, Qani? Qani Beshiri i thonë?

— Qani Beshiri?

— Po. Mësues ka qenë. I gjatë, flokëverdhë. I kuqërrremtë.

— S'ka nga këta këtu. Banorët e kësaj lagjeje kanë lëkurë tjetër..

...  
Ja dhe qyteti.

Që aty, një rrugë e gjerë zbriste si grykë lumi.

E gjerë, e drejtë, midis ca kopështe me gjerdhe kallamash.

Në të dyja anët e saj ca shtylla të kërrusura telefonash. Shtylla të mbushura me tela që lëshonin një hungrimë të mbytur, të pandërprerë, monotone.

Rruga fillonte me një përrua të zbuluar që hynte qetësish nën rrugë nga juglindja e derdhej me vërtik nga veriperëndimi, duke gurgulluar aty poshtë me një shkumë të zezë si shkumë zhuma-reje. Pak më tej, midis një kallamishteje të dendur, shkumëzimi sikur mekej, rrjedha kthehej në një pellg lere të zezë, që në dimër e në verë kundër-monte erë qelbësirë.

Aty fillonte rruga e mbaronte poshtë me një shesh të gjerë plot me dyqane të vogla të ngjeshura me njëri-tjetrin, si për të siguruar brinjët.

Vende-vende muri i dyqaneve thyhej e nëpër ato të thyerë çaheshin ca gojë rrugicash që të çonin nëpër të gjitha anët e qytetit.

Në mes të sheshit, si një karakoll i skalitur në gurë të bardhë, ngrihej xhamia Tabakhane me një minare që ngulej, si pykë në kaltërsinë e kulluar miengjerezore të qillit të Vlorës.

## VII

### PAZARI I VLORES

Pazar.

Ditë pazar.

Mbi pazar, si një iso e stërgjatur, rrinte pezull kumbimi i çekanëve të teneqexhinjve e vareve të kovaçëve.

Një iso e zgjatur, e tymosur, e djersitur.

Grupi i udhëtarëve, me Sezainë në gjirin e tij, sa zbriti në pazar, u përpush, u shpërnda sikur të mos kishte qenë kurrë.

— E? — e pyeti Sezainë Lamçja — do të vish me mua?

— Zbrite djalin! — i tha Sezaiu Merushes — shkarkoje mushkën! — dhe ktheu krahët.

— Kam një mik këtu. Nallban është. Dëgjon, Sezai? Vemë atje sa të çlodhemi pak?

— Jo, jo! Shko ti.

— Dua të të njoh me të. Është burrë që s'e ka shokun.

— Po të jetë i mirë, do të më çojë fati tek ai.

— Si të duash. Nuk të detyroj, po qejfi ma donte të të njihja me të.

— Urdhëro! — tha Merushja dhe i zgjati frerin e mushkës.

— Po të mbetesh keq, kërkoje! Rexho Nallbani i thonë. I thuaj se të ka dërguar Lamçe Hyseni. Hajde, mbeç me shëndet!

— Të dëgjofsha zérin e mirë! — iu përgjegj Sezaiu.

...Mushka zvarritej pas frerit të tendosur me ca sy të shqyer nga frika.

Sezaiu psherëtiti thellë dhe mbushi çibukun pa guxuar ta ngrinte kokën. Shtegu i ballit i theri e tëmthat i rrähën me dhembje. Çibuku i dridhej në dorë.

Merushja shtrëngoi sytë me cepin e jashmakut të bardhë.

Vogëlushi u mat të vraponte pas mushkës.

— Aty ti! — u hakërrua Sezaiu.

Ai çakarriti sytë.

— Po mushka?!

— Merre nënën për dore!

Po atij i mbeti koka nga mushka.

Mushka zvarritej pas litarit të tendosur.

Isoja e çekanëve të teneqexhinjve dhe e vareve të kovaçëve mbrynte ajrin e ftohtë të janarit.

Ata të tre në prak të pazarit.

Në këmbët e tyre dengjet me plaçka.

Përpara tyre pazar, që përpjui në gjirin e tij të rrëmujtë Lamçe Hysenin dhe mushkën.

Pazar si çdo pazar.

Pazarin e bëjnë njerëzit e sendet, prandaj edhe pazarë është plot me njerëz e me sende.

Njerëzit në pazar janë të huaj për njëri-tjetrin.

Secili bën atë që do, blen atë që do, aq sa mund të blejë, megjithëse ka edhe nga ata që blejnë sa u duhet edhe ca pér rezervë, po këta janë të rrallë.

Në orët e para pazari zjen nga rrëmuja. Ata që duan të shesin çirren pa pushim pér tē reklamuar atë që duan të shesin, kurse ata që duan të blejnë, thartojnë turinjtë para sendeve që u nevojiten.

Kështu e ka kjo punë. Njera palë lëvdon, tjetra pérçmon.

Prandaj edhe i thonë pazar.

— Fasule Velçe! Të mira, të lira!

— Lesh, lesh! Merrni lesh!

— Hajde, një gomar tē mirë! Merrni një gomar tē lirë!

Përmes turmës së njerëzve, Sezaiut iu duk sikur shkau në një rrjedhë tē re, tē ngjeshur, tē ngrohtë e tē gjallë, që shtyhej herë në njerën anë e herë në tjerën.

Aty gjithshka ishte në lëvizje, në një lëvizje të zhurmshme, si brenda një unaze tē madhe, tē padukshme.

— Hajde, një gomar tē mirë! Merrni një gomar tē lirë!

Mbi kokën e qorrit që reklamonte «gomarin e mirë e tē lirë», fiksuar në një tellaje tē madhe të veshur me beze tē bardhë, qeshte fytyra e një kamerieri, trashaluq me faqet flakë tē kuqe e me zverkun tē humbur midis supeve. Në dy duart e ngritura përpjetë mbante, në dy pjatanca porcelani, dy torta allafrënga. Trupi i tij humbiste prapa fjalëve tē shkruara me germa kapitale në një gjuhë tē huaj. Nën fjalët e shkruara në gjuhë tē huaj, midis kllapave, shkruhej me germa më tē vogla:

(ASSORTIMENTE MIELLI E SHEQERI NGA  
TË GJITHA LLOJET; TORTA, KREMA, BONBO-  
NE, KARAMELA, ÇIOKALATINA, SHITJE ME  
PAKICË E ME SHUMICË GJENI NË PASTICERINË  
MË MODERNE TË KOHËS,

NASIP KUKA E VËLLEZËRIT.)

— Ama, gomar që..!

«Kështu do të thërrisja dhe unë për mushkën,» mendoi Sezaiu dhe pa një herë rrëth e rrötull, se iu duk sikur foli fort e pati turp mos e dëgjuan të tjerët.

— Pse, si të duket ty?

— Kërmë.

— Me këto vithe?! Tuaf njeri! Kam njëzet vjet që shes gomarë, po gomar kaq të mirë e kaq të lirë nuk më ka bërë vaki të shes.

— Pa hapja dhëmbët!

— Brisk i ka.

— O, të kegen, ore! Si dhëmbët e xhi Sanos.

— Shikoje, shikoje mirë!

— C’ti shikoj? Katër dhëmbë e asnjë dhëmballë!

— Po pse ore, ka dhëmballë gomari?

— Si s’paska?!

— Atëhere s’i kanë mbirë ende.

...Megjithatë, kur pa Sezaiu se të gjithë këtë punë bënin, bile midis tyre kishte edhe nga ata që e bënin fare pa të keq e, kur thërrisni, mundo-heshin ta zbukuronin zërin, se, doemos, një zë i bukur e i shkoqur dëgjohet më me ëndje, iu duk se edhe atij do t’i vinte zëri, tamam si Skëndos, kurrë dërgoi xhi Zenepja me një matara qumështi krahëve

për ta shitur rrugicave të Vlorës. I shkreti Skëndo, kishte bredhur tërë ditën e, kur ishte kthyer në fshat me mataranë plot, i kishte thënë së emës:

— Nuk e shita dot. Ja tek e ke.

— Pse, të keqen nëna — e kishte pyetur e habitur xhi Zenepja — nuk e hanin qumshtin në Vlorë!?

— E hanin, moj nëne, e hanin po, që të shisje, duhej të thërrisje.

— Po ti, pse s'thërrite, kurban nëna, apo s'kishe zë?

— Kisha zë, moj nëne, kisha, po kisha edhe turp.

— Filloje që larg, të keqen nëna, që pa vajtur në Vlorë! Avash-avash e shtruar-shtruar, pa të ikën turpi vetiu pastaj.

Dhe të nesërmen e nisi prapë.

Kur u kthye Skëndua me mataranë bosh, xhi Zenepja po e priste te praku i portës.

— E — e pyeti ajo — e shite?

— E shita, po lëre mos më nga! E fillova si më the ti. Në fillim si me vete, pastaj shtruar e më pas me të sokëllitur. Kur sokëllita për herë të parë, kërrrrrrtauu ma bëri mu në mes të vetullave.

— Eshtë delli i ballit, të keqen nëna, të ka plasur delli i ballit.

Kur kujtoi këto, Sezaiut iu duk se kjo histori kishte ndodhur edhe me të gjithë ata të tjerët, prandaj edhe vuri buzën në gaz, i bindur se kështu do të kishte ndodhur edhe më atë.

— Merrni djathë! Merrni djathë!

— Erdhi kukureci! Erdhi kukureci! Delja nga Dukati, kripa nga Zvérneci!

— Kukurec me zorriqe, ore!?

— Pse, si e do zotrotë?

— Me kolloface, ore! Si kukureci i xha Malos, që të shkrin në gojë!

Të gjithë thérresnin, po asnjë nuk blinte.

Kështu është në pazarin e mëngjezit. Myshterinjtë vetëm sa vijnë rrötull brenda asaj unaze të padukshme. Kjo i ndez edhe më tepër ata që duan të shesin.

Ngrihet zëri. Ngrihet volumi i reklamit.

Ata që shesin, vërtet që ulen në bisht përpara mallit të tyre po, kur thérresin, e ngrenë kokën lart e në qafë u ngrihen si shkopinj damarët mavi. Sikur t'i zhvishje nga rrrobat që mbanin, t'ua ngjyeje pak edhe lëkurën me zhumare ulliri, t'ua shpupurisje flokët e t'ua shkulje verigat e gjatë të mustaqeve, në këtë gjendje nuk do të ndryshonin shumë nga Tarzani që, midis degëve të dendura të pyllit tropikal, duke ulëritur, ishte fiksuar në reklamat e kino «Reksit» që kishin zënë të gjitha faqet e lira të mureve në sheshin e pazarit.

Po le të çirrej sa të donte Tarzani midis degëve të dendura të pyllit tropikal, se mbi zërin e tellallit s'del dot as zëri i atyre që shesin e as zëri i tij.

— Eeeej, milet!

Zërat e tjerë shuhën fare para zërit të tij, se punën e zërit ai e ka zamat.

— Eeeej, milet! Ka humbur një kuletë!

Sezaiu ktheu kokën dhe rrudhi fytyrën.

— Kush e ka parë, kush e ka gjetur, t'i dojë qejfi, ta rrëfejë!.. Eeeej, milet! Ka humbur një kuletë! Kush e dorëzon, hallall ka një napolon!

— Fiuuuu!... E majme paska qenë!

— Llastik, apo lëkurë?

— Lëkurë, lëkurë... Eeej, milet..!  
— Simite, qahira, të bardha, të mira!  
... Duke çarë me vështirësi gjirin e ngjeshur  
të turmës, Sezaiu me të shoqen e të birin dolën në  
një vend pak më të qetë e më të lirshëm.

— Ulemi këtu!

— Ulemi — pranoi Merushja.

— U lodhëm.

Ajo i fshiu qurret të birit.

— Po ti, u lodhe?

— Jo.

Ai lëshoi dengun e mbështjellë me velenxë e  
mbi të lëshoi sharkun. Rahu masatin fort pér  
stralli, ngjeshi eshkën në çibuk, thithi tym të vaktë  
dhe hodhi sytë nga turma.

Sezaiu u ngrit me rrëmbim e pastaj u têrroq  
shpejt e shpejt.

— Ptfu! Ta marrë djalli!

— Ç'pate?

— U ngatërrova. Pér pak u turpërova!

— Me kë?

— Ja ai burri atje m'u duk si Qaniu — i tha  
ai Merushes.

Një copë herë, të dy burrë e grua heshtën me  
sytë të ngulur në gjirin e turmës.

— Kështu është këtu — tha Sezaiu papritur.

— Kjo është Vlora?

— Në Vlorë jemi.

— Sa e madhe!

— Ky është vetëm pazari.

— Pse, ka edhe më?

— Dhjetë hise më shumë.

— Korba!

— Ç'pate?

- Do të humbasim!
- Nuk humbet njeriu në mes të njerëzve.
- ...Djali ka uri.
- Edhe ne kemi.
- Ne durojmë.
- Hej, ti!.. Ti, more!.. Sillna tri nga ato!
- Simite apo qahira?
- Hë, more, simite sill!
- Me gjalpë apo me mjaltë?
- Pa gjë.
- Sa the, katër?
- Tri, tri.
- Peqe!.. Urdhëro!
- More, do të të pyes.
- Urdhëro e pyet!
- Mbështetja ka zënë veshi emrin Qani Beshiri?
- Qani Beshiri?
- E, mësues. E kam patur në fshat.
- Në cilën lagje banon?
- Mbaj mend që më thoshte: «po zbrite në pazar, e gjen kollaj shtëpinë time».
- Jo, besa! Turp të të gënjej!
- Sa bëjnë simitet?..
- .....
- Eeeej, babam! Mos u ul aty, se do të më rrëzosh tezgën!
- Qebap, erdhi mezeja! Ja valon, ja përvëlon! Erdhi mezeja!
- Merrni taze vezë të ziera, iku krushka, erdhi vjehrра... Merrni taze vezë të ziera!
- Avash, ore vëlla, avash! Këtu e gjete të hash ti?! Eeeej! Do të më shkelësh thesin, ore! Shko, ore, ha te xhamia! Atje është vendi për të ngërënë!
- Taksën!

- The gjë? — e pyeti Sezaiu.  
 — Ti tjetri! Taksën! — dhe me dorën e djathtë  
 lëmoi verigat kuqaloshe të mustaqeve.  
 Sezaiu u hoq mënjanë.  
 — Urdhërove gjë, zotrote? — e pyeti i zoti i  
 thesit.  
 — Taksën!  
 — Po unë sa e lëshova thesin! S'kam bërë sefte  
 ende!  
 — Kurrë mos bëfsh! Taksën dua unë! Ka rre-  
 gulla mbretëria!  
 — Për perëndi! S'kam asnjë grosh!  
 — Kurrë mos paç! Jepe ujem!  
 — Ku ka këtu pér ujem?!  
 — Kurrë mos pastë! Aq më bën mua!  
 — Ja, ika fare.  
 — Jo, jo, jo, jo!.. E zure vendin? Hopa, taksën!  
 — Po me se, more vëlla?  
 — Punë pér ty ajo.  
 — Allahu heqber, allahu heqber! Lahilahila-  
 llah, Muhamedin resulullah!.. — u lëshua nga pyka  
 e minaresë si një piskamë e çjerrë zëri i efendit.  
 — Eeeej, milet! Ka humbur një kuletë!..  
 — Merrni gjizë!  
 — Taksën!  
 — Merrni një gomar të mirë! Merrni një go-  
 mar të lirë!  
 — Gomar i thënçin!  
 — Jep pazar, zotrote!  
 — Tobe e stafkurullah!  
 — Më placin sytë! Eshtë goxha gomar!  
 — Taksën!  
 — S'kam.  
 — Thesin!

- Aman, se më there!
- Hy, të thertë Kuzubabaj!
- Kau!.. Kau!.. Kau!
- Bobo, e vranë!
- Kë vranë?
- Kush u vra?

Turma u lëkund sikur ato tri krisma të kishin goditur në gjirin e saj.

Hingëlliti një pelë.

Dy kuaj, njëri i bardhë e tjetri kuqalash, çanë përmes turmës e morën të përpjetën e Çesmës së Mademeve.

- Uuuu!.. Uuuuu! Uuuu!..
- Plasja në grykë!
- I ziu, më vranë aganë!
- Xhandarët u derdhën midis turmës. Me ta shkoi edhe ai që kërkonte taksën.
- Rrofsh, o aga, se më shpëtove!
- Hy, të rroftë e të shkurtoftë!
- C'pate ti, ore?
- Cili aga të rrojë?
- Ai që u vra!
- Po ai vdiq! Qysh të rrojë?
- E, ore, o! Paske takat ti!
- Uuuu! Uuuu, më vranë aganë!
- Kush ta vrau, more mavri?!
- Hasmi!
- Hasmi?
- Hasmi, more, hasmi! I ziu, c'më gjeti pëi aganë! I ziu, si do t'i them hanko Zylkadesë! I ziu, ç'do t'i shpie hanko Zylkadesë!
- Mbuloje, se na kalli datën!
- S'më bën zemra ta mbuloj.
- Shikoje, se mbase s'ka vdekur.

— Vdiq, more, vdiq! E kanë marrë të tre në kokë!

— Paska patur dorë burri!

— Mblidhja trutë, mos ia lërë sheshit, se është gjynah.

— Amani, një haraba!

— Një haraba!

— Eeeej, një haraba!

— Harabaxhi!.. O harabaxhi!

— Këtej, këtej!

— Erdhi, erdhi!

— Hapuni! Erdhi harabaja!

Dhe turma hapi rrugë.

Kali i harabasë shkrofëtiti. Zilet në qafën e tij shkundën një tufë tingujsh të bronxtë.

Kali përplasi disa herë këmbën e parë në truall.

Atje u bë një gropë e vogël. Përtej u hodhën cifla dheu.

— Merrni një gomar të mirë! Merrni një gomar të lirë!

— Atë kërmë, bën të mirë ti?

— Uh, i marrsh, të ligat! Këto vithe do të shash ti?!

— Mblidhja trutë me një shami! Mos ia lërë sheshit, për qentë!

— Eeeej, milet! Ka humbur një kuletë! Kush e ka parë, kush e ka gjetur, t'i dojë qejfi ta dorëzojë!.. Kush e dorëzon, hallall ka dy napolona!

— Ia ke enjtur vithet me shkopinj tū, dhe kérkon të ma rrasësh mua!

— I ranë tespijet. Merri tespijet e agait!

— Erdhi zoti Memduh! Erdhi zoti Memduh!  
Hapuni, se i bënë gjémén të ziut!

«O në Karabash-o, po bie qemania,  
Në spitalo, seç ka rënë Pajamja.  
O-o-o, qenke për të dashur!  
O-o-o, ti, o moj, Rreeme!..»

— Dridhe, Xhiku!

— Nëm një çereke, pa e dredh unë.

— Vëëllaaa! — klithi zoti Memduh Rushiti  
me sa i hante gryka dhe, si një thes i zi, i madh, u  
lëshua mbi kufomën e gjakosur të Myslym agait.  
Rrotat kërcitën.

Karroca u shkund disa herë me vërtik.

Kali turfulloj e hingëlliti. Hingëllima e tij  
mbysi kujen e zotit Memduh Rushiti.

— Një grosh, po deshe!

— Groshët nuk shkojnë. S'ka rënë pazari  
ende. Një çereke, po ta mbajti!

— Hajde pesë grosh e një cigare!

— Ikë, ore, pirdhu tutje! Të tjerët s'po ulin  
«fasulet», unë të ul këngën! S'qenke sagllam, zo-  
trote! Të paska bërë nënokja qibar nga trutë!

Mbi tendën e karrocës doli një kokë e bardhë  
me dy sy të mullosur, të çakërdisur, të përlotur.  
Nën kokën e bardhë u ngrit një trup i zi, i bëshëm,  
i drejtë. U ngrit e u ngrit derisa doli i téri mbi  
tendë.

Vetëm këmbët mbetën poshtë tendës.

Në të dyja duart dy pistoleta.

Metali i zi i tyre feksi.

Zoti Memduh Rushiti mbështolli turmën në  
sytë e tij.

Në sfond një copë qiell i kaltër dhe një pllakat  
me fushë të verdhë. Në fushën e verdhë të pllakatit,

një amvisë e bukur me duar të zgjatura përpara në drejtim të maqinës qepëse të piktuuar deri në imtësitë më të vogla. Midis amvisës së bukur dhe zotit Memduh Rushiti lexohej «N E C C H I» dhe disa copëza të shkëputura fjalësh.

— Kush?.. Kuuuush? — thirri zoti Memduh Rushiti pa i ulur duart me pistoletat. — Kuuuuush? gulçe-gulçe dilnin dhe fjalët, se pikëllimi ia kishte ndrydhur gjoksin e ia kishte shtrydhur fytin.

— Hasmi!

— Haaasmiiii? —

Të dyja duart e tija u shkundën. Dy batare krismash u ngjitën përpjetë qiellit.

Amvisa e bukur vazhdonte të buzëqeshte.

Karroca çau përpara.

Sezaiu psherëtiti. U shkund si nga një gjumë i thellë e i gjatë dhe thithi çibukun.

— Paska edhe burra në këtë botë!

— Si the? — e pyeti Merushja.

— E vranë një aga.

— Këtu nuk po shikojmë asnje të njojur.

— Ai qen duhej vrarë!

— Po vete dreka. Do të na zërë nata përjashta.

— Kusari!.. Kusari!.. Kapeni kusarin! — u dëgjua një zë nga gjiri i pazarit.

— Ku, more?

— Zëre, të zëntë për gryke, se të shkau nën hundë!

— Çfarë vodhi, shejtani?

— Eeeej, millet, ka humbur një kuletë! ..

— Avash, more, se më dërmove! — po djaloshi, që u përplas në gungën e kurizit të tellallit, fryu në gjirin e turmës duke thirrur:

— Kapeni!.. Kapeni!.. — dhe preu në kthesën e sheshit të Kateqit.

Fshatari që bridhte pas tij ndaloi.  
I merrej fryma.

— Ptfu!.. Rasat i keq!

— Çfarë të vodhi?

— Pesë lekë.

— Qaje, se ia rrrove bishtin!

— I hëngërt gjak e ilaçë!

....

— Janë shtuar hajdutët.

— Hajdutët i pjell koha. Populli vuan për bukën e gojës. Buka është e shtrenjtë. Populli s'ka para. Paraja po zë myk në baulet e agallarëve. Me ata që shesin, s'bie dot në ujdi. Kërkojnë nënën dhe babanë. Duhet të presësh tërë ditën për të blerë një qase misër, se pazari në darkë bie...

Sezaiut iu duk si zë i njojur.

Ktheu kokën, por jo. Prapa krahëve të tij qëndronin dy fshatarë. Vërtet me veshje labi po, sa burra ka labëria që kanë një zë e një shtat, aq të mira qofshin.

— Për misër ke ardhur?

— Për misër.

— Keq e paske!

— S'më mbeti fare nga i arës. Kam vetëm farën.

— Keq, keq!

— Kështu mbeti fshati ynë sivjet. U zverdh që pa lidhur, s'punoj moti.

— Shyqyr i qoftë!

— Po shesin berrat për një kafshatë bukë.

— Mjerë ata, që s'kanë as berra!

— Ta marrë djalli!.. Nejse... Të vaftë mbarë!

— Shëndoshë!

Sezaiu i pa kur u ndanë.

Ata ikën secili i kërrusur nën malin e hallevë të veta. Atij i rrähën témthat. Biseda e tyre e lëndoi, i rëmoi një plagë që po i dhimbte ende. Një plagë të vjetër, po që tanë po vuante dhembjet e saja.

— Dua bukë! — u ndie zëri i vogëlushit.

— Plaç të preftë!

— Ka uri — e mbrojti Merushja.

— Hëngri një herë!

— Iu tret.

— Allahu heqber! Allahu heqber!..

Kësaj radhe zérin e efendiut e sulmuani kambanat, ndërsa ai zgjaste e zgjaste zverkun që të thërriste sa më fort, përtë mbuluar më zérin e tij jehonën e kambanave. Si e pa që kështu s'i doli gjë në vijë, vendosi të mos pushonte së thirruri ezan pa mbaruar kambanat. Po, kur pushuan ato, atij s'i kishte mbetur më zë. E shtrydhi edhe disa herë gurmazin e, si u bind që ai s'bënte më përtë thirrur, u fut në derickën e minaresë dhe zbriti shkallëve spirale, duke shukur kokën nëpër basamakët e gurtë.

— Ç'u bë ai me thes?

— Ku e di unë! — u përgjegj Sezaiu!

— Këtu, me ty ishte!

— Jo me mua.

— Kodoshi! Kujton se do t'më shpëtojë pa paguar taksën! E pe nga shkoi?

— Jo — tha Sezaiu dhe ktheu krahët.

— Nuk do të tregosh, ë?

— As e pashë e as e njoh!

— Sa mirë që e përdridhke! Mua do të ma

hedhësh ti? Pa dale një herë! S'të kam parë herë tjetër këtu ty! Nga je ti?

- Këtej.
- Si këtej?
- Fshatar!
- E shoh. Nga q'fshat?

— Ikim, Sezo, se po na bëhet vonë! — ndërhyri Merushja e shqetësuar nga qëndrimi këmbëngulës i xhandarit!

- Do të ikim, do të ikim.
- E gjeta! — thirri xhandari e u sul me vrap më të djathët.

Aty te shtylla e telefonit, pranë derës së dyqanit të xhokaxhiut, kishte lëshuar thesin e po dridhite një cigare fshatari që s'kishte me se të paguante taksen. Xhandari e shkundi nga krahu.

— A, qerrata, a, qerrata! Kujtovë se do të ma hidhje? Hajde, kruaji xhepat!

- S'kam!
  - Prandaj m'u fshehe, ë?
  - Se mos jam vetëm unë që po të fshihem, po pse, të shkretën, m'u qepe mua?!
  - Se po më bën naze, prandaj!
  - Hej, bela!
  - Belaja mos t'u ndaftë!
  - Po prit, more i uruar, prit, sa të shes të paktën një okë, pa ta jap unë taksen!
  - Pres unë, po, s'pret ligji!
  - Le të presë edhe ligji, se s'bëhet kiameti.
  - Kiameti bëhet, kiameti, që ç'ke me të!
  - Po le të bëhet, de, se ma plase shpirtin!
- S'kam, e nuk e paguaj!
- Kujt i kundërshton ti, more viç ferrash?!  
Po e di ti ç'të bëj unë?

— Asgjë s'më bën dot! Dy duar për një kokë janë!

— Taksën, se ta mora shpirtin! — dhe xhandardari vuri dorën në pistoletën që kishte varur në brez.

— Nxirre de, të shkretën, se më plase! O shkrepe, o hidhe në hale!

— Mua?! Mua?! Mua të m'i thuash këto fjalë ti.... ti... gjithë ti, bashte ferrash! Mua që... që... po ju?! Ç'kërkoni ju këtu?.. Qërohuni që këtej!.. Marsh në punën tuaj!.. — po asnjëri nga ata që ishin mbledhur rrëth shtyllës së telefonit nuk donte të largohej. Kishte midis tyre djem të rinj, burra të moshuar, qytetarë e fshatarë e prapa tyre edhe Sezaiu.

— Të prishim punë? — pyeti një djalosh flokëzi e shpatull-gjerë, i veshur me një palë kominoshe të arnuara në bërryla e në gjunjë.

— Shikoni punën tuaj ju!

— Pse i bie në qafë atij? — pyeti djaloshi me kominoshe.

— Se s'don të paguajë taksën:

— S'ka me se ta paguajë.

— Kurrë mos pastë! Ligji do taksën!

— Punë dreqi është edhe kjo puna e ligjit!

Gjithnjë kërkon, po asnjëherë s'jep!

— Çfarë të të japë ligji?

— Atë që më mungon.

— Atë që të mungon, nxirre me djersë! — vetulla e majtë e xhendarit u ngrit si pykë përpjetë.

— S'ka më djersë! Djersën e piu ligji!

— Ligji!?

— Po, ligji! Nuk e kupton? Ja, dëgjo, se ta shpjegoj unë. Ligji del nga mbreti, vete te «dovleti», nga «dovleti» zbret te «mileti». Kur vjen ligji, «mileti» dridhet si nga iletia, se ligji, gjen e ç'gjen,

e merr nga «miletì» e çon te «dovleti», nga «dovleti», e çon te mbreti... e kështu fryhet mbreti, qesh «dovleti», qan «miletì».

— Si the, more pizeveng?!

— Mos i bjer më qafë atij! Ai ka ardhur nga ana e anës që të shesë një karroqe fasule për të nxjerrë ndonjë lek për bukë e barëra.

Grumbulli i njerëzve rreth tyre po shtohej.

Fshatarë e qytetarë dëgjonin me veshët bigë ato që thoshte djaloshi me kominoshet e arnuara në gjunjë e në bërryla. Hidhej e përdridhej xhandari e kërcënonte duke nxjerrë nga goja bashkë me fjalët edhe një spruce jargësh, po djaloshi s'luante nga vendi.

— Kot e ke! Me britma s'e shuan dot varfërinë e këtyre.

— Frrrrriiiuuu! — fryu bilbili i xhandarit.

— Ikë, se do të të kapin!

— Le të më kapin. Puna është që këta të mos na pandehin për kafshë. Edhe ne jemi njerëz, duam që edhe me ne të sillen si me njerëzit, jo si me kafshët.

— Cilët këta?

— Ti me shokët e të mëdhenjtë e tu!

— Ne i shërbejmë Naltmadhërisë së Tij!

— Shërbeni, po na lini edhe ne të jetojmë!

— Të gjithë jetojmë.

— Vërtet, të gjithë përpinqemi të jetojmë. Ti dhe ata të sërës sate — me atë që rrëmbeni të gatshme nga ne, kurse ne me atë që mezi shpëtojmë nga thonjtë tuaj. Po njerëzit lindin njëlloj e njëlloj duhet të jetojnë.

— Bollshevik! Komunist!

— Po të jetë kështu si thotë ky komunizmi, ne

paskemi qenë qorra! — thirri dikush nga gjiri i turmës.

— Rrebelizëm! — Frriiu! Frriiu! Frriiu! —  
i fryu bilbilit.

— Erdhën xhandarët!

— Largohu; se do të të kapin!

— Hapuni nga rruga! — thirrën xhandarët e tjerë.

Turmën e ndrydhi një heshtje e rëndë, e tendosur.

— Ç'ndodhi këtu? — pyeti njëri nga xhandarët, që u futën midis turmës duke çarë me bërryla.

— Komunisti!

— Lidheni qenin!

— S'ka faj ai. Më lidhni mua! — tha fshatarë që s'kishte me se të paguante taksën.

— Edhe këtë! Të dy t'i lidhim!

Po një dorë e fuqishme e tërhoqi djaloshin nga pas.

Midis turmës çohej më zigzage një udhëz e ngushtë, sa për të térhequr djaloshin më kominoeshet e arnuara në bërryla e në gjunjë, pastaj mbyllej përsëri.

— Hapuni! Hapuni nga rruga! — thërrisin xhandarët.

Turma memece kishte mbërthyer sytë mbi grupin e xhandarëve me fshatarin e lidhur e nuk lëvizte nga vendi.

— Hapni rrugën!

— Merushe!

— Urdhéro!

— Kujdes djalin! Mbaje afër!

— Hajde, Sezo! Hajde dhe ti këtu!

— Këtu jam. Mos ki merak! — dhe u ngjesh pas krahëve të turmës.

— Hapni rrugën se, për perëndi, këtu do bëhet njera sot!

Një hungrimë e mbytur përshkoi turmën, tej e mbanë.

Në veshët e Sezaiut ajo goditi si një zhuzhitje e largët bletësh që sa vinte e afrohej, shtohej, shumohej, forcohej. E ai ndjeu dëshirën që ajo të shtohej e të shtohej, për të shpërthyer pastaj si një gjëmim i fuqishëm, t'i flakte tutje xhandarët e të shpëtonte fshatarin me duart e lidhura që s'kishte me se ta paguante taksën.

- Hapni rrugën, se do të përgjegjeni para ligjit!
- Ne do të përgjegjemi!?
- Ju do të përgjegjeni!
- Pse?
- Se e latë që iku.
- Ne e lamë?
- Ju, po kush?
- Iku vetë. Ju këtu e patët. Pse s'e kapët?
- Se ju na zutë rrugën.
- Ne erdhëm këtu për të parë, jo për t'ju zënë rrugën juve. Hajdeni, vellezër! Mjaft patë! Ikim tanë!
- Dhe turma u copëtua, u thërrmuva, u shpërndea.
- Vetëm Sezaiu mbeti aty ku ishte, karshi xhandarëve, me sytë të gozhduar në duart e lidhura të fshatarit që s'kishte me çfarë ta paguante taksën.
- Sezai!
- ....
- Sezo!
- Erdha, erdha.
- Rëmbeu sharkun dhe dengun e mbështjellë me velenxën e dhirtë dhe u nis.
- Mbaje djalin për dore!
- Ai pérpara, ajo një hap pas tij, me djalin për dore e me dengun tjetër të lidhur me tërkuzë mbi shpatulla.

## VIII

### RRUGA E TË GJITHËVE

— Na, more ti, djalosh!  
— Urdhëro!  
— Pa hajde këtu!  
— Urdhëro!  
— Vete në shkollë ti?  
— Si urdhëron, vete!  
— Mirë! Po e njeh Qani Beshirin ti? Mësues është.  
— Qani Beshiri? Në cilën shkollë?  
— Më zure ngushtë. Shkollën nuk e di.  
— Nuk e hijoh.  
— Dreq, o pünë! Urdhëro??  
— Hic, hic!  
...  
Ecnin, tekundë e shtë, usqendë, iashë.  
Ecnin ngadalë.  
Zhurmat e pazarit kishin mbetur prapa kra-  
hëve të tyre. Ato ishin shkrirë në një zhurmë të  
vetme, në një gumëzhitje të vazhdueshme, të  
mbytur, të paqartë, siç dukeshin të paqarta edhe  
siluetat e njerëzve që shkisnin si valë të turbullta  
në të dyja anët e vështrimit të Sëzaitut

...Ai ekte po mendimi i tij kishte mbetur te shtylla e telefonit, para dyqanit të xhokaxhiut, tek ai djaloshi shpatullgjerë me kominoshet e ar-nuara në bërryla e në gjunjë, te grumbulli i njerezve që e rrëmbeu djaloshin nga hekurat e xhendarëve, te duart e lidhura të fshatarit që s'kishte me se ta paguante taksën.

Kur mendonte se, edhe sikur ta kapnin atë djalosh xhendarët, të tjerët nuk do ta linin që ta çonin zyrave apo burgjeve të tyre, një ndjenjë e vagëlluar krenarie ia ngrohte gjoksin e dejet.

Ai djalosh dhe ai grumbull burrash i bëheshin si një njeri i vetëm, i madh, i rreptë, i fuqishëm e i pamposhtur. Prandaj, edhe kur tha «bolshevik», atij iu duk se xhandari edhe u drodh nga zemërimi. Kur tha komunist, atij iu duk se xhandari mori fytyrë bishe.

... e vriste mendjen Sezaiu përfshirë kuptuar një të vetme: «nga zemërimi apo nga tmerri?» Po ç'bëri njera, ç'bëri tjetra! — thosh ai me vete, «të dyja po atë tregojnë: Ai u a ditka mirë vidhat këtyre, prandaj ai djalë më rrinte si një goxha shkëmb mbi kalldrëmin e atij sheshi, kurse xhandari shikumonte si nga iletia. Trim djalë! Po, në qoftë edhe komunisti aq trim sa ai djalë, pisk e paskan xhendarët».

...Sezaiu lëshoi dengun dhe sharkun në shesh, mbushi çibukun, shkrepi shkëndija me masat mbi eshkën në strallë, e ndezi dhe thithi tym të vakët duhani.

— E pe?

— Cilin? — pyeti Merushja.

— Si e shpëtuan, moj?

— Cilin shpëtuan?

— Atë që mbrojti fshatarin.

— Jo, nuk e pashë. S'më linin të tjerët.

— Trim djalë! Po fshatarin e morën, e lidhën, se s'kishte me se ta paguante taksën.

Siluetat që shkisnin në të dyja anët e vështrimit të tij sikur po dilnin nga një mjegull e përhimtë e po merrnin ngjyrë, nuancë, jetë.

— ... po s'kanë ç't'i bëjnë, se ai nuk e shau mbretin. Vetëm xhandarin shau për pistoletën; kurse xhandarit nuk ia mbajti ta nxirrte pistoletën. Do t'i marrin fasulet. Tjetër s'kanë ç'i bëjnë.

Thithi edhe një herë çibukum dhe u kthyen nga sheshi i pazarit. Në mes të sheshit — xhamia me minarenë e saj të bardhë.

Rreth xhamisë po ajo turmë njerëzish, që rriddhite si brenda një unaze gjigante të padukshme.

— Ndihmoje robin e zotit! — dhe një dorë e rrëshkur u zgjat përpara pa drejtim — me ç'të të ndodhet! Jetë e shëndet ta bëftë perëndia!

— Gjete ku të kërkosh! — iu përgjegj një burrë i thyer në moshë me belin mbi sup.

Në bishtin e belit kishtë lidhur një vandak xinash për zjarr, kurse nën sjetull mbante një disk të hollë bukë misri. Trupi i tij i kërrusur rëndonte mbi kalldrëm me dy këmbë të gjata e të holla, të përkthyera pak në gjunjë. Opingat e ngarkuara me baltë ugari dukeshin si dy plisa të lagësht.

— Kërkoi te ndonjë tjetër, o mavri, se argati s'ka as për vete.

— Ndihmoje robin e zotit me ç'të të ndodhet! Jetë e shëndet ta bëftë perëndia!

Po njerëzit bënin sikur s'e vinin re:

— Shtrëngonin fort nën sjetull diskun e bukës së misërt dhe vazhdonin rrugën.

Pas një dite pune ata ktheheshin në shtëpitë e tyre duke mbajtur mbi vete një vandak me xina pér zjarr, një barrë lodhjeje dhe feksin e një buzëqeshjeje tē hidhur, që vizatohej vetiu, kur mendja u shkonte te fëmijët. Ata do t'u dilnin përpara te praqet e portave e do t'i prisnin duke thirrur téré gëzim: «Erdhi babi, pruri bukë, erdhi babi, pruri...»

Vetém kaq kënaqësi mund t'u siguronin ata me punën e tyre; kaq e hiç më tjetër!

Prandaj edhe rruga dukej si e vdekur; prandaj edhe zëri i lypsit tē bëhej si jehonë kambane, megjithëse ishte i paktë, i mekur, i turpshëm.

...Sezaiu u hodh anës udhës.

Të hidhte një herë sytë dyqaneve, të pyeste ndonjérin, cilin t'i mbushej mendja se, kushedi, mbasë edhe mund ta njihnin mësuesin e fshatit të tij.

Në fshat e njihnin tē gjithë se, doemos, njeri me kalem, po edhe në qytet duhet ta njihnin, se mësuesit janë njerëz që numrohen me gishta.

Por, sapo vuri këmbën në prakun e dyqanit të parë, u detyrua tē përbahiej. Aty brenda po grindeshin, kurse ai nuk mund tē hynte në një vend tē huaj në një gjendje tē tillë.

Qëndroi te praku më tepër pér tē vendosur se çmund tē bënte.

Atij nuk i interesonin punët e tē tjerëve. Ai vetëm donte tē pyeste e tē gjente atë që kërkonte.

— Kujt i thua hajdut, ti, more zegali i buacave?! — u dëgjuar që brendë dyqanit, në prak tē tē cilit kishte ndaluar me mëdyshje Sezaiu.

Ktheu kokën andej nga erdhi zëri.

— Ty, ore, tē them. Hajdut dhe më pashë, babam!

Sezaiu mori frymë thellë.

— Sikter përjashta, lyrash i qelbur!

— Mos bëj çap tëhu, të them, se, pér Krisht, t'i bëj turiçkat finjë!

— Malli është imi dhe do të shes sa të më dojë mua shpirti!

— Sa e bleve, ore?

— Ç'të duhet ty ajo punë?

— Nga unë, ore, nga unë e bleve. Harrove kur më erdhe në vakt të lëmit vitin që shkoi? Ma bleve sa të desh qesja ty, po tani, që shteroi imi, ma shet pesë herë më shtrenjtë. Pa lëre, më thùa që s'je hajdut, pastaj! Hajdut, ore, hajdut faqezni bile!

— Aziiiz!

— Ndihamoje robin e zotit me ç'të të ndodhet! Jetë e shëndet ta bëftë perëndia! — dhe lysari, duke kaluar përpara Sezaut, zgjati dorën në derën e dyqanit të drithit.

— Aziiiz, more haram!

— Leeeepeeee!

— Mbathu shpejt, të griftë hastera! — maliçkoi tregëtari i drithit.

— Peqe, efendi! — dhe hyri me vrap, duke lidhur bushkurin e poturevë. «Teshiti» më një «tshjooo» të zgjatur, fshiu qurret e jargët me të prapën e dörës dhe prapë teshtiti dy herë radhazi, duke spërkatur mbi tryezë piskita jargësh e qirresh:

— Plasja të preftë, se mia n'gjite! Tutje, danet!

— Peqe, efendi — dhe u zembraps, duke fshirë me mëngë syprinën e tryezës.

— Nxirrmi këta pér... po lypsi dhe ai që donte të blinte misër, kishin kohë që ishin larguar. — Ptfu!

— Qysh «nxirrmi këta pér...» — pyeti Azizi

që nuk pa gjë e iu duk se nuk e dëgjoi sakt atë që tha i zoti.

— Po tërbohen mileti. U ka hyrë zegali në tru. S'pyesin më cili je ti dhe cilët janë ata!

Azizi po e shikonte me ca sy të picërruar nga habia. Fërkonte majën e skuqur të hundës me të prapën e dorës pa i ndarë sytë nga i zoti e mendja i vente, për të keq. I bëhej sikur efendiu, këto kohët e fundit, nuk para ishte në terezi se «jepte ca urdhëra e kishte ca të tekura që zoti na ruajtë nga sahati i lig!»

— Po tërbohen, more, po tërbohen! — thirri tregëtar i drithit.

— Le të tërbohen. Hallall e paçin! Hazër është Ali efendiu në çmendinë. Vetëm zotrote, mos e prish terezinë!

— Si të mos e prish, more i paudhë? Të fani-tjetri pëlltym si lugat në derë e të bëhet zot në mallin tënd! Po kjo është të vesh kujen, o mavri, të pëlcasësh nga marazi!

— Mos e prish gjakun! Hic mos e prish! Dëgjo Azizin, zotrote! — dhe u largua duke murmurit me vete.

Tregëtar i drithit la karrigen e shkoi te dera e dyqanit. Provoi me radhë kanatat, provoi bravën e menteshat dhe hodhi një herë sytë nga qepeni i rëndë. Si ndolli një herë hundët, zgjati kokën jashtë me bulçitë plot e u mat të pështynte po u bë pishman, se i erdhi më mirë të kapërdihej.

— Po ti, c'pret aty? — pyeti me dyshim Se-zainë. — Eeeej, ty të pyes!?

— Ç'ke, more?

— Pse rri këtu?

— Klam punë.

- Me mua?  
 — Jo.  
 — Po me cilin?  
 — Ç'të duhet ty?  
 — Si, more, ç'më duhet mua? Më rri një burxhik afër derës së dyqanit tim e ke sy e surrat të më thuash edhe ç'm'u dashka mua?!
- Rruga s'është dyqan. Është e të gjithëve.  
 — Rruga përpara dyqanit tim është imja.  
 — Na lërë rehat tan!  
 — Aziiiz!  
 — Leeepeee!  
 — Zhdukma këtë fajezi që këtej! — dhe hyri me rrëmbim në derën e dyqanit.
- Tuaf njeri! Ekim! — i tha Sezaiu së shoqes.  
 Azizi doli te dera e dyqanit me një shkop në dorë e, megjithëse aty nuk pa njeri, shkruhu në hava një batare me fjale e me piskita jargësh.
- Sikter, firaun! Efendinë tim të shkallosh ti, qurravec, ti, keç i shtirë, ti, zegal i buacave! Mos folë se, për nur të pejgamberit, ta bëra kokën çatall! Thyej qafën që këtej e mos të ta shikoj më surratin, se do të të bëj atë që s'ta ka bërë as perëndia! — dhe ngriti shkopin në hava. — Sikter!.. Oj, edepsëzi! — tha duke hyrë në dyqan. — E ndoqa.
- Aferim të goftë!  
 — Jo, po tallemi!  
 — Blokun këtu!  
 — Ç'e do, efendi?  
 — Bjere, more, e mos më pyet ti mua!  
 — Peqe, efendi!  
 — Do të të shënoj një çeneke bakshish.  
 — Mos u harxho, zotrote, se nuk është vakti sot!

— Uh, vakti thotë! Kurrë mos qoftë vakti! E ke hallall sot!

— Po zotrote, s'më ke dhënë ende të parat!

— Hiç mos u bëj merak ti! Këtu në blok i ke!

— Hejvallah! Jetë e shëndet jua bëftë perëndia, zotërisë sate e çupës së vetme!

— Hallall e paç! Edhe mbylli blokun e madh me kapak të zi.

— Po të ra njeri më qafë, thirrmë mua zotrote! Vetë hiç mos e prish gjakun!

— Janë shtuar të ligjtë, Aziis, janë shtuar shumë. S'pyesin më pér ligje e pér fuqi. Ia pinë lëngun edhe të madhit fare. Duhet një dorë tjetër tanë, po të jetë mbretëri e madhe; ama. Ajo ua mbledh rripat këtyre.

### HANET Ë VLORES JANË NALLBANHANA

Diellit i doli përpara një rë e madhe.

Shkëlqimi i ftohtë i tij u turbullua e ndërrroi ngjyrë. Disku i zjarrtë u shpërfytyrua, u copëtua dhe copat e tij humbën prapa masës së resë.

Reja, që fshehu diellin, lëshoi akull mbi qytet. Merushja u ngjeth.

Ngriti kokën lart.

Nën renë e zezë fluturoi një tufë sorrash. Sorrat fluturonin lart.

Ajo mbuloi kokën e të birit me palën e sharkut.

— Ke ftohtë, ë?

— Jot. Këtu do të rrrimë ne?

— Jot. Më s'kuptoj që do t'i bëj.

— Po pse s'ikim?

— Sa tē vijë babai.

— Ku vajti babai?

Në oborrin e hanit hyri me nxitim një mesoburrë.

— Rusto! — thirri ai në ecje e sipër.

— Lëshoje këmbën e kalit — i tha Rustua ndihmësit dhe u nis me sandraç në dorë pér t'i dalë pérpara atij që e thirri.

— E?

— Vapori ka ardhur, po ata i kanë mbajtur pér kontroll në doganë.

— Si kështu?!

— Do tē ketë marrë erë.

— E pamundur!

— Edhe Hysua kështu tha, po mua sikur s'më pëlqen mbajtja në doganë! Të mos jenë treguar të kujdeshjëm ata tē komitetit...

— Ku vajti Hysua?

— Në skelë e lashë! Mua më nisi këtu. Më tha që kuajt tē jenë gati pér një orë.

— Ashtu, ë?

— Ata do t'i nisim sonte. Këtu ka rrezik.

— Në i lëshoftë dogana.

— S'ka ç'u gjen dogana. Ato që kanë ata nën kafkë, s'ua zbulojnë dot.

— Kush do tē shkojë me ta?

— Nga Smokthina kanë dërguar Mevlinan. Ai do t'i presë te spitali.

— Mirë. Ti nisu pér në skelë. Thuaji Hysos tē mos vijë me ta këtu. Ne themi s'ka marrë erë, po ku i dihet? Le që ai na qenka grindur edhe me xhandarët sot.

— Ma tregoi. Mirë ua ka bërë maskarenjve.

Vetëm të zhvatin dinë — dhe tundi kokën. — Veç mos ardhtë ajo dita jonë!..

Rusto Bardhi u kthye të mbathte kuajt. Ai tjetri ktheu edhe një herë kokën prapa, pastaj u zhduk tej portës së oborrit të hanit.

— Erdhi babai! — tha vogëlushi dhe u ngrit duke mbështetur dorën në prehrin e Merushes.

— Ulu, ulu, se do të ftohesh!

Ai u bind.

— S'gjeta gjë — i tha Sezaiu Merushes.

— Bobo!

— As te hani i Rexho Nallbanit s'kishte njeri.

— Mbetëm! Korba, mbetëm rrugëve!

— Dale, të pyesim këtë një herë — dhe u kthye nga hanxhiu: — More hanxhi. — Urdhëro!

— Duam vend për të fjetur! Flihet këtu te ju?

— Jo, more vëlla, jo. Hanet e Vlorës janë nallbanhana, s'janë hotele. Jemi qytet bregdetar ne. Të huajt e duan shumë luksin, prandaj edhe mbreti i prishi hanet e natës me dekret.

...  
Pas pak ata dolën në rrugë...

...Në të dyja anët e rrugës rreshtoheshin magazinat e tregëtarëve e kafenetë dhe përbri tyre njëjteshin si këpurdha punishtet e zanatçive dhe dyqanet e bakejve me tezgat si nofulla të dala të mbushura me vjetërsira e cikërrima.

Prapa krahëve të dyqaneve shtrihej tërë qyteti me ca rrugica të ngushta, tërë kthesa, plot pellgje uji e balte, me shtëpitë përdhese mbështetur me njera-tjetren. Tek-tuk midis tyre kishte edhe nga ato pallatet me dy kate që thyenin monotoninë e përdheseve dhe bënin që rrugica të dukej si shtrat dhëmbësh katarosh.

Sezaiu u kthyesh në rrugicën e parë që i doli përpara...

*Kallot e «babait» dhe spitali i «të çmendurve».*

— Qani Beshirin unë nuk e njoh, po këto ditë kam dëgjuar për një mësues tjetër që e mbyllën në çmendenë.

— Si e quanin?

— Rrugëve thonë që s'qe vlonjat, qe i ardhur, po këto që thonë janë profkat e bashkisë se; ato që shkruante ai, nuk mund t'i shkruante veç një vlonjat.

— Po pse u çmend?

— Kush u çmend?

— 'Ai mësuesi, de.

— Ai s'u çmend, po, atje ku e futën ata, me siguri do të çmendet.

— Jo, more!

— U shkeli në kallo ai, e atyre u dhembishumë... Di ta lexosh ti? — dhe nxori nga xhepi i brendshëm i xhaketës një fletë të palosur.

— Di, po ashtu, copa-copa.

— Ta lexoj unë — dhe shpalosi fletushkën.

U afroa më pranë tij, pa me kujdës rrëth e rrötull, pastaj uli kokën mbi fletushkën që mbante në duar dhe lexoi titullin në fillim:

*«Babai i qytetit dhe... grykat, ujrate të zeza...»*

*Pas titullit vazhdoi:*

*«Karroca i zbriti të dy, në skelë dhe ata vendosën ta bënин téré atë rrugë më këmbë»*

Rruja ishte e gjatë, tepër e gjatë edhe përfuqitë, edhe përmoshën e tij, po ai një herë vendoste.

Detyra që i kishte ngarkuar vetes ishte tepër patriotike, kurse patriotizmi nuk mund të kuptohet

*pa sakrifica, qofshin këto edhe kaq të mëdha, së kjo e sotmja.*

*Zonjusha e këndshme tërhiqtë me një rrip të meshintë të zi, të zbukuruar me ca pullëza metali të nikeluar, një kone çokolatinë.*

*Ai ecte pas kones çokolatinë me barkun përpara e duart prapa.*

*Ecte babai i qytetit e fliste me një ndjenjë të ligjshme krenarie për të ardhmen e qytetit të tij.*

*Dëgjonte e bija e babait të qytetit e krenohej me madhështinë e mendjes së të atit dhe të qytetit të ardhshëm.*

*— ... e le të thonë pastaj qytet pa plan, pa sistem, pa kanale kulluese, pa kanale për ujërat e zeza...*

*Zonjusha e këndshme, me një lëvizje tepër delicate, zuri feçkat e hundëzës së derdhur.*

*Konia çokolatinë nuhati një bajgë.*

*Babai i qytetit mori frysë thellë.*

*— Sa për ujërat e zeza... — po një kollë e shpeshtë s'e la të vazhdonte më tej. Mallëkuar qoftë ajo kollë, që ia zuri fjalën në fyt babait të të gjithëve... kurse ne, që e kemi për detyrë ta ruajmë si sytë e ballit babanë e lëtë gjithëve, le ta lëmë atë të qetë sa të mbledhë veten e, që të mos venë dëm hapat e tij, duke shfrytëzuar më shumë respekt ato që ai u ka shprehur edhe të tjerëve para se të merrte vendimin solemn për t'ia shprehur edhe së bijës, të ecim më tej në rrugën e madhështisë së ardhme...*

*— ... në qoftë se sot derdhen rrugëve... po le të derdhen, ore, se, babam, ku ua del dot qesja e një mbreti pisllëqeve të milletit... — E hajde pastaj e mos ma quaj njeri me një karroqë tru tërë këtë birkoburrë, që mezi u rëmuia në atë goxha Drashovicë e u vu kryetar bashkie në Vlorë.*

— ... *Derdhen në rrugë?! Po le të derdhen, ore, se gryka halesh janë. Në fshatin tim ku ta gjejnë këtë fat, se është pleh që ia kalon njëmijë herë edhe bajgës së lopës, edhe kakërdhisë së deles e të dhisë...*

... *E grykat e haleve, si për t'i bërë qejfin kryetarit të bashkisë derdhen nga faqet e mureve, baltë e gurë rrëzë rrugicave në ca hendeqe të zbuluara tërë lerë të zezë. Në lerën e zezë lëvrijinë mijëra krimba të bardhë me bisht të hollë e të gjatë, që, herë pas here, sa për të ndërruar klimë e për t'ia bërë borxh kryetarit të bashkisë, marrin rrugën nëpër pjerriinën anësore të hendekut. Doemos që, sa ngjiten pak, ata rrokullisen, se s'është edhe aq e lehtë t'ia hedhësh kryetarit të bashkisë. Mendja c tij gjeniale i ka parashikuar të gjitha dhe ka dhënë urdhër nëpërmjet të «të ngarkuarit kompetent» që pjerrësia e hendekut të bëhet e atillë që «ato qenie të ndyra me bisht të hollë e të gjatë» të mos e marrin dot të përpjetën... megjithëse midis tyre ka edhe nga atc që, pasi e kalojnë me shumë e shumë këmbëngulje e mundim pjerrinën anësore të hendekut, shëtisin serbes nëpër kalldrëmin e rrallë të rrugicave.. e as «i ngarkuari kompetent», as kryetari i bashkisë nuk kanë ç'u bëjnë, se «ato qenie të ndyra, po të kenë pesë para mend në kokë, nuk e thyejnë urdhërin e babait të të gjithëve.»*

Ai që lexonte mbaroi dhe ngriti këkën.

Sezaiu po e shikonte me sy të picërruar.

— Kështu — tha ai që i lexoi fletushkën-kështu ka shkruar mësuesi, pastaj thanë se u çmend dhe e quan në çmendinë...

## **IX**

### **T H O M A I**

Sezainë e zuri nata nëpër rrugica, vetëm se tanimë ai nuk mendonte pér mësuësin, po pér një strehë, një strehë të çfarëdoshme pér të futur kokën.

Të rraskapitur nga lodhja, ata mezi çapitnin nëpër rrugicat e ngushta e të errëta.

Kudo rrugica të ngushta.

Në rrugicat e ngushta porta të mbyllura nga brenda me shula.

Kudo mure të larta, dhe atij i bëhej sikur tërë jetën kaliot e fshatarit nga fshati rrëzë Çikës do të shkelnin mbi kallot e gurta të rrugicave të ngushta e të errëta.

Natë.

Rrugë.

Natë pa shpresë.

Rrugë pa shpresë.

Si një puhizë e afshtë, pér një çast, iu derdh nëpër tërë qenien mendimi se vëç shtëpisë së mësuesit mund të kërkonte edhe shtëpinë e një tjetri,

një nallbani, njëfarë Rexho Nallbani të panjohur... tamam të panjohur.

Po si mund të trokasësh në portën e një të panjohuri?!

Është njësoj sikur të trokasësh në secilën nga portat që të dalin përpara, njësoj sikur të zgjatësh dorën. Punë që s'bëhet! Le që kush do ta njohe? Këtu nuk njohtan një goxha mësues, jo më një nallban.

— Kam ftohtë — u qa vogëlushi.

— Ftohtë është. Skemi ç'i bëjmë.

Këtu u këput edhe filli i mendimeve të ngatërruara.

— Makar të gjejmë ndonjë rrëzë që të mos e rrahë era, se s'durohet.

Tënë atë mbasdite ajo nuk e kishte nxjerrë një fjalë nga goja. Vetëm se shikonte më shqetësim të shoqin që ndizte e shuante çibukun dhe ecte e kërrusur me dengun të lidhur në shpatulla e me djalin pér dore.

Sa herë që i shoqi pyeste ndonjë pér mësuesin, ngrinte kokën e me një vështrim të drobitur, po tërë shpresë, shikonte të panjohurin. Po kur i panjohuri ngrinte supet e hapte krahët, ajo ulte kokin, psherëtintë lehtë e përsëri nisej nér në rrugëtimin e gjatë e të pafund.

— Arixhijtë flenë rrugëve.

— Mirë makari, si të duash ti, po unë... — dhe përsëri e linte fjalën në mes.

— Mbështille mirë djalin! Nëma mua dengun tjetër! Zgjidhe tarkuzën! Ke tërë ditën pa e zgjidhur fare.

— U mësova.

— Zgjidhe, zgjidhe!

— Minë e kam, se më mban krahët. Kam frikë se mos ftohem.

— Ulemi të çlodhemi pak, se edhe unë u lodha.

Lëshoi në rrëzë të rrugës dengun që mbante vetë. Mbi të shtroi sharkun.

U ulën.

Djalin e vunë midis tyre.

— U lodhe, ë? — e pyeti Sezaiu të birin, duke i përpushur flokët me dorën e tij të ashpër.

— Jo, po më dhembin pak këmbët. Ja këtu — dhe kapi me duart e skuqura nga të ftohtët kërcinjtë e hollë. — Këtu më dhembin pak.

— Do të të shkojnë. Mos ki merak!

— Kur do të më shkojnë?

— Kur të ngrihesh nga gjumi.

— Pse, do të flemë tani?

— Në rrugë do të flemë?

— Po ku?

— Ku të jetë thënë, vetëm jo në rrugë, se është turp.

Merushja u mbështet pas murit dhe mbështolli kokën me cepin e sharkut. Shtrëngoi nofullat dhe ngjeshi mjekrën në gjoks.

— Do të vemë në shtëpi ne? — e pyeti Sezainë i biri pas një heshtjeje të shkurtër.

— Është larg — iu përgjegj ai pa qejf.

— Na çon mushka.

— S'ka më mushkë.

— Pse?!

— Të dhembin më këmbët?

— Ku vajti mushka?

— E hëngri bisha.

— Eeee! Atë e mori ai babai që më dha bukë me gjizë.

- Ia dhashë unë.  
 — Për fare?  
 — Për fare.  
 — Uuuu! Po me se do të vemë në shtëpi ne?!
- Ke të shkrepur, more? — u dëgjua një zë  
 nga këndi në bërryl të rrugicës.  
 Sezaiu ktheu kokën, po s'pa njeri.  
 — Të shkrepur, të shkrepur, ke? — u përsërit  
 pyetja.  
 — Kam.  
 — Eh! Të rruashin të gjithë ç'ke! Më ishte  
 çarë fërrneçka e hundës për një cigare.  
 Sezaiu nxori strallin, masat, dhe eshkën.  
 — Po duhan ke? — pyeti tjetri duke u afrouar.  
 — Kam, kam.  
 Merushja mbështolli këmbët me cepin e sharkut.  
 — Ç'më paska bërë me fat perëndia! Dridhma  
 një!  
 — Nuk di ta dredhësh vetë?  
 — Kam ditur, po tani nuk e dredh dot më.  
 — Ke harruar, ë?  
 — S'dridhet duhani me një dorë — dhe u afroa.  
 Ndërkohë Sezaiu kishte dredhur një cigare  
 me lëpushkë të butë masuri dhe ia zgjati. Për vete  
 mbushi cibukum.  
 — Nga, të kemi? — e pyeti i panjohuri.  
 — Nga fshati.  
 — Qofsh shëndoshë!.. Erdhe për ditë pazari, ë?  
 Sezaiu shkrepit strallin me masat.  
 — Po qenke vonuar shumë, ama. 'Apo ndenje  
 vetë?  
 — Ndize! — dhe i zgjati copëzën e ndezur të  
 eshkës.  
 — Afroma pak, se... ta marrë djalli!

- Ç'pate?!
- Një dorë më punon.
- A?!
- Tjetrën s'e kam fare. Ma preu dinamiti. Sezaiu ia ndezi cigaren.
- Në gurore... Më plasi dinamiti në dorë. I panjohuri fliste dhe ndizte cigaren.
- Jo, more!
- Eh! Jemi të varfër ne, kurse të varfërit ë duhet më tepër nga ç'i japin për të mbytur varfërinë. Unë dinamitin e fitilin kisha në dorë. Vërtet që hiqja nga një pulqer dinamit, po dinamiti do edhe fitilin. Duhej shkurtuar gjatësia e fitilit për çdo plasje; por, çdo copë e shkurtuar... ç'të të them më tepër. Në fund fare unë mbeta me një dorë... Eh, more vëlla! Është e poshtër varfëria! Dëgjomë mua ti, se e kam provuar në lëkurën time unë!
- Nuk je në ndonjë punë?
- Jo. Nuk jam. Këtu nuk ka punë për njerëzit me dy duar, jo të ketë për sakatët. Sa i kisha të dyja duart, punoja nga katërmëbëdhjetë orë në ditë. Derrce punoja, po ku të linte kryepunëtori?! Ta hidhte sy më sy italianë e veç kur dilje si «rruar qethur». Po të paktën punoja e haja me djersën time. Kisha rregulluar edhe një palo kasolle sa për të futur kokën atje nën gurore, buzë detit, kurse kështu... kështu e mori lumi këtë punë.
- Sa vjeç je? — e pyeti Sezaiu.
- Njëzet e tre?
- Saaa?!
- Njëzet e tre. Pse, s'e dëgjove mirë?
- Po, po. Mirë e paskam dëgjuar.
- Kam një jetë të tënë përpara. Po s'besoj të

vazhdoj shumë kështu. Dëgjomë mua ti. Në gurore na e thoshin gjithnjë këtë dhe e thoshin djem me shkollë, nga ata që e ndjejnë që larg. Afroma çibukun, se m'u shua.

— Këtej je?

— Jo. Jam nga Fieri — dhe ndezi cigaret e shuar.

— Si ta thonë emrin?

— Thoma.

— Po pse s'vete në Fier, o Thoma?

— Ku të vete?.. S'kam as shtëpi, as njerëz. Nëna më ka vdekur që shpejt. Babanë ma vranë që në kohën e kryengritjes. Unë shpëtova se ua mba-tha. Po ta dinin njerëzit e mbretit që isha në Vlorë, në pranga do të kisha përfunduar edhe unë.

— Jo, more!

— Se edhe unë luftova kundër mbretit. Atë-here na thyen se ishim pak. Disa na u vranë në luftë e sipër. Shumë na i vranë edhe pas luftës, e të tjerët na i burgosën në Berat e në Burrel. Ata që shpë-tuan mörën arratinë. Po ty nga të kemi?

— Nga Çika.

— Nga Çika?

— Ehë!.. Isha, se tanë s'jam më.

— Pse?

— Ika. Ika për gjithnjë.

— Erdhe të punosh në Vlorë?

— Ashtu them.

— Ke gjetur punë?

— Sot erdha.

— Keq e paske. Dëgjomë mua ti! Kthehu prapë në fshat! Këtu s'gjen dot punë.

— S'kthehem dot. S'kam ku të kthehem.

— E shite truallin?!

— Jo. Ma rrëmbyen.

— ...?!

— Agai i fshatit. I kisha ca borkhe. S'kisha t'ia laja. Bëri gjyq, e fitoi gjyqin, pruri xhandarët e më nxori nga shtëpia e nga ajo copëz tokë që kisha.

— Prandaj je rrugave sonte?

— S'kam ku të vete.

— S'njeh njeri këtu?

— Njoh një, po s'e gjeta. Kam tërë ditën që po e kërkoj.

— Si e ka emrin?

— Qani. Qani Beshiri.

— Qani Beshiri, ë?

— Po. Ka ndenjur tek unë në fshat. E kishim mësues.

— Jo. Nuk e njoh. Megjithëse më duket se diku e kam dëgjuar këtë emër.

— Merushja tërhoqi pranë vetes trupin e vogëlushit që kishte humbur në një gjumë të thellë dhe e mbështolli më mirë me shark.

— Kujtova së në Vlorë do ta njihnin të gjithë.

— Eh, more vëllai im!

Sezaiu uli kokën dhe psherëtiti.

— Mos ki merak! Mirë do të ishte të shkoje në ndonjë hotel, po atje të rjepin, sidomos po t'u shkosh në këtë orë. Të kërkojnë shumë, se e dinë që, do — s'do ti, do të paguash. Janë bërë njerëzit të ligj. Shumë të ligj. Vetëm paranë shikojnë. Paranë dhe asgjë tjetër. Pa, se je në hall ti, atë duan ata.

— Ku the ti, more?

— Si, ku thashë?

— Ku the të veja?

— Aha! Në hotel.

— Qysh në hotel?

— Në hotel, ore! Është vend ku fle me para. Paguan sa t'i dojë qejfi hotelxhiut, e ai të fut në një dhomë për të fjetur; po pati vend se, po s'pati, të fut në korridor dhe të thotë: «Po të të dojë qejfi, urdhëro e shtrihu të flesh këtu.» Aty, po, njësoj si në rrugë, se të vjedh vetë hotelxhiu e pastaj të thotë: «Hajdutët, hajdutët të kanë vjedhur!» Ose, përpara se t'i thuash ti: «më kanë vjedhur», të thotë ai ty: «më ke vjedhur». Të sjell edhe xhandarët e pastaj lumi që të mori. Mos u çudit. Kështu është bërë këtu.

— Dreq, o punë! Ka, apo s'ka më njerëz në këtë botë?!

— S'ke ç'i bën.

— Po pse, pse, ta marrë djalli?!

— Kështu si ti pyesin të gjithë.

— Eh!..

# X

## O TË GJITHË, O ASNJËRI

Ai mëngjez u gdhi i zi pus.

Gryka e Pishës ziente me një hungrimë të pandërprerë.

Vetëtimat çanin tendën e reve të zeza dhe nguleshin si hostenë të zjarrtë në tokën që dridhej nga gjëmimet e bubullimave.

Megjithëse retë ishin ulur shumë, si një kësulë gjigante mbi qytet, thëllimi mëngjezor i janarit, si një gjarpër i akullt, vërvshonte pas erës së cingërimtë që dyndej prej veriut e shponte deri në skutat më të mbrojtura të qytetit.

— Sezo!

— Eëëë!

— Ngrihu, se u gdhi!

Ai hapi sytë.

— Jo, moj, jo... Nuk është gdhirë ende — dhe futi kokën në cepin e sharkut.

— Ngrihu, se jemi në rrugë. Turp kush na shikon! Pastaj edhe unë sikur s'para ndjehem mirë. Më kanë ngrirë këmbët e duart dhe më çjerr këtu më të majtë e në cepin e shpatullës. Sikur s'mbushem dot me frymë!

Gërvishjet metalike të menteshave të kanatave

të portave, që po hapeshin pér të filluar ditën e re, plotësonin intervalet ndërmjet bubullimave.

Në rrugë po dilnin njerëz.

Dilnin njerëzit e punës, njerëzit që do ta zgjognin qytetin nga gjumi.

— Zgjoje djalin! Nuk mund të rrimë më këtu!

— U ngrite, Sezai?

— Hajde, Thoma, hajde!

— Ama ftohtë, ë?

— Kohë bore kjo.

— Po u zbraz, njera do të bëhet — tha Thomai.

— Nuk e besoj, se po fryn e ftohta...

Pothuajse tërë atë natë ata e kishin kaluar duke e hedhur bisedën nga Çika me burrat e kërrusur pranë shatit e parmandës, në Fierin e ditëve të kryengritjes kundër mbretit e nga Fieri i gjakosur pas ditëve të kryengritjes, në Vlorën, që rënkonte e ziente midis rënkimeve.

Ndaj të gdhirë ata ishin veçuar në skutën e vet. Po Sezaiu kishte ndenjur edhe ca mbi kokën e Merushez dhe të të birit. Vetëm kur gjumi i kishte rënduar si plumb mbi qepalla, kishte mbështetur bërrylin mbi deng e kokën mbi shuplakë e kishte humbur si guri në një pus të thellë.

— ...More Thoma... turpi është kordhë, po s'u mbaka më.

Thomai ngriti sytë në pritej.

— E njeh Rexho Nallbanin ti? — e pyeti duke mbushur çibukun me pulqerët që i dridheshin, ndërsa ftyra iu mbështoll me një cipë të vakët turpi. Se as ai vetë nuk e kuptoi qysh iu tek të pyeste kaq papritur pér një njeri që as e kishte njojur ndonjëherë e as e kishte takuar gjékundi.

— Ka një han ai, më duket, aty te shtëpia

e Osman Hakiut, përmbi xhaminë Tabakhanë.  
— Aty e ka. Mirë do, të ishte të takoheshë një herë me të.

— Po të jetë ai, e njoh.

Sezaiut nuk i erdhi mbarë t'i rrëfehej, se e dinte me saktësi që tamam ai, për të cilin tregonte Thomai, ishtë njeriu që kërkonte, se te hani i tij kishte shkuar edhe të djeshmen e se nuk e kishte gjetur aty, po këtë e bënte, se, po të shkonte i shqëruar me një njeri tjetër, më lehtë mbase do ta kishte.

— Posi, ore, të shpie unë — i tha Thomai. — Po ishallah qoftë ai që them unë!

— Do të ketë dalë tani, apo jo? — pyeti Sezaiu dhe për një çast ndjeu një zemërim të brendshëm kundrejt vetes. Çuditej se si nuk kishte guxuar ta mposhtte që një natë më parë atë krenarinë e tij të ngulshme, e cila nuk e kishte lejuar ta shkëpuste veten nga ndjenja e turpit që do t'i skuqte faqen, po të trokiste në shtëpinë e një të panjohuri në pikë të natës. Po ajo që nuk duhej të ndodhete, kishte ndodhur. Atë natë ai e kishte kaluar rrugëve, si «arixhinjtë», pa një strehë mbi kokë.

— Po edhe po s'pati dalë, pyesim ku e ka shtëpinë dhe i vemë.

— Më mirë në han, se as unë vetë nuk e njoh, po më thanë se, po të kem ndonjë hall, ta kërkoj.

— Po pse s'më the që mbrëmë, more i uruar?!

Asaj që i druhej Sezaiu, nuk i shpëtoi, me gjithatë ai u mundua t'i bënte ballë kësaj pyetje me një përgjegje të shkurtër.

— Nuk shkonte. S'ia zë dot tjetrit në mes të natës, kur ke me vete një stan të tërë.

Era që fryntë nga veriu po i shtynte retë ma-

tanë Karaburunit. Vetëtimat e gjëmimet e bubullimave rrëshqitën mbi Vlorë e humbën tutje në gjirin e egërsuar të Adriatikut.

Dalëngadalë, që nëpërmjet reve po derdhej dita me një feks të brishtë ngjyrë plumbi, kurse qyteti, që po nxirrte format e tij nga gjiri i zi i natës, po gjallërohet duke zbrazur nga të gjitha anët në sheshin para xhamisë Tabakhanë turmat e përgjumiura të largatëve, që shkelnin të parët mbi shpatullat e mpirat të qytetit.

Sheshi i xhamisë Tabakhanë i ngjante në këto orë një stacioni të vogël shpërndarës. Që aty, pasi pinin kafenë e mëngjezit dhe ndiznin cigaret e para, argatët merrnin të përpjetën për në Qafëm e Koçut apo në Qafën e Topit, i ngjiteshin Bregut të Orizit e Mesovunit, ose vareshin për në Sadra, në Pus të Mezinit, në Grykë të Shegës ose edhe për në Bes-trovë e Panaja me shetërit e belat në krahë dhe trastat e bukës të lidhura në brez.

Nga e djeshimja plot rrëmujë në tërë atë shesh kishte mbetur vetëm minareja e bardhë e xhamisë dhe isoja e çekanëve të teneqexhinjve dhe e vâreve të kovaçeve që si një vegim i magiishëm i së djeshmes, zgjonin me radhë në kujtesën e Sezaiut tërë ato ngjarje të çuditshme.

### Legjenda e tri selvive

Në mës të gjithë atij sheshi, si për çudi të të gjithëve, aty nën minarenë e xhamisë Tabakhanë, pranë e pranë njëra-tjetrës ishin rritur tri selvi.

Tri selvi të vetme në tërë atë shesh.

Nga të gjitha ato që fliteshin e dëgjoheshin për këto tri selvi, njerëzit besonin vetëm ato që

tregonete Çeço Arapi, se në tërë Vlorën nuk gjeje njeri më të moshuar e më të bredhur nga ai. Pa lëre pastaj se si tregonete! Doje, s'doje, do ta besoje.

Rinte një copë herë, duke parë kureshtarët pak si vëngër që nën vetullat e trasha e me buzë-qeshje krenare, në buzët e mbufatura, shtruar-shtruar, niste e tregonete atë histori që kishte treguar mijëra herë:

«Vakti i turkut paskësh qenë, po një vakt që turkoshaku, edhe i vrarë, edhe i drobitur, nuk para e ndjente veten pér aq zot të madh sa mbahej. Prandaj edhe bishéronte sa i hante presa e shpatës.

Po na kishin zënë një vakti vase tre kaçakë me mustaqe e me mjekër, me fustanella e me qestoleta, me silahe e me jataganë.

Kaçakçet i kishin zënë me ndihmën e spinëve, kur flinin, se, edhe taboïre të kishin qenë, kush i dilte trimërisë së tyre?!

E, si i zunë në një shpellë të Shashicës, përmbi kokë të Lapardhasë, na i lidhën të tre bashkë, dorë më dorë me një litar.

Tre kaçakë të lidhur në një litar e një varg me tunkoshakë zbritën poshtë në udhë të madhe. Ranë aty në një karvan e u nisën pas karvanit pér në Vlorë.

Vapë e madhe paskish qenë asaj dite, sa edhe toka nxirrte shtëllunga avulli, sa edhe gjinkalla zhazhariste e gajasur nëpér gérbojat e drurëve, kurse mushkat e karvanit mbanin kokat nëpér shalë të njera-tjetrës.

Te burimi i Kallafetit, më të dalë të Drashovicës, duke pirë në lekane ujë të freskët, na u trembka mushka e kreut, se një gjarpër dy hostenë i gjatë dhe i trashë sa një kërci burri fusht ia bëka

nga gryka e burimit e nëpër këmbë të kafshëve e të turkoshakëve zbritka poshtë zallishteve të lumit. Pas së parës edhe e dyta, pas së dytës edhe e treta e me radhë të tëra mushkat e karvanit morën arratinë. Kishte ç'kishte nëpër thasë, s'mbeti më pér në koçekë. S'pritën më as turkoshakët dhe kush ia mbathi nga mali, kush nga fusha, duke lënë sheshit tërë ç'kishin ngjeshur brezit:

Fat e rrësk pér tre kaçakë. Ata prenë litarët, ngjeshën armët e turqve në breza dhe u zhdukën në rrapishte.

Pa po ku s'kërkuan turqit e, si s'rancë në gjurmë kaçakësh; kapën rrugës tre të tjera të veshur me fustanella dhe, pa arritur mirë në Vlorë, nga frika se mos u dilte në sheshi e vërteta, u prenë gjuhët e i plasën te xhamia, aty rrëzë minaresë. S'flisin dot të shkretët burra. Pa po çurk u shkonte gjaku, gjersai mbuloi zalia e u shtrinë sa gjatë gjerë:

Erdhi e u mblodhi gjithë qyteti. Popull, sa të hante syri e në mes të atij populli ishin futur edhe tre kaçakët me mjekrat të prera e fustanellat të ndërruara. Rrinin të tre kaçakët në mes të gjithë atij populli e shikonin të vrarët.

Kur rritrita e ditës tjetër, u mblodh prapë i gjithë qyteti se aty rrëzë minaresë nuk ishin më tre, pò gjashtë. Se kaçakët asaj nate kishin vrarë tre turkoshakë dhe nën këmbët e tre shqiptarëve të vrarë kishin vënë kokët e turqve e te kokët e shqiptarëve kishin mbjellë tri rrënjen selvi.

Vitet shkuani erdhën vite të tjera. Pa u rritën tri selvitë, hodhën shtat e vunë kurorë. Tri u mboillën, tri u rritën, tri kanë mbetur gjer më sot, se të tjerat, që bulonin nga rrënjishtet, ditën e verës

shkonin çunat e i shkulnin. Kështu ishte bëre zakon e kishte mbetur që atëhere. Ai vend nën minare, për kujtim të tre burrave të vrarë, do të rritte brez pas brezi vetëm tri selvitë që mbollën kaçakët.»

— Dëshirat e vërtetë që këtë gjë po bëjë? —  
— Nëse nuk e dëshirat, tani përfundon. —

### R e v o l t a

— E atij mëngjezi nën ato tri selvi qëndronte një grup argatësh me kryepunëtorin në mes:

— Lajmi që sillte kryepunëtori nga agai i tronditit argatët se, të sësive në rrugë pa punë dhjetë burra, nuk ishte gjë e vogël. Dhjetë familje prisin nga krahët e atyre të dhjetëve.

Kur u ndodhën pranë tyre, Thomai e mbajti nga krahu Sezainë.

— Kot e keni që ngulni këmbë. Sot e tutje do të punojnë dhjetë më pak. Pallakomat e ullinjve po mbarojnë e punë për një kopsi kjo juaja, nuk ka më.

Me sa ma ha syri mua, aty ka edhe një muaj punë.

— Jo, more? — dhe kryepunëtori shqeu sytë nga habia. — Na qenke bërë burrë me një karroqe tru zotrote! — dhe aty për aty ndërroi zë e fytyrë.

— Pse, ç'kujton ti? Aq punë sa keni bërë ju duhet të bëjë argati në ditë?

— Kemi punuar që ç'ke me të. Aq sa të ka dashur qejfi ty kemi punuar!

— Jeni tallur! Keni lozur me paratë e agait, që haram i paçi! Po këtej e tutje s'ka më sofër qorrash, jo! Ata që do të mbeten, vërtet që do të punojnë edhe një muaj, po bashkë me punën që kanë bërë.

do tē bëjnë edhe atë që do tē bënин ata që do tē largohen.

— Ai deshi tē fliste edhe më, po aq frymë i mbante kafazi i kraharorit, bïle nga zori i fjalëve tē fundit edhe sytë iu bëjnë sa dy kokrra vezë breshke, ndërsa duart mbërthyen pantallonat që po i ëmbinin, se edhe barku i firoi e iu bë njësh me kurrizin.

— Ç'bëhet kështu? — e pyeti Sezaiu Thomanë.

— I pushojnë nga puma.

— Pse?!

— Se duan tē kryejnë sa më shumë punë, me sa më pak para. Avaz i vjetër ky. Pesë thotë agai, dhjetë i bën kryepunëtori; pesë për vete, pesë për aganë.

— Po këta ku do tē punojnë?

— Në gjeçin, do tē punojnë; nuk nesër.

— Po halli?

— Keq i kanë punët.

— Djall, o punë!

— Kështu e bëjnë tē gjithë, po mjerë tē varférít!

— Jo, more; jo! Kaq kollaj nuk kalon kjo punë. Kemi kalamaqër ne. Duan tē hanë ata. Dhe, duke u afruar te kryepunëtori, argati vazhdoi: — Ty tē duket se unë ia ngul thonjtë baltës për tē mbledhur ullinj, apo jo? Po s'është ashtu! Unë qëmtoj thërrime në baltë, e kupton ti, apo jo? Thërrime buke për kalamaqërit. E di ti që kam katër kalamaqër unë?! Duan tē hanë ata. Nga këta krahe presin — dhe rrahu krahet me shuplakat e ashpra e plasa-plasa.

— I paç me shëndet! Rrësku yt janë. Kot që m' i kujton mua, se unë s'u kam asnjë borxh. Ti i bëre, ti dilu zot! Hajde, nisuni ju tē tjerët!

Po asnje nga argatet nuk levizti nga vendi.

— Dëgjo këtu ti! — ndërhyri një argat tjetër!

— Shikoje mirë këtë punë, zahmet e ke, se as ne të tjerët nuk punojmë dot aq sa thua ti, as këta që po ndjek ti nuk do të rinë pa ardhur në punë, more vesh?!

— Jo, more?! Qenke serbes zotrote!

— E, e, kështu si të them unë ty!

— Ti rri rehat e thuaj shyqyr që s'të zuri maja e kalemit!

— S'më zuri mua, zuri shokët e mi; s'më zuri sot, më zë nesër.

— Mirë e keti ti. Po s'erdhën këta në punë, nuk vij as unë!

— Po deshe hajde, po s'deshe mos hajde.

Kryepunëtori i tha këto fjalë duke u munduar të mos shprehte asnje lloj shqetësimi për rrugën e re që po merrte gjendja, megjithatë, thellë ai e ndjeu se fjalët e argatit ishin një shkëndijë e rrezikshme.

— Kam frikë se mos nuk vijnë as të tjerët — tha argati, ndërsa kryepunëtori vuri re se shkëndija po binte tamam mbi benzinë.

— Po patën kokën tënde, le të marrin mendjen tënde.

— Ata dinë t'i mendojnë vetë punët e tyre, po këta që po ndjek ti sot janë vellezërit tanë. Të varfér e të vuajtur si ne. Sot ndoqe këta, nesër dhjetë të tjerë, pasnesër të tjerët. Tërë punën që do të bënin ata që ndjek, do t'u ngarkosh atyre që mbeten.

— Kot fjalët! Po të pëlqeu, hajde, po s'të pëlqeu, mos hajde! Nisuni ju! — tha kryepunëtori dhe vetë i pari ktheu kurrizin e bëri të ikte për të

fshehur shqetësimin e madh që ndjeu pas atyre që dësioi.

— Mos u nxiton, vëllezër! Po, të ngulim këmbë ne, ai do t'i marrë edhe këta.

— Ngulni këmbë sa të doni! Asnjë më tepër nuk marr!

— Do, të marrësh, se s'ka kush t'i hapë pallakomat e ullinje.

— Do t'i hapin ata që kanë nevojë për bukë.

— Po s'erdhëm ne, s'ka kush e bën atë punë se, me aq sa paguan ti, s'të vjen njeri të punojë. Pa le që ku i ke dhe të tjerët?! Të paktën edhe dy-tri javë punë ata e kanë të siguruar në ato vende ku janë pajtuar.

— Mirë e ka Saliu! Po i përzuri këta, nuk vemë as ne!

— 'Ashtu do të bëjmë! O, të gjithë, o asnjë!

— Daleni, more! Sos u tërbuat ju?! — ndërhyri kryepunëtori. — Mos merrni mendjen e Saliut, se ky gjithnjë dy dërrasa mangut ka patur!

— U tremb! — thirri Saliu. — E patë si e drodhi? — dhe u kthye nga kryepunëtori. — Ne kështu do të bëjmë. O të gjithë, o asnjëri! Apo jo, vëllezër?

— Po sikur të marrë të tjerë? — pyeti me gjysmë zëri një argat i paktë në trup e i verdhë në fytyrë.

— Do të marrim që ç'ke me të! — ndërhyri me rrëmbim kryepunëtori.

— Ku do t'i gjejnë?

Kësaj radhe ishte Saliu ai që e ngrinte zërin.

— Të tjerët janë të zënë me punë, kurse këta i bëjnë këto se duan ta blejnë sa më lirë djersën tonë.

- Ashtu do tē bëjmë.
- O tē gjithë, o asnjeri!
- Ashtu, ashtu!
- Tē mos i lëmë shokët nē baltë!
- Tē mos ndahemi! O tē gjithë nē punë, o tē gjithë nē shtëpi! Nē djall tē venë tē gjitha! Pse, kafshë jemi né që t'ua mbajmë gjithnjë shtruar kurrizin kamzhikëve tē këtyre?
- Dō tē mèrrni veten më qafë, them unë.
- E, kryepunëtor, si ma kë syrin?
- Mblidhni, more, mendjen! Salinë dëgjoni ju?!
- E ndërrrove çehrenë, kryepunëtor!
- Do tē vijmë tē gjithë, apo tē ikim tē gjithë?
- E fituan davanë. Ikim — i tha Thomai Sezaiut.
- Si e fituan?
- S'ka ç'bën kryepunëtori. I ngeci sharra nē gozhdë. Hajde tē ikim!

## XI

### TE HANI I REXHO NALLBANIT

Vërtet që grumbulli i argatëve mbeti prapa krahëve të tyre e ata u futën në rrugioën e kovave e të butexhinjve, po mendja e të dyve punonte bashkë me mendjen e atij grumbulli aty nën tri kurorat e selvive.

— Sa mirë i vajti mendja atij Saliut! — u kënaq Sezaiu e fare papritur iu kujtua ajo historia e Afézit të Meçes me Canen e Ramazan agait e xhändarët që morën vratin kur doli téré fshati pér të mbrojtur ata të Meçes.

— Eh, more Sezai vellai! Të varférít janë fuqi e madhe, po duhen zgjuar — ia ndérpreu Thomai fillin e mendimeve Sezaiut.

— Sezo! Mbarova! S'më bëjhë më këmbët! Po më zihet fryma!

Sezaiu ktheu kokën.

Merushja po dridhej e téra.

Me një dorë mbante fort injekrën, me tjetrën shtrëngonte gjoksin.

— C'pate?!

— S'jam mirë. Kam ethe. Më plasën témthat. Seç më shtrëngon këtu në gjoks. Më shtrëngon e më djeg. Më mori frymën.

— Mbahu edhe pak! — ndërhyri Thomai. — Ja. arritëm.

— Mos na turpéro! Sa të vemë te hani, pa shohim e bëjmë. Mbahu tevdjali!

— Merrma pak dengun! — dhe ajo zgjidhi terkuzën.

Dengu i mbëshqellë, me velenxën, e dhirtë ra në shesh.

Thomai e mori dhe e vuri nën sqetull.

— Nuk jemi larg, ja arritëm — tha ai dhe u kthye i pari në bërrylin e rrugicës së butexhinje e të kovaçeve.

Edhe aty kishte zhurmë e lëvizje.

Çekanët, sqeparët e skarpelet u mbanin iso lëvizjeve ritmike të krahëve muskulozë. kurse vajreja e kovaçit, që shtypte hekur të skuqur, në kudhër, sikur mbante ritmin e tërë asaj valleje të gjallë pune.

Pas dredhës së parë të rrugicës së kovaçeve dhe butexhinjeve, ata u ndodhën ballë për ballë hanit të Rexho Nallbanit.

— Erdhëm — tha Thomai.

— Hej, Sezaiu!

Megjithëse krejt i papritur, zëri iu duk i njohur, i ngrohtë, i dashur.

Ngriti kokën.

Përpara tij qëndronte buzëgaz Lamçe Hyseni. Përbri tij një burri të tjetër, me trup të shëndoshë e mesatar, rrëth të pesëdhjetave.

— Ai është — tha Thomai.

— Ja mushka — thirri vogëlushi.

— Shëët! — shqiptoi nëpër të dridhura Merushja dhe e tërhoqi vogëlushin pranë vetes.

Po Sezaiu e kishte humbur fare nga takimi i ppritur me Lamçe Hysenin e as që i dëgjoi fjalët e Thomait, thirrjen e gjëzuar të vogëlushit dhe urdhërin e mekur të Merushes.

Lamçja se ç'i tha me zë të ulët Rexho Nallbanit.

Ai ktheu kokën nga Sezaiu dhe buzëqeshi.

Sezaiu ndjeu një afsh të nxeh të që i mori përpjetë fytyrës.

«Turp!» — tha me vete, po Lamçe Hyseni sikur e pikasi këtë zë, sikur e pa të shprehur në tënë qenien e Sezaiut, në lëvizjet e tij, prandaj edhe lëvizi përpëra.

— Ne të pritëm që mbrëmë, bile shkuam edhe nga pazari me Rexhon, se mbasë të gjenim atje — tha Lamçe Hyseni duke u afruar.

Pas tij, me një qeshje të embel në fytyrë, u afrua edhe Rexho Nallbani.

— Më i lind jepet, këtëdje ëmri vudhur ilirë, i cili konsiderohet si njëri i parë i lirëve së cilët kanë qenë i lirë i përgjithshëm. Të cilët kanë qenë i lirë i përgjithshëm?

— Më i lind jepet, këtëdje ëmri vudhur ilirë, i cili konsiderohet si njëri i parë i lirëve së cilët kanë qenë i lirë i përgjithshëm?

— Më i lind jepet, këtëdje ëmri vudhur ilirë, i cili konsiderohet si njëri i parë i lirëve së cilët kanë qenë i lirë i përgjithshëm?

— Më i lind jepet, këtëdje ëmri vudhur ilirë, i cili konsiderohet si njëri i parë i lirëve së cilët kanë qenë i lirë i përgjithshëm?

— Më i lind jepet, këtëdje ëmri vudhur ilirë, i cili konsiderohet si njëri i parë i lirëve së cilët kanë qenë i lirë i përgjithshëm?

— Të veshur me veshje e lirë, Rexha u kujdes që nuk i përfshinte se çfarë është qëndruar. Në shtëpinë e tij, u rritën gjithëpërveç një dritare që u rritur me vërtetë. Rexha u rrit me vërtetë, u rrit me vërtetë, u rrit me vërtetë.

— Të veshur me veshje e lirë, **XII** — Rexha u kujdes që nuk i përfshinte se çfarë është qëndruar. Në shtëpinë e tij, u rritën gjithëpërveç një dritare që u rritur me vërtetë. Rexha u rrit me vërtetë, u rrit me vërtetë, u rrit me vërtetë.

## N J E R È Z I T

— Të veshur me veshje e lirë, Rexha u kujdes që nuk i përfshinte se çfarë është qëndruar. Në shtëpinë e tij, u rritën gjithëpërveç një dritare që u rritur me vërtetë. Rexha u rrit me vërtetë, u rrit me vërtetë, u rrit me vërtetë.

Në shtëpinë e Rexho Nallbanit Sezainë e pritën si të ishte ndonjë mik i vjetër.

E shoqja e Rexhos, Havaja, u kujdes që miqve të mos u mungonte asgjë, kurse Rexhua me të birin, Hyson, u përpoqën që edhe ai edhe e shoqja me të birin të ambientoheshin sa më shpejt që të ishte e mundur me gjendjen e re. Lamçe Hyseni, nga ana e tij, iu bind me fjalën e parë Rexhos për të qëndruar edhe dy a tri ditë të tjera, se, si i njohur më përpara me miqtë, do t'ua lehtësonte gjendjen e re.

Në mënyrë të veçantë Havaja u kujdes për Merushen.

Që sa i solli Rexhua në shtëpi, asaj nuk i pëlqyen as të dridhurat as të nxehjtë e Merushes.

«Kjo lumëmadhe qenka ftohur» — tha me vete dhe e gjeti kohën për ta tërhequr pak mënjanë.

— Aman, të keqen — iu lut Merushes kur e çoi në dhomën e zjarrit — se s'kam as vajzën këtu!

Iku te dajot shejtanka, nē Gorricēne kushedi kur u mbushet e ma kthejnē. Bēni pak hýzmet zjarrit, se vetém s'ù bëjidot ballē tē gjitha punëve! Mos m'i kurse drutē! Tē bëhet sa më shumë shpuzë, se nē odë s'rrihet dot pa mangall.

Megjithëse i erdhi pak zor, Merushes iu bë qejfi që e ulën pranë zjarrit, se mendoi që afshi i zjarrit do t'ia largonterratë «tē flamosur éthe.»

Havaja u duk përséri nē derë.

— Ja edhe drutë tek i ke — i tha Merushes dhe lëshoi nē fund tē dhomës një krah bujashka ulliri. Eshtë dru i mirë ky. Digjet më shpejt nga lisi dhe bën një shpuzë që tē kënaquribm.

Pastaj doli, shkoi nē dhomën e pmiqve si pér tē marrë mangallin e duke dalëti bëri me shenjë tē shoqit.

— Dëgjo! — i tha kur ai gjeti çastin e doli nē korridori. — Ajo eshtë shumë e sëmurë. I ka vënë rrëth syri! I dridhet mjekra sikuri tē ketë marrë plevit.

— Vëre pranë zjarrit, se do tē jetë ftohur ndopak.

— U, korba! Mua më thua ti? S'eshtë pak ajo. Bën ç'të bësh e dërgo njeri pér doktor, se s'më gënjen syri mua!

— Tani s'dal dot.

— Po unë s'thashë tani. Kur tē vijë Hysua, dërgoje...

Tërë pasdreken Havaja u kujdes që Merushja tē mos largohej nga zjarri. I pruri aty edhe tē birin, tē cilin, pa kaluar as edhe një orë, e zuri gjumi pranë zjarrit, ashtu me kokën tē mbështetur nē prehrin e së èmës.

Megjithatë Merushja nuk u qetësua.

Havaja iu lut që ajo tē shtrihej e tē merrte një sy gjumë, po ku dëgjonte Merushja; kurse pasdarkerë, vonë, ajo e fërkoi dhe i hodhi edhe kupa. — Ezëza ti, sá qenke ftohur! Tu bënë shpatullat si shpretkë e zezë.

— Do tē më kalojë — i tha Merushja — po më bezdis ca kjo e djegura në brinjë e në shpatull.

— Moj me këtë tē fërkuar e me këto kupa do tē dalë se s'bën ajo, po i që do tē vuash, do tē vuash ca.

— Më qepi që mbrëmë. Endjeva unë, po s'kishim ç'të bënim,

— Të kishit ardhur që mbrëmë. Merushja, që s'dinte ç'të thoshte, mbështeti më minë faqen hë këllëfini e bardhë tē jastëkut dhe mbylli sytë.

Tërë atë natë Havaja nuk fjeti, se Merushes i hipi aq zjarr, sa filloj tē fliste përcart; kurse ajo s'ia ndau nga balli pecen me uthull e më lëng qepc.

— Tu që i keni qëndruar, qëndroj!

### XIII

## NATA E RRÉFIMIT TË NJË JETE

— ...Pas babait mua edhe nënës na mbetën rripat e ngushtë të tokës në Këmba, shtëpia dhe kali.

Tokën e kishim të paktë, po të mirë. Nëpër rripa babai kishte ngritur praje gurësh që të mos na i gjerryenin rrëketë. Toka ishte e butë, se babai e kishte qëruar pëllëmbë më pëllëmbë, bile edhe plisat e vëgjël i kishte bluar me pëllëmbë të dorës.

Të gjithë na e kishin zili atë tokë e ajo, si për t'uva shtilar më tëpër zilinë të tjerëve, prodhonte më shumë se çdo copë tjetër tokë në fshat.

Unë e nëna gdiheshim e ngrysëshim në rripa. Shkonim atje edhe kur s'kishte punë, se ashtu urdhëronte nëna.

Nuk rrinim kot, jo, se ajo ishte nga ato që s'i pu shonte dora. Ta gjente punën edhe atje ku s'ta priste mendja.

Vitet kalonin, unë rritesha, nëna plakë, po rripat në Këmba mbeteshin atë që kishte lënë babai, ashtu siç i kishte lënë ai.

*Një natë, kur ne sapo ishim kthyer në shtëpi, në portën tonë trokiti Kamberi.*

*Kamberi ishte qehajai i Zaim aga Çikës.*

*Ai e kishte dërguar.*

*Kamberi hyri brenda buzëgaz.*

*Jashtë kishte filluar të frynte Gryka. Gryka sillte erë të ftohtë.*

*Kamberi qeshte e fërkonte duart.*

— Ftohtë jashtë — tha ai e u afrua të ngrohej në zjarrin e sapondezur. Unë dhe nëna mbetëm më këmbë te dera.

— As ma ngroh një çanak qumësh, moj nusja e Zenunit — tha ai pa e kthyer kokën nga ne — se më ka vajtur e ftohta në zemër.

— Ti e di që dhitë e mia m'i çau bisha atë vit që m'u vra im shog — iu përgjegj nëna.

— Po vetëm, me misër s'rrohet, moj nusja e Zenunit — tha ai. U ngrit më këmbë dhe u kthye nga ne. — Njerinë vërtet, e mban misri, po misri pa bulmet s'mjafton. Te ne edhe qentë kanë çanakët e tyre.

— Po të më bëhet mbare, do të kem edhe unë.

— Po nga qelli ato të shkreta nuk bien, moj nusja e Zenunit.

— Përse ke ardhur ti? — e pyeti prerë nëna.

Ajo ishte nga ato që, pa dalë mirë lumi, e dinte ç'trungje do të sillte.

— S'je budallaçkë ti, jo! — u përkëdhel Kamberi — ta ndjen të mirën hunda që një orë larg.

— Të gjitha të mirat i kam — i tha nëna — gjynah të qahem.

— Po ti sikur po ma pret me sëpatë, moj nusja e Zenunit!

— Të kam parë ca herë rrrotull rripave në Këm-  
ba — i tha nëna.

— U robtove atje.

— Unë nuk i jam qarë njeriu.

— Po e ke larg, moj e uruar, pastaj rripa... .

Rrëketë mbi kokë, pylli afër.

— Më mirë ashtu. Rrëketë sjellin ujë, pylli pleh.

Qar ka toka.

— S'është për ty ajo tokë. Këtu nën shtëpi ke një goxha ngastër. Aty mund të mbash edhe nja dy dhi. Siç e shikon, Zaim agai është shumë dorëlë-  
shuar. Edhe tokë edhe dhi... .

— Po nëna nuk e ndërrroi tokën.

Pas një viti Kamberi erdhi e kërkoi prapë çanakun me qumësht të ngrohtë, po nëna prapë nuk e ndërrroi tokën.

Një javë më pas kali na ngordhi. E gjetëm të fryrë si kacék. Në buzë i kishtengrirë shkumë jeshile.

Mullai i Rrëzës na tha se kali kishte shkelur në xhind fémér. Shiu i parë na rrëzoj praqet e rripave në Këmba.

Vetëtima e parë na preu pjergullën rrëzaki të oborrit. E preu rrafsh me tokën, sikur ta kishte goditur sëpata.

Te rripat në Këmba, xhindet qelluan me gurë.

— Është egërsuar xhindi mashkull — tha Mullai i Rrëzës. — Xhindit i duhet hapur rrugë.

— C'rrugë të hap? — e pyeti nëna Mullain e Rrëzës.

— Djali të rruat e t'u bëftë i hairit, moj nusja e Zenunit, po një dritë syri të fali perëndia.

— Korba, ku të vete gjuha!

Po xhindit mashkull s'po i dilte inati.

*Ara u mbush me gürë.*

*Një gur i madh ra te këmbët e mia.*

*Nëna shkoi te Kamberi.*

*Ne morëm ngastrën nën truall dhe dy dhitë.*

*Mullai i Rrëzës na bëri një muskë, hëngri kapama  
me bollgur e hasude, mori një karroqe misër të ri e iku.*

*Pas tij s'u panë më as xhindet...*

*Kështu na e rrëmbeu atë farë toke Zaim agai.*

Rexhua e Lamçja dëgjonin duke thithur tym duhanj, mbështetur me bërryle mbi jastëkët e stromave. Hysua, praptas në stroma; me duart, të kryqëzuara nën kokë, e kishte tendosur shikimin në një pikë të tavanit.

Mangalli në fund të dhomës ngrohte me shpuzë ulliri.

Jashtë binte shi. Një shi i imtë. Një shi fëshfëritës.

*Deri në vjeshtë e qëruam ngastrën nga barërat e gurët, e sheshiuam dhe përfundi i ngritëm edhe një ledh guri që të mos na e roitnin rrëketë! Rreth e rrötull saj mbollëm fiq e ftonj.*

*Asaj vjeshte më fejuan.*

*Më fejuan larg e me njerëz që s'kërkuan shumë.*

*Nëna nisi të ziente mare për të hedhur rakinë e dasmës, se dasma do të bëhej shpejt.*

*Po ai dimër punoi keq.*

*Tri herë e hodhëm farën e të trija herët na e qëmtoi lloha.*

*Farën e katërt e mbuloi bora.*

*Ngrica s'u pre tërë dimrin. Bora binte e ngrinte mbi borë.*

Vetäm marsi e çau qiellin, po qielli u ça që tē mos mbyllej mē.

Fara mbiu, po mbeti sa një vetull. Dyllé e verdhë e petë e hollë. Ajo as u mbush e as hodhi shtat, sa e dogjën juga shterpë e dielli. Një jugë e thatë, sa tē zihej fryma e një diell që tē digjte si saç i skuqur.

— Do ta kemi keq sivjet — tha nëna tek rrinte atje mē bisht, me kokën në mes tē grushtave, në krye tē ngastrës.

— Do ta kemi keq sivjet — thanë plegtë e fshatit.

— Do ta kemi keq sivjet — tha majë kalit Kamber Hakimi.

Bima zverdhej e rrëgjohej.

Plegtë numronin tespiet më vetulla tē ngrysura. Unë dhe nëna sillnim ujë me bucela nga lumi. Toka e pinte ujin e bucelave me ca gojë si gryka shpellash që përpinin ujë e villnin avull. Avull tē dendur, Avull më shtëllunga, edhe bima prapë zverdhej e rrëgjohej.

Tërë ditën s'na pushqin këmba e dora.

Tërë natën s'na zinte gjumi.

Nënës iu värën shpatullat e syri i vuri rreth.

Plegtë e fshatit u mblodhën në lëmë. Të gjithë më tespije në dorë, të gjithë vetullngrysur.

— Si këtë vit asnjëherë — tha më plaku.

Rrëzës:

— Digjni shkurrishtet.

— Pa kurban s'ndreqet kjo punë — tha Mullai i Rrëzës. — Tre desh tē zinj me blanë tē bardhë në ballë.

Atë natë tërë Rrëza llamburiti nga flakët e shku-rrishteve.

Njerëzit u gdhinë në praqet e portave.

Tymi u mbështoll si kurorë mbi majën e Çikës.  
Natën hëna vuri rreth.

— Shyqyr i qoftë të madhit zot! — thanë më plegjtë — s'e la zoti në baltë fukaranë.

Juga fryu prapë.

Një jugë e vakët, një jugë e butë, një jugë e dashur.

Juga pruri re me vete. Re të zeza. Re të ngarkuara. Po retë fluturuan shpejt e lart.

Kaluan malin, pëershkuan fshatin, spërkatën trojjet me ca pika të imta e të vakëta, hodhën lumin e humbën tutje, tutje, matanë maleve.

Gazi i fshatit ngriu në sofatë e praqeve.

Në vjeshtë nëna më dergoi në derë të Zaim aga Çikës.

Kamberi më priti me buzën në gaz.

Caktuam kamatën, bënnë një senet e une mora edhe për të ngrënë, edhe për të harxhuar ditën e dasmës.

Kur më përcollit te porta, më rrahu krahët.

— Je goxha djale — më tha — s'i ke lënë gjë Zenunit. S'i rrinte, lumëmadhit, as këmba as dora. Unë e ndjeva që po skuqesha, prandaj ula kokën.

— E, more djale — më tha — makar dhe gjysmën e bujqve të kisha si ti. — Psherëtiu, fërkoi mjekrën dhe prapë më rrahu shpatullat.

— Të vaftë mbarë vitin tjetër — më uroi.

Unë zbrita shkallët nën sofati.

Ai mbylli portën prapë krahëve të mi.

Në shtëpi gjeta nënën të sëmure. I çante téré krahu i majtë dhe në gjoks ndjente një hon.

Buza i ishte nxirë, sytë i qenë thelluar, fytyra i ishte zbardhur, kurse këmbët mezi e mbanin.

Tërë natën e kalova mbi kokën e saj.

Rënkonte gjatë, mbyturazi e tërë dhembje, kurse gjoksi i përpëlitez si zog i therur.

Të nesërmen u għidhi mē mirë.

Għieth vjeshten vazħdoi sémundja e saj. Aty bēhej mirë e aty keq-esohej, kurse buza i rrinte gjithnjé e zeżże e ajo ankohej se s'kishte fuqi; se kishte dhembje né tē majtē tē gjoksit. Njē dhembje që e shponte si turrijel, njē-dhembje që ġie sħtrydha.

Ditën e-dasmës nēna u bē keq.

Papritur u nxi e ra né këmbé e né shesh.

Nusja e harroi nusəriné. Nusja e harroi zakonin.

U sul te nēna, e ngriti né krahé, e vuri né stroma, hapi dyer e drittare, u ul prané saj e s'luajti që andej tērē ditën e tērē natën.

S'i la /këmbé e duar, pa fērkuar. S'i la /damar pa ndrydhur.

Vjeshten, e tretē, filluq, shirat.

Unē, shkova prapē te Zaim tagħha. Ġika,

Kamberi, mē dha edhe pēr, farē vedhe pēr abukē, po shirat s'po pushonin.

Vjeshta e tretē u mbyll me kohē tē mirë, po me ererà tē forta. Ererat, frynin tē ngaterra u. Aty frynte veriu, aty lindja e aty juga.

Ererat e thanē tokën.

Unē, dha nusja, hodhēm farēnu.

S'kaloi java e nga toka dolēn bisqet ixfara. Ca bisqo tē shéndetshme, ca bisqo tē mbara, që erdhën dha e mbuluu tokën, si një qilim i għelbér i rrahur mirë.

Nēna, shikonte, ngastrēn, nga drittarja e t-qeshtebuza.

— Ne i gëzoheshim ngastrës si perëndisë.

Bima rritej e rritej e shëndetshme!

Një mbrëmje, kur po kthehesha nga mulliri, takova rrugës Mullain e Rrëzës. Lashë hejbet e këmbiyem nga një duhan.

— E pashë ngastrën tënde — më tha. — Binën e ke të mbarë.

— Të mbarë e kam — i thashë — po ajo që shkoi na trembi shumë.

— Ajo shkoi e vajti. Një duman ishte ajo.

— Po dhitë i ke? — më pyeti.

— M'u shtuan — i thashë unë. — Sivjet i kam me keca.

— Njerën do ta marr unë — më tha — me gjithë kecin.

Unë hapa sytë.

— Më pikoi në zemër, kur të ngordhi kali, se kafsha është krah për fshatarin — tha ai pa i ngritur sytë. — Nuk të shikoj dot poshtë e përpjetë më hejbet në krahë. Muat më polli pëla mushkë. Të dyja s'kanë ç'më duhen. Ma kanë kërkuar shumë po unë ta kam taksur ty. Bisedoje një herë me nënën. Nesër unë do të dukem prapë këtej.

Takuam duart dhe u ndamë. — Në shtëpi nëna po i tregonte nuses për babanë. Ajo dëgjonte dhe i ndryste krahun e majtë.

Unë u ula pranë tyre.

Sytë më vajtën në murin karshi. Aty varej pushka e babait.

Unë i ngula sytë mbi të.

— E nxora — më tha nëna. — Ti u rrite tanë.

Unë shikoja pushkën varur në mur dhe m'u kujtua dita që përcollëm çetën. Bashkë me çunat e tjerë të fshatit u vamë pas deri në va të lumit. Kuit

*u ndamë, bábai më tha: — «Në mos ardhsha unë, Kapedani do të ta sjellë pushkën time. . .»*

*Kur mbaroi lufta, Kapedani më solli pushkën e babait.*

*Mua më pëlgente shumë pushka, kurse fishekë gjeje ngado që të hidhje sytë.*

*S'ë hiqja nga supi derisa mbreti lëshoi urdhër për dorëzimin e tyre.*

*Që atëhere nëna e fshehu.*

*E mëra pushkën në dorë. M'u duk e rëndë.*

*Duke trazuar shulin, i tregova nënës për mushkën e Mullait të Rrëzës.*

*— Jepja! — më tha. — Boll e kemi njjerën dhi me kec. Vitin tjetër ato prapë do të bëhen katër.*

*Mua m'u bë qejfi.*

*Edhe nëna e ndjeu që u gëzova.*

*Të nesërmen, kur erdhi Mullai i Rrëzës, unë i dhashë dhinë me kec e ai më dha mushkën këlyshe. Mullain e Rrëzës e përcolla deri te lëmi.*

*— More djalo — më tha kur kishim takuar duart për t'u ndarë — kam dëgjuar se do të na sjellin një mësues qyteti në fshat. Shiko, hapi mirë sytë, se të tërbojnë ata. S'kanë din e iman ata me shkollë. Unë të dua si djalin tim, pa të them.*

*Sezaiu ngriti kokën.*

*— Ngrehu, o Hyso! — e urdhëroi Rexhua të birin. — Merrna nja dy ftonj.*

*— Mbështet mëritët? — pyeti Sezaiu.*

*— Jo, jo!*

*— Hysua u ngrit, këputi dy nga ftonjtë e varur.*

në tavan, mori biçakun në xhaketën e të atit dhe i preu ftonjtë në dritare.

— Ngreja pak fitilin llambës, se u venit fare.

Në dhomën tjetër u dëgjua një kollë e mbytur, e gjatë.

— Nusen nuk e këmire — i tha Sezaiut Rexhua. — Të është ftohur. Mirë është të sjellim një doktor.

Sezaiu uli kokën dhe psherëtiu thellë.

Hysua i dha secilit nga një gjysmë ftoi të qëruar.

— Eh, more djali i xhaxhait! — tha Lamçe Hyseni. — Kanë qenë vite të rënda ato! Vitin e dytë edhe te ne ashtu mbiu fara! E dendur, e shëndetshme. Po ç'e do se e kalbën shirat e pranverës. Tre muaj pa pushuar shiu! Kurrë s'kishte bërë vaki!

— E mbaj mend mirë unë atë kohë — tha Rexho Nallbani. — Vajti një napolon qaseja e misrit.

— Po fshatari s'kishte napolona — tha Hysua duke përtypur një copë ftua — kurse Zaim aga Çika me shokë atë donin.

— Doemos atë donin — tha Lamçe Hyseni. Ai, që s'ka me çfarë të mbushë barkun, do të zgjatë dorën.

— Tërë atë behar hëngrëm lakra të ziera dhe lende lisi. Nëna s'më la të veja prapë te Zaim aga Çika.

Të tjerët shkuan. Kamberi s'u dha më misër. U dha para. Ata erdhën në Vlorë e blenë béréqet.

Kur erdhi vjeshta, ata s'punuan më në tokat e tyre. Kamberi ua kishte blerë me gjithë troje. Ca u bënë bujqë të Zaim agait, ca ngarkuan e zbritën në Vlorë. Trualli dhe ngastra ime mbetën si pykë

*midis tokave të agait. Kamber Hakimin e shikoja shpesh aty përreth. Herë qeshte e më përkëdhelte me ca fjalë të mira, herë e kyçte gojën dhe shikonte ngastrën me zili.*

*Në vjeshtën e dytë më vdiq nëna.*

— *E ka qoditur — tha Mullai i Rrëzës. — Kaq ishte rrësk. Me të dashurin e saj perëndia kështu sillet. Në kokë e në gropë. Ti të rrosh vetë dhe të nderoftë perëndia me ndonjë djale!*

*Kur u tëharrën njerëzit, më erdhi Kamber Hakimi.*

— *Të rrosh vetë — më tha edhe ai. — Kaq ishte rrësk.*

*Unë e prita si e desh zakoni.*

*Ai ndenji shumë atë natë. Ndenji e s'pushoi së foluri. Foli për perëndinë, për robin e saj; për tokën, për kohën dhe për prodhimet e tokës. Mallëkoi djallin që u kishte prishur terezinë punëve të zotit dhe i qau hallin robit që vuante kusuret e terezisë së prishur.*

— *Po shqyr i qoftë Zaim uga Çikës, që ua hapi derën të gjithëve e s'i la të vdiqin ngauria. E tregoi veten Zaim aga Çiku, po edhe hambarët e tij po terën. S'i thonë shaka të mbahet tërë fshati me një hambar e një qere. Po i ihois u druaj. Fu të jesh keq, aty e ke Zaim aga Çikën.*

— *Këq jam sa s'kë ku të vejë, po jam futur aq thellë, sa s'mban më.*

— *Të tjerët s'e kanë keq. U bënë bujq dhe vëtëm punën dinë. S'i kanë më telashet e tua. Po ti bëj si të duash, vetëm se mua më vjen keq kur shikoj që robtohesh e s'të del gjë në kut.*

— *Kurrë, kurrë! — i thashë. — Sa të jem gjallë, dua të jem zot i vetes!*

— Mirë, mirë — më tha. — Unë s'të thashë të bësh si të tjerët. As derën s'ta mbylla. Ato që t'i thashë, m'i tha zemra; kurse Zaim aga më porositi të të pyes çfarë të duhet e sa të duhet.

Unë i kërkova përfarë e përtë ngrënë.

Përfarë më dha misër. Përtë ngrënë më dha para.

— Hajde nesër t'i marrësh — më tha e u ngrit e iku.

Po-atë natë më trokiti në derë kryeplaku i fshatit.

Bashkë me të hyri edhe një i panjohur, i veshur si nga qyteti. Nën sgetull mbante një trastë me libra.

— Eshtë mësuesi — më tha kryeplaku.

— Urdhëroni — u thashë unë.

U futën brenda dhe u ulën pranë zjarrit.

Mësuesi na qenkësh gojëzgjidhur.

Kryeplaku sâ e filloj, kurse ai sikur aq deshi. As mbahej më të rëndë e as druhej se ndodhej midis të panjohurish:

Pas pak kryeplaku ia preu fjalën.

— Dëgjo, ti, Sezai — m'u drejtua mua — këtë djalë na e dërguan përtë na mësuar kalamaqët. Meqë ti je më i lirë nga të gjithë të tjerët, ne, si pleqësi, e pamë të udhës ta lëmë hëpërhë te-ti. Një copë vend do të të zërë, se përtë ngrënë e përtë pirë ka rrrogën ai.

Unë nuk dija ç'të thosha, kurse mësuesi s'priti të flisja unë.

— Fshatari ynë s'e ka mbyllur kurrë derën për mikun — tha.

— Unë erdha këtu për ju. Përtë mësuar fëmijët tuaj. Do të fitoj me ju dhe do të punoj me ju.

Dhe vërtet, sa gjente pak kohë të lirë, ai rrëm-bente shatin e punonte krah pér krah me mua në ngastër. Punonte e më fliste edhe pér tokën, edhe pér farën, edhe pér plehun; kurse unë çuditesha sa mirë i dinte ai punët e bujqësisë.

Herë pas here ai shkonte në qytet e, kur kthe-hej, s'na linte pa na prurë ndonjë dhuratë.

U bëmë si vëllezër me njëri-tjetrin.

Nga fundi i janarit Kamberi erdhi prapë. Mua dhe mësuesin na gjeti rrëth vatrës.

U ngritëm e i hapëm vend.

— Mirë po na vete sivjet — e hapi bisedën ai. — Ishallah të mbajë kështu edhe më tej! Po do të mbajë, se perëndia s'è lë në të keq robin e saj.

Mësues Qaniu ngriti kokën, e pa me kujdes dhe, si vuri pak buzën në gaz, i tha: — Kur ka zemërgjerë si Zaim aga Çika, edhe po të mos, i mbledhë mendtë perëndia, s'mbetet keq fshatari i Rrëzës.

— Ca llafe si këto i kam dégjuar edhe nëpër fshat — tha Kamberi. — Ju mësuesit e keni gjuhën ca si shumë azgane, po ndonjëherë duhet edhe freri.

— Freri duhet pér kafshët, o Kamber Hakimi — ia priti Qaniu. — Po unë kam vënë rë se fshati juaj edhe kafshët i ka të pakta. Në qoftë se ju ngatërroni kafshët më njerëzit, hapni sytë mirë, se njeriu nuk e duron frerin!

Ata u grindën edhe ca me njëri-tjetrin, pastaj Kamber Hakimi m'u kthyë muaj.

— Erdha të bëjmë llogaritë — më tha.

E ndjeva nga zëri se ishte zemëruar shumë.

Me duart që i dridheshin nxori një defter nga xhepi dhe, duke u kollur si pér të pastruar fytin, e shfletoi duke i ngulur me interesim sytë faqe më faqe.

— Unë e di sa borxh tē kam — i thashë.

— E di ti, po më mirë nga ne tē dy e di defteri — më tha dhe vazhdoi tē shfletonte. — Në defter janë tē gjitha llogaritë.

Unë ula kokën e prita sa tē gjente Kamberi llogarinë time.

Po nga e gjithë ajo llogari, kur vola misrin në ngastër, lava vetëm kamatat dhe taksat.

Kamberi u bë bishë.  
Unë rrija e vrisja mendjen pën tē kuptuar se ç'e ndërrroi Kamber Hakimin kështu, po ai s'më linte as tē mendoja.

Sa më shihte, më kthehej e më lemeriste me tē bërtitura e tē shara. Dhe një ditë më thirrën në kullë. Zaim aga Çika rrinte në shilte pranë oxhakut. Pinte raki e thithte tym duhani nga një cigarishte e gjatë sa një krah burri.

Kur i thanë që erdha, ngriti kokën e më pa vëngër me njerën vetull përpjetë.

Asnjëherë s'e kisha parë aq afër.

Qaniu më kishte porositur tē mos e merrja me frikë, po unë, mbasë edhe ngaqë s'dija ç'të bëja e ç'të thosha, fillova tē dridhesha.

— Ti s'më lave borxhin — më tha Zaim aga Çika me një zë që m'u duk si rrökullisje shkëmbinjsh.

— Do tē ta laj, Zaim aga.

— Po borxhi lahet në kohë.

— Kamber Hakimi s'më ka caktuar kohë.

Dhe aty ndodhi ajo që s'e prisja.

Kamber Hakimi m'u turr me tē bërtitura e me tē shara.

Unë s'po kuptoja ç'po ndodhë.

Ngaqë e humba fare prej atij sulmi tē papritur, as fjalët s'po i dëgjoja dot, po grushtin e Kamberit,

që tundej si kopan përpara hundës sime, e shikoja mirë.

Ngrita kokën.

Sytë i ishin bërë si prush i kuq.

«Të jetë Kamberi ky?!» — pyeta veten.

Po, ai ishte, Kamberi. Unë po e shikoja vetë. As s'ë, e as veshët s'më gënjenin. Aty qëndronte. Një çap para meje. Po të zgjatja duart, mund të kapja edhe fytin e tij. Po të bëja një hap përpara, edhe mund ta shkelja, po unë isha mpirë. As duart e as këmbët s'më urdhëroheshin më. Bile edhe frymë me vështirësi merrja.

— Mjaft më bërtite ti! — i thashë, po ai u egër-sua edhe më tepër.

Sa vazhdoi kjo ulëritje unë s'e marr dot me mend; po di të them që ai pushoi vetëm atëherë, kur nga gryka e tij s'dilte më zë, po hungrimë.

— Mua s'më duhet në ke apo nuk ke — ndërrhyri me njerën vetull përpjetë Zaim aga Çika. Mua përsëri m'u duk se nga gryka e tij po rrrokulliseshin shkëmbinjtë. — Atë që të dhashë, duhet të ma kthesh menjëherë. Po s'ma dhe ti, do të ta marr unë...

Edhe vitin tjetër lava vetëm kamatat dhe taksat.

Plaqte e fshatit iu lütën Zaim aga Çikës që të më linte edhe një vit kohë.

Ai s'ua prishi, po u vuri edhe kusht. Po të mos e laja tërë borxhin vitin tjetër, do të më hidhte në gjyq; ndërsa unë isha i bindur se as vitin tjetër s'ia laja dot.

Mësues Qaniu më ndihmonte me sa mundte.

Bashkë punonim në ngastër, bashkë mblidhnim mare për të zjerë raki, bashkë nxirrnim shqopë për qymyr, bashkë e digjnim qymyrin e bashkë ua çonim

*tregëtarëve, kur vinin matanë lumi t pér të grumbulluar qymyr e raki.*

*Mësuesi dhe mushka m'u bënë si vëllezër...*

*Nusja mbante shtëpinë dhe djalin e, kur e donte puna, punonte me ne edhe në arë, edhe në gropën e qymyrit.*

*Po një herë më ndaluan të nxirrja shqopë, se pyllin e kishte bërë të vetin Zaim aga Çika e pyllit s'i afroheshe dot, se roja s'ta përtonte as plumbin.*

*Në pranverë mësues Qaniu shkoi në Vlorë e s'u kthye më.*

*— E gjeti atë që kërkonte! — u tha Kamber Hakimi fshatarëve.*

*...Kurse unë prapë vetëm kamatat dhe taksat lava.*

*Gjyqin ma bënë në nënprefekture.*

*Në gjyq kishte ardhur edhe vetë Zaim aga Çika.*

*Foli gjyqtari, foli Zaim aga Çika, foli dhe Kamber Hakimi.*

*Doja të thosha edhe unë të miat, po s'më lanë.*

*Në gjyq humba edhe magastrën, edhe triuallin, edhe përdhesen.*

*Për shpenzimet e gjyqit lashë, rehem dhitë me një muaj afat.*

*Në krye të muajit mbeta edhe pa dhitë.*

*...Pastaj më erdhën xhandarët dhe...*

*Në dhomën e burrave ra një qetësi e thellë.*

*Sezaiu mbushi çibukun, vuri mbi të një thëngjill të ndezur nga të mangallit dhe e ndollti me gjithë mushkëri tymin e hidhur.*

Nga dhoma tjetër vinte rënëkimi i drobitur i Merushes.

Sezaiu e dëgjoi e uli kokën.

— Jua prisha qetësinë — tha, ashtu siç rrinte, me kokën ulur — po unë vetëm sa pér të kaluar një natë... Në Vlorë erdhë me shpresë të mësues Qani Beshirit. E kërkova sa m'u këputën këmbët, po s'e gjeta gjékundi.

Hysua pshëretiti thellë.

Rexhua e Lamçja kthyen kokat nga ai,

— Mos e kërko më Qani Beshirin! — Tha Hysua. — Me ne nuk do ta kalosh keq. Mbësë do të të gjejmë punë. Do të punosh e s'do t'i bëhesh barrë asnjë njeriu.

— Si të mos e kërkoj më Qani Beshirin?

— Se nuk do ta gjesh dot...

— Pse?! — dhe mendja i vajti tek ai mësuesi që, pasi «kishte shkelur kallot e babait të të gjithëve», e kishin futur në spitalin e të çmendurve.

— Se s'është më.

— Si s'është më?!

— E kanë burgosur.

— Si the, more?

— Po, po. Ka dy muaj që e arrestuan. E dënuan me dhjetë vjet punë, të detyruar. Tani çau prugë në Skrapar.

— Jo, more!

— Unë e kisha shok. Ai s'ishte nga Vlora. Këtu kishte një dhomë me qera.

— Eee- eh, dynja! — u pikëllua Sezaiu. — Po pse xhanëm, Pse?

Hysua po shikonte me vërejtje.

Të dy mbetën një kohë të gjatë duke parë një-ri-tjetrin në sy.

«Pse» - ja shpërtente me një feksje të lagësht nga sytë e Sezaiut. Në skajet e lëshuara të buzëve të tij Hysua pikasi një dridhje të lehtë. Ngriti sytë më lart. Edhe mollëzat dridheshin, edhe shtegu i ballit dridhej, edhe flokët dridheshin. Gjithshka dridhej pas asaj zbehjes që kishte pushtuar fytyrën e Sezaiut, kurse Hysos iu kujtua ai fshatari që s'kishte me se të paguante taksën te shtylla pranë dyqanit të xhokaxhiut. Po ajo zbehje. Po ajo dridhje. Dhe mbi zbehjen e dridhjeve varej «pse»-ja e pikëlluar.

«Sa kohë duhet përi ta fshirë këtë lloj «pse»-je nga kokat e njerëzve mendoi Hysua — kohë dhe punë! Ata duhet të mësohen të heqin dorë nga pse-ja e përgjumur. Jeta e tyre ka nevojë përi «pse» të tjera. Jó përi «pse»-të që të zbehin, po përi «pse»-të, që të ndezin gjakun.»

Rexhua e prishi i pari qetësinë.

Pas tij foli edhe Lamçë Hyseni.

Ata e panë të udhës ta ngatërronin bisedën. Në fillim sikur u kënaqën me aftësinë e tyre, po më pas, pa e kuptuar as edhe ata vetë, fjala shkau në rrëkenë e mëparshme.

— Tregonte Rexhua e dëgjonin të tjerët.

Tregonte Lamçja e dëgjonin të tjerët.

Biseda e tyre shkau në çdo skaj e në çdo plagë qyteti.

Biseda e tyre shkau në çdo skaj e në çdo plagë fshati.

Në rrëfimet e tyre shkisrin orët e natës...

## XIV

### HYSUA.

Hysua vetém rrinte e dëgjonte.

Në fund edhe atij sikur iu zgjidh gjuha.

Në fillim sikur nuk para ia vunë veshin, po më pas në dhomën përdhese dëgjohej vetém zëri i tij.

Lamçja e shikonte me një pamje të habitur atë djalosh nëntëmbëdhjetëvjeçar. Dëgjonte e nga ato që dëgjonte i ldukej sikur në zemrën dhe në mendjen e atij djaloshi i shiin struktur tërëjeta dhe vuajtja e një populli.

Zëri burrëror, i shtruar e i kujdeshshëm i Hysos i dukej i ngröttë, i bëdashur, i safërt, që i zgjonte kujtime të së kaluarës.

Rexho Nallbania iu kishte mbërthyer sytë të birit e në shpirt kienohej që kishte një djale që e njihte aq mirë jetën e popullit të varfër. Ai nuk e kishte dëgjuar ndonjëherë të birin, të fliste ashtu e aq gjatë. Në të vërtetë ai e mbante mend mirë se sa kurresttar kishte qenë Hysua në yogëli, atëhere, kur Rexhua i tregonte për luftën me Italinë e për Selamin, për revolucionin, për Avniun, për Halimin.

Mbante mend sa shumë e mërziste ai me ato «pse»-të e tij të pambaruara. Po edhe më pas, kur Hysua mësonte në Tregëtarë, i kujtohej si e trazonte me ato «pse»-të e vështira e me ato tregimet e zgjuara për ndodhi të ndryshme. Më të freskët kishte atë që ngjau para tre vjetësh, kur Hysua goditi me çantë kokës mësuesin e italishtes se ai ia kishte bërë veshët bigë, kur ia kishte grisur një libër italisht fashist hundës. Mbante mend mirë se si nguli këmbë Hysua për të mos shkelur më në atë shkollë, ku shumë nga mësuesit betoheshin për Italinë... Po që të arrinte Hysua e të futej kaq thellë, këtë nuk e kishte shkuar kurrë në mendje. Kur e pa me sa vëmendje po e dëgjonin Lamçja e Sezaiu, iu bë zemra mal nga gëzimi e, pa e kuptuar edhe vetë se si, përdroddhi nja dy herë verigat e mustaqeve.

Sezaiu duke dëgjuar kthënte herë pas here kokën nga Rexhua e Lamçja e i mbushej mëndja që Hysua po fliste për gjëra shumë të rëndësishme, se edhe ata dy të tjerët po e dëgjonin me shumë kujdes.

Kur fliste Hysua, atij i kujtohej Thomai e, kur kujtonte ato që i kishte thënë Thomai, i bëhej se Hysua kishte qenë ai që e kishte mësuar Thomanë të fliste me ato fjalë.

— ...Në përgjithësi kjo është gjendja. — tha Hysua e për herë të parë gjatë tërë fjalës së tij pshërëtit thellë, kurse ata të tre ngritën kokat e drëjtuan sytë nga ai, sikur, duke e parë, do të kuptionin më mirë ato që prisin të dëgjonin.

Po pasoja e kësaj gjendje ka rënduar në kurriz të popullit. Mbreti i madh e mbretërit e vegjël, ata të drithit, të vajit, të kripës, të leshit, të pyjeve, tokave, bagëtive e të tregëtisë, po përpiken të varfërojnë popullin punëtor e zanatçitë, me qëllim që

ata tē katandisen nē një kope sklevërish, tē paaftë pér t'i kundërshtuar shtypjes së tyre. Po, që tē arrish deri këtu, nuk mund tē shkelësh mbi popull pa ngjallur urrejtje, zemërim, revoltë. Një popull i tërë nuk mund tē heshtë. Kjo gjendje do ta ngrejë atë më këmbë. Më këmbë, pér jetë a vdekje.

— Dale pak ti, Hyso, se unë tē dëgjova me kujdes — tha Sezaiu — po nuk tē kuptova mirë.

— Muhabet i ngatërruar ky — tha Rexhua.

— Edhe unë u trullosa.

— E ka mirë djali. Këta qenër i paskan matur mirë hapat e tyre.

Lamçja fliste dhe fërkonte fytyrën me shuplakën e rreshkur tē dorës tërë nervozizëm.

— Mirë, minë — tha Sezaiu — po më shtruar, se unë dua ta kuptoj mirë këtë.

— U pa kjo punë — tha Lamcja — do rrëmbyer prapë dyfeku.

— Të lumtë, xha Lamçe! — u gjëzua Hysua.

— Aty ka ardhur puna.

— Dale more, se më hutuat fare! — kurse Hysua ia mbértheu sytë një copë herë edhe si pér tē kuptuar ç'nuk kishte marrë vesh Sezaiu, edhe si pér tē mbledhur prapë fuqitë.

Në dhomë qetësia ishte tendosur nē tē katër këndet.

— Nuk më thua — ia nisi Hysua — përsë ike nga fshati ti?

— Më ndoqën. M'i morën tē gjitha. Ai qeni, Zaim aga Çika, më ropi e më ndoqi! Jua thashë tē gjitha pak më parë.

— Çfarë dëmi do tē kishte Zaim agai, po tē tē mbante ty nē fshat?

— Çfarë dëmi? ku ta di unë!

— E ke dëgjuar atë që bënë para ca vjetësh bujqërit e Përtejës?

— Jo.

— Atje s'pati një si ti. Si ti qenë katandisur të gjithë. Si ti e shumë të tjerë. Në fillim kujtonin se shkaktar për gjendjen e tyre të rëndë ishte fati, prandaj edhe e mbanin kokën ulur! Vuajtjes dhe dëshpërimit i kishin gjetur për balsam atë psherëtimë, që më tepër i zgahte se sa i qetësonte. Por, kur e kuptuan se s'qe fati por feudali që i rripte cikë e nga një çikë, u ngritën kundër tij. U ngritën e derdhën gjak për tokën. Ata nuk fituan, se kundër atij grapi të vogël fshatarësh të armatosur me gurë, drunj, e kosore u ngrit forca mbretërore, po ata u treguan tërë të tjerëve se, për të jetuar, duhet luftuar dhe se duhet luftuar kundër atyre që e shkaktojnë këtë gjendje.

Pa e kuptuar edhe vetë, Hysua kishte rrëzuar jorganin nga krahët dhe ishte ngritur në gjunjë.

— Sa si ti janë në fshatin tënd? — e pyeti ai Sezainë.

— Ka edhe të tjerë.

— Do të ketë edhe më pas.

— Mbase.

— Do të ketë pa tjetër, se ajo që mbetet nga ç'jep toka pasi rrëmbejnë mbreti, mullai e agai, s'mjafton për të jetuar.

— Ashtu éshtë.

— Ata do t'i zgjatin dorën agait.

— E.

— Ai do t'u japë.

— Do t'u japë.

— Ata s'do të kenë t'ia kthejnë.

— Doemos.

— Pra do tē shtohen.

— Do tē shtohen.

— Dhe do tē vijë një ditë që ta kuptojnë se shkaktar pér gjendjen e tyre janë agai dhe mbreti, që ua rrëmbejnë pjesën më të madhe të djersës së tyre që në lëmë.

— Shiko, shiko!

— Do tē vijë?

— Do tē vijë.

— 'Atëhere ata do tē ngrihen kundër tij?

Sezaiu shikonte i çuditur.

Rexhua ktheu kokën nga Lamçja.

Lamçja buzëqeshte nën verigat thinjoshe tē mustaqeve.

— Këtë nuk do ai — tha Hysua pasi i hetoi së pari tē tre me një vështrim pyetës. — Pikërisht këtë. Prandaj tē ndoqi ty. Prandaj do tē ndjekë edhe tē tjerë.

— Të lumtë, more bir — thirri Lamçja — se i ke rënë pikës!

— E mora vesh — tha Sezaiu.

— Çfarë more vesh? — e pyeti me një ton nxitës Hysua.

— Që ai qen duhej vrarë. Këtë ia thosha vetes téri rrugës, këtë i thosha edhe gruas, po as unë s'e besoja as gruaja s'ma pranonte.

— Kaq nuk mjafton.

— Siiii?! — u cudit Sezaiu.

— Në vend tē tij do tē vinte një tjetër, ndoshëta më i keq se ai, që do tē tē ripte edhe ty, do tē ripte edhe tē tjerët më keq se ai. Edhe ai duhej vrarë, apo jo?

— Edhe ai.

— E prapë në vend tē tij do tē vinte një tjetër.

- Edhe atë do ta vrisnin  
— Pra duhen vrarë të gjithë?  
— Të gjithë.  
— Vetëm ata të fshatit tënd, apo kudo që të  
jenë?  
— Kudo që të janë, se të gjithë njësoj janë.  
— Unë me të tjerët.  
— Me të cilët të tjerë?  
— Me ata që robtohen e vuajnë si unë.  
— Si vuan ti, vuan i gjithë populli.  
— Të ngrihet i gjithë populli!  
— Ti deri tani ishe në gjumë. Si ti flenë edhe  
shumica.  
— T'i zgjojmë nga gjumi.  
— Kush t'i zgjojë?  
— Ti, unë dhe ata të tjerët që janë zgjuar.  
— Po ata i mbron ligji?!  
— Ta prishim ligjin.  
— Ligjin e mbron mbretëria menarmë.  
— Ma prishe mendjen. Më trullose.  
— U trembe?  
— Unë s'kam frikë nga armët, po nga mbretë-  
ria...  
— Aty qëndro! — e ndërpreu Hysua. — Fjala  
mbretëri, që ngjall aq tmerr te populli, rron ende  
sepse, ata që e gjetën këtë fjalë, e veshën atë me  
një mur bajonetash e ato bajoneta i lyen me gjakun  
e popullit që kishin nën vete së, pa popull të shtypur,  
s'ka mbretëri. Është kjo arësyje që mbretëria  
në sytë dhe në mendjen tonë ka marrë trajtën e  
një bishe të tmerrshme e të paprekshme. Po mbretë-  
rinë e përbëjnë njerëzit. Dy palë njerëz. Njerëzit  
që shtypen dhe njerëzit që shtypin. Të dyja palët  
armike me njëra-tjetrën. E para përbën shumicën

e popullsisé. E dyta mban nén thundér tē parën. E pérçan, e copëton nē grupe, fut hasmériné e sherrin midis tyre, qëbata tē merren me njéri-tjetrin e tē mes kenë kohë tē merrén me mbretériné. Kjo éshëtë mbretëria. Po tani ajo ka filluar tē kalbet nga brenda. Léshimet që po i bën Italisë fashiste janë një zgjatje dore pér tē shtuar frymëmarrjende atij që po jep shpirt. Paria e vendit e di mirë se kjo dorëzgjatje dhetërë ato lëshime që i janë bërën Italisë fashiste do tē çojnë një ditë nē skllavërimin e vendit, po ajo e pranon me kënaqësi këtë, se, një ditë, pikërisht ndihmén e bajonetave italiane do tē kërkøjë ajo pér tē rrëzuar mbretina dhe pér tē nënshtruar vendin. Pikërisht në këtë gjendje duhet vetëm një tufan, një goditje e fuqishme dhe mbretëria do tē shembet. Këtë goditje do ta japë populli, tufani që mbretëria rriti vetë, pa ditur se një ditë ky tufan do tē shpërthejë kundër saj.

— Ti flet me ca fjalë që unë nuk po i kuptoj mirë — tha Sezaiu dhe mendja i vajti tek ai djaloshi me kominoshet e arnuara nē bërryla e nē gjunjë, që një ditë më parë ishte zënë me xhandarët te sheshi i xhamisë Tabakhanë pér atë fshatarin që nuk kishte me se tē paguante taksën. «Ky duhet tē jetë, thosh me vete. — S'më gënjeu syri mua, po pse s'po marr vesh mirë çfarë thotë?» — dhe fërkoi ballin me dorën e majtë.

— E di ç'ke ti? Atë tufanin s'para e kuptova mirë unë. Ma thuaj pak më shkoqur se, me sa marr vesh unë, ai duhet tē jetë çështja kryesore në këtë mes, kurse unë duhet ta kuptoj pa tjetër. Dje te sheshi i xhamisë ti fole më shkoqur dhe unë, që tē dëgjova që prapa krahëve tē tē tjerëve, i kuptova tē gjitha.

— Ku the, more?! — pyeti i habitur Rexho Nallbani.

— Atje ku e desh puna — ndërhyri Lamçe Hyseni, që e kuptoi nga zëri i Rexhos se atij nuk i pëlqeu kjo punë. — E harrove veten në njëzetën? E harrove në kohën e revolucionit? ... Bashkë kemi qenë. e, kur të thosha unë ta merrje më shtruar, ti më goditje me noçkën e dorës në tëmtha e më thoshe: «Po e morëm shtruar-shtruar si breshka, e humbëm davanë...»

Pastaj iu kthye Hysos:

— Dëgjo, more djali i xhaxhait! Ti je djalë me shkollë e nuk e ke të vështirë t'i thuash ato që ke në kokë, po më e mira është që, ato që thua, t'i kuptojnë të gjithë, edhe shkollari, edhe dhijari...

— Dëgjo, more djali i xhaxhait! Ti je djalë me shkollë e nuk e ke të vështirë t'i thuash ato që ke në kokë, po më e mira është që, ato që thua, t'i kuptojnë të gjithë, edhe shkollari, edhe dhijari...

## XV

### MULLIRI I VERO BEUT

— ... Sikur janë pak këta që kam! — u çudit e u zemërua në të njejtën kohë Faslliu, kur i shpuri Sezaiu letrën që Hysua kishte marrë nga Nevzati, i biri i Vero Beut. — Këtu s'ke nga të vish vërdallë! Këtej koshat, andej cipurrat, këta lugjetër po mizë lisi. Na edhe ti tani! Sikur s'e di Nevzati këtë.

Po Sezaiui priti në heshtje këto fjalë, se druhej mos prishte punë.

— Nga je ti? — e pyeti papritur Faslliu.

— Fshatar — ia preu shkurt Sezaiu.

— Nga ç'fshat?

— Tutje!

— Si tutje?! S'paska emër fshati yt?

— Unë tani s'jamumë nga asnjë fshat. Jam nga Vlora.

— Mirë, mirë, po nga ç'fshat ke ardhur?

— Nga Çika.

— Nga Çika?! Shiko, shiko! — dhe vuri buzën në gaz e u gjallërua Faslliu. — Po ti qenke nga alamet fshati, more tutkun! Shiko, shiko!

Po Sezaiu nuk po e dëgjonte. Me dy vetullat tok ai kishte ulur kokën dhe po trazonte me majën e opingës nja dy kokrra ulliri që kishin mbetur aty në shesh.

— Jo, t'u thaftë këmba! — i klithi Fasliu.  
— Mos i shty ullinjtë me këmbë! — dhe e pa një copë herë me sy të çakarritur. — Kështu jeni ju fshatarët. S'ia dini kimetin rrëskut të perëndisë!

— Ia dimë, se tërë jetën me punë jemi marrë.

— Marshallah! E me tërë ato shpatulla që më ke, më ke lënë fshatin e më je varur në qytet! Do të jesh ndonjë birko dembeli ti, që s'do ta kesh shokun! — këtu Sezaiu, i fyter në sedër, fërkoi kallot e shuplakave të duarve dhe nuk duroi pa i thënë:

— Puna na ka bërë kaq.

— Po ç'pate pastaj që më le fshatin e zure qytetin?

— Se s'më vajti mbarë.

— Jo, more?! Edhe të vete mendja se do të të vejë mirë në qytet, ë?! Hic mos e shko këtë në mendje, dëgjomë mua ti! Se sa si ti janë varur në qytet e s'kanë ngrënë as pesë vakte bukë, aq të mira qofshin!

— Ku do të punoj unë? — e pyeti Sezaiu si përt'i thënë që s'ia kishte qejfi ta zgjaste këtë lloj bisede.

— Ou! — u çudit Fasliu — edhe evgjit, edhe qibar! Po javash një herë ti! Po të jesh kështu si m'u duke bë tani, ia more të keqen punës! Këtu ka vetëm dy fjalë: «Lepe-peqe». Do bërë hyzmeti punës. Vetëm një duhet i mendjes këtu, të tjerët duhen të krahun. Kush e vret mendjen përtë dyja, ma merr të keqen shpejt. E shikon këtë derë ti?..

Ashtu, të lumtë! Për të hyrë bëhet vrimë kjo, pa për të dalë bëhet grykë shpelle. E more vesh, apo jo?

— Ehë — Sezaiu mbushi çibukun.

— Ashtu, më të lumtë! Këtij i thonë sakllëm pazar! Dëgjo më tej tan! Po erdhe në punë pa ardhur shokët, je punëtor i mirë. Po punove kokulur, je punëtor i mirë. Po e le punën pasi të kesh punuar aq, sa të të urdhërojnë, je punëtor i mirë. Këtu buka hahet më orar dhe në sy të të gjithëve. Hëngre mienjanë, s'do shumë tru kjo punë, çoc luan në këtë mes; e hëngre, kur i thonë fjalës! U lye gishti me vaj, e hëngre! Tu gjet një kokërr ulliri në xhep, e hëngre! E kupton ti ç'do të thotë «e hëngre?»

— E kuptoju përgjegj! Sezaiu me mendjen top se kishte të bënte me një njeri që ta merrte shpirtin për punë e përrugulla. — E fundit, po që duhet tarimbash mend mirë: Këtu, me mua, mos shiko për qifkulla dhe fale duhanin, se është e ndaluar këtu, kavend kastile për duhan këtu. Kjo hundë dhe goditi feçkën e hundës me mollëzënë gishtit tregues — ka nuhatje qehi, kur i thonë fjalës. Një brë larg të mbajë erë, fërriria bën kjo e shkretë. E kam fjalën për atë illoj bajge që po molëpsat e nga ca nga të rinjtë e sotëm!... bollshëvistë komunist!... mbase ta ka zënë veshi? — dherë vëréjt me sy të picerruar.

— Në qofsh njeri më tru larg tyre, sa më larg tyre se poh plekse mëta të mori perröpia, kur i thonë fjalës. Po t'i duash të mirën vëtes dhe familjes tënde... ke familje, apo jo?

— Kam — u përgjegj prerë dhe rreptë Sezaiu.  
— Mos bërtit, ti! — klithi Fasliu.

— I mora vesh ato që më the!

— Kam të tjera ende. Sezai psherëtiti thellë dhe uli kokën.

— Ashtu dé! Po t'ü duash të mirën vetes dhe familjes tënde, duhet të kesh shokë vetëm. krahët dhe koshin. S'kam ç'të të them tjetër. Për sot je vonë. Nuk do të punosh.

— Po unë erdha në kohë! Ti më mbajte me llafe!

— Jo ti, po zotrote! Jo llafe, po urdhëra! — thirri Fasliu. — Nesër duhet të jesh këtu që në orën pesë allafranga. Tani, po deshe, hidhi një sy punës! — dhe ktheu krahët. — Aha! — tha dhe u kthyesh sikur u kujtua përdicka. — Nëma ta dredh një herë! E ndjeva nga era që ke duhan të mirë — mori shubekun që i zgjati. Sezai dhe duke dredhur cigaret, vazhdoi: — More, s'e s'të pyeta fare, ke a s'ke emër ti, kur i thonë fjalës?

— Sezai, më thonë.

— Vetëm Sezai?

— Sezai Abaz Hajrullau.

— Ashtu de, kë lezet kështu! — dhe palosi letren në kokën e cigares. — Dëgjo këtu ti, Sezai Abas Hajrullau! — nxori shkrepshen, shqepi një fije dhe e ndezi. — Qëkur është ngritur mulliri e deri më sot, ka mbetur një adet këtu. Ka që kurë, s'mbahet mend kjo punë. E një adet që, s'dihet që kur ka nisur, bëhet ligj pastaj. Ptfu, lanet! — thirri duke u rrrotulluar nga dy herë rrith vetes e duke shkundur gishtin, që ia përcëlloi flaka e shkrepshes nëpër qillotat e shajaktë. — Më dogji e flamosura.

Sezai vuri buzën në gaž.

— Mos m'u zgërdhi ti aty!

— Lyeje me qurre, se s'të përcëllon më!

— E di vetë unë atë punë! S'mbeta të më mësosh ti! — dhe futi gishtin e përcëlluar nga flaka e fijes së shkrepse në feçkën e hundës e ashtu gishtin në feçkë vazhdoi: — Këtu paguhet tre lekë dita. Në pesëmbëdhjetë ditë bëjnë dyzet lekë.

— Sikur bëjnë dyzet e pesë, apo jo? — e pyeti Sezai, duke kujtuar se Faslli u kishte lajthitur pa dashje.

— Dyzet e pesë bëjnë, po ai adeti i vjetër është bërë ligj tanë.

— More, po unë ato të shkreta, i nxjerr me djersë?!

— Dale, se s'i ke nxjerrë ende.

— Kur t'i nxjerr.

— Me djersë i nxjerrin të gjithë.

— Unë them për veten time.

— S'e prishim ligjin për ty ne! — dhe ktheu krahët e iku.

#### IVX

## XVI

### AJO ÇELI SYTË

Rexho Nallbani e kishte bërë zakon ta priste Sezainë në han, derisa ai të linte punën në mullirin e Vëro Bëut e që nga hani të ktheheshin së bashku në shtëpi. Edhe vetë Sezaiu e kishte më të lehtë, kur kthehej në shtëpi i shoqëruar. Në këtë mënyrë ai nuk e ndjente edhe aq ngushtë veten kur hapte portën, kur kanata e hapur godiste në zilen e bronx-të të varur me një tel alumini në traversën e pullazit të portës e zilja tringëllinte si kambanë alarmi. Ai e dinte se, kur tringëllinte zilja, në derë do të dilte një nga ata të shtëpisë për të parë se kush kishte ardhur. Dhe atij nuk i vinte mirë që të shihnin atë duke hyrë atë, një njeri krejt të huaj për njerëzit e asaj shtëpie. Ai e kuptonte fare mirë se, po të mos kishin qenë ata njerëz kaq bujarë e mikpritës dhe e keqja që e zvarriti nga fshati rrëzë Çikës deri në rrugët e Vlorës, ndofta as që do të ishin njojur fare, ndofta do të jetonin secili për jetën e tij, secili në prakun e tij e ndofta nuk do të kishin dëgjuar fare për njëri-tjetrin.

Po tanimëjeta e Sezaiut ishte gjërshtuar plotësisht me jetën e këtyre njerëzve e ai vinte re se ata mundoheshin ta trajtonin tamam si një pjesëtar të përhershëm të familjes së tyre.

Ata po kujdeseshin me të gjitha mundësitë jo vetëm për vogëlushin e tij por edhe për Merushen e sëmurë e cila, me gjendjen e saj shëndetësore, ishte sipas Sezaiut, një barrë e rëndë, e tepërt për ta. Ata njerëz të mirë nuk kishin treguar asnje shenje pakë-naqësie ose bezdie, po megjithatë ai mundohej që me punën e tij, me qëndrimin e tij të mos krijonte asnje përshtypje të keqe.

Rexho Nallbani këshillohej me Sezainë për çdo gjë e ai, megjithëse e kuptonte mirë se këtë ia bënin që ta ndjente veten si njeri i brendshëm i shtëpisë, si njeri i barabartë me të gjithë të tjerët, në brendësi provonte një lloj ndjenje që ia trazonte tërë qenien dhe e bënte të ngrihej përpjetë kurmit një valë afshi e ngrohtë.

Pasi kishte shitur i sharkun, ai i kishte bërë bashkë paratë me ato të mushkës dhe ia kishte vënë përpara Rexho Nallbanit. Rexhua ishte zemëruar shumë për shitjen e sharkut dhe, pasi ia kishte futur prapë paratë në xhep Sezaiut, i kishte thënë: «Të pranuam në shtëpi si djalë e jo si qeraxhi. Ti do të jetosh me ne derisa të vijë koha që të keshtipinë e punën tënde.

Edhe Hysua ndoqi rrugën e të atit por, meqë puna që bënte në oficinën e zotit Seribeli i linte pak kohë të lirë, më rrallë takonte të ulej shtruar me Sezainë. Megjithatë, kur e binte hera e bëheshin bashkë, ai sillej me të si me një vëlla të tijin, si me një vëlla që kishte bërë e bënte një jetë të vështirë.

Edhe Sezaiut i pëlqente shumë afrimi me Hyson. Ai ndjente pér tē, që nga ajo nata e parë e takimit tē tyre, një admirim e një respekt tē vëçantë. Edhe kur vonohej Hysua, Sezaiu rrinte ashtu i shtrirë në stroma dhe e priste. Ndonjë natë e sillte puna ta priste shumë. Ashtu, duke pritur, atë e kapiste gjumi me kokën tē mbështetur mbi krahun e shtruar në jasték. Përmendej nga gjumi se i mpihej krahu, kujtohej pér Hyson, shikonte në stromat e atij e, si s'ë shihte, rrinte e vriste mendjen pér tē gjetur shkakun e mungesës së tij. Në këto çaste, nga dhoma tjetër, duke u rënduar edhe më tepér nga qetësia dhe errësira e natës, vinte rënkim i plot dhembje i Merushes. Atëherë e kapte një trishtim therës, që ia prishte gjumin dhe e mbërthente me një ngërç mbytës në fyt. Vetëm se ai mundohej ta mposhtte ngashërimin. Mbulonte kokën me jorgan, shtrëngonte sytë fort, fërkonte me pulqerët e djersit, shtegun e ballit dhe psherëtintë thëllë. Nëpër pafundësinë e zezë që shtjellohej tej vështrimit tē tij, dalëngadalë e detaj më detaj, si duke dalë nga thellësitë e një mjegullnaje tē pafundi vinte e materializohej një fytyrë si e ngjer me gëlgere tē bardhë. Në bardhësinë e saj spikatnin gropëzat mavi të syve, bebëzat e zmádhura; balli i rrudhur, i mbuluar me bulëza tē kristalta djerse, hunda e holluar deri në transparencë, mollëzat si kokalla dhe buzët e plasaritura nga zjarri i etheve. Ai e ndjente atë përfytyrim i deri në dhembje, veg mundohej ta qetësonte veten me shpresëri se do tē kalonin ditët, e keqja do tē largohej e ajo bardhësi e plagosur do tē merrte përsëri tiparet, e dikurshme tē fytyrës së Merushes. Do tē kthehej përsëri ajo hijeshia, dhe freskia e dikurshme; ajo do tē gjallërohej, do tē

urdhéronte këmbën, dorën e çdo muskul e përséri do të përpinqeshin t'i bënин ballë së bashku jetës... Po mjeku?! Ai nuk buzëqeshte më si ato ditët e para, nuk ia rrithë më krahët me ato shuplakat e tij të pastra e të buta». Këtu ai ngekte. Mendimi i tij nuk çante dot më tej. Përfytyrimi me atë bardhë-sirën e plagosur venitej e humbiste, përséri ndjente atë dhembjen që i mblidhej si lëmsh mbytës në fyt. «E kam keq Merushen!» — thoshte me vete dhe shtrëngontenofullat, kur e ndjente se s'mund të bënte dot asgjë për ta ndërruar gjendjen e saj. ... Si priti edhe ca, Rexho Nallbani flaku cigaren, siguroi nga brenda dritaren, mbylli derën e hanit dhe doli në rrugë.

Mbrëmja po derdhej mbi qytetin bregdetar me ca përflakje të bronxta të horizontit në perëndim, kurse nga lindja po ngrihej drejt kupës së qiellit një velë gjigante violetë.

Si çdo prak tjetër mbrëmjeje, edhe kësaj nate rruga gumëzhinte. Fëmijët luanin lodrat e fundit të ditës, lodrat e lodhura, lodrat e drobitura, lodrat e gajasura, të kërrusura, si shpatullat e burrave që mbartnin mbi vete lodhjen, drobitjen, gajasjen, kërrusjen e një dite të gjatë pune.

Rexhua doli në kryqëzim dhe u kthyte në rrugën e Çesmës së Mademeve.

Qëndroi dhe pa rrugën.

Që larg vinte jehona e mbytur e gjëmimit të motorit të mullirit të Vero beut.

«Punokan djemtë! — mendoi Rexhua. — U bë bishë ky mulli! Ua hëngri palcën djemve!» — dhe me këto mendime u ngjit më tej në të përpjetën e rrugës së Çesmës së Mademeve.

Te Çesma ndaloi.

Hoqi qylafin, uli kokën dhe piu ujë.

Uji ishte i ftohtë. Aq i ftohtë, sa i therën dhëmbët, po ai piu me etje, pastaj nxori shaminë dhe duke u kthyer nga e përpjeta e kalldrëmtë e rrugës fshiu buzët dhe mustaqet e lagura.

Nëpër kalldrëm po zbriste Faslliu.

E pa që larg Rexhon e, për të mos i folur, ktheu kokën mënjanë.

— More Faslli! — i foli Rexhua megjithëse e kuptoi që Faslliut s'ia kishte qejfi t'i fliste — lartështë Sezaiu?

— Kanë punë, Rexho. Lëre Sezainë të punojë!

— I këpüte djemtë, more Faslli!

— Kanë shpatulla ata; s'kanë qeder nga puna.

— Po shpatullat duan edhe të pushojnë!

— Le të pushojnë natën. Nata është ende e gjatë.

— Mirë e ke ti, po njeriu është prej mishi, s'është prej hekuri.

— Është ndezur ulliri, Rexho e, kur ndizet ulliri, firon vaji. Vero beu s'do të dijë për këto që thua ti.

— Pse nuk shtonni pumëtorët? 'Ashtu do të lodhen më pak.

— S'të kërkoi njeri mendje tv! Ti shiko sandragin e mos u ngatërrro me punët e të tjerëve! Le që kështu jeni të gjithë ju. Kur vijn puna për të tjerët, bari e bëni gurmazin. Kur është fjala për punën tuaj, e kullandrisni arixhiçë!

— Mua m'i thua këto fjalë ti?

— Jò unë, po puna jote. E kishe sakatuar kalin e Vero beut. Le që nallban je ti!

— Ka hak ai, se ia mbatha kalin për shtatë palë qejfe, dhe më pagoi një majë thoi!

— More, se mirë është të pyesë njeriu, po paska bërë dava të mëdhe e gjyq me Zaimin ai... — tha, por pastaj u pendua dhe e la fjalën përgjysmë.

— Si the? — e pyeti Rexhua, që s'e kuptoi ç'donte t'i thoshte Faslliu.

— Ikë, ikë tan! Lëre Sezainë të punojë sa ta ketë rrësk. Vetëm shkulja ca veshin, se shumë hesap kërkon për punën e për lekët. Të shikojë koshat ai. Të tjerat i di unë.

— Mirë e ke ti, more Faslli, po kanë edhe shtëpi njerëzit. Atij po i vdes e shoqja, kurse ti ma mban në pünë deri në mesnatë.

— Puna kjo është. Po të dojë të punojë, le të punojë si e do puna, ndryshë le të shkojë të përgjojë të shoqen. Dy kunguj s'mbahen në një sqetull — dhe zbriti nëpër të tatëpjetën e 'kalldrëmtë.

Rexhua e ndoqi me sy nga pas:

Pas pak yuri qylafin në kokë dhe mori rrugën e shtëpisë.

Hysua kishte lajmëruar se do të vonohej atë natë, kurse ai ndjeu përsëri atë shqetësim që e mundonte sa herë që dëgjonte se Hysua do të vonohej.

Këto kohët e fundit vonesat e Hysos ishin bërë më të shpeshta; po ai nuk e kishte lejuar asnjëherë veteq që ta qortonte të birin për këtë. E merrte me mend se me q'mund të merreshin djemtë, se edhe ai në të ritë e tij kështu ishte vonuar me shokë, herë në shtëpi të njërit, herë në shtëpi të tjetrit... prandaj edhe mundohej ta mbyste shqetësimin, duke i thënë vetes ndofta për të njëqindtën hérë se Hysua, si gjithë djemtë e tjerë, s'i përkiste më vetëm atij... «Vetëm u daltë mbarë», dhe pshërëtiu. Pshërëtinte me një «O-oh», të lodhur e të

dëshpëruar, lodhje të trashëguar nga lufta e përjetshme, dëshpërim të grumbulluar nga zhgënjam i plagëve, dhe i gjakut. «Vetëm mos e pësofshin si ne!»

— Si ka qenë Merushja sot? — e pyeti Havanë Rexhua.

— Lëre mos pyet! — u përgjegj Havaja. — Eshtë keq e shkreta! Tërë ditën e meku një kollë e ligë, që ia këputi shpirtin! S'është mirë ajo, jo! — në këtë kohë nga dhoma e zjarrit vazhdonte të vinte kolla e mbytur e Merushes. — Ja, dëgjoje! Kështu e ka ngarë tërë ditën. — Dhe u nis për në dhomë, po në mes të rrugës Havaja ndaloi e u kthye nga i shoqi: — More Rexho, i thashë edhe Hysos, po ku besojnë të rinjtë e sotëm. Pse s'more një hoxhë? S'i dihet. Të gjallë jemi e s'vemë re ku e hedhim këmbën. Po sikur... — po e preu fjalën, se Rexhua rrudhi buzët e tundi kokën si për të thënë:

«Hajde, budallaçkë, hajde!» — E-e, ashtu bën gjithnjë ti — vazhdoi përsëri ajo. — S'të pëlqen fjalë ime, po bëj këtë që të them unë e të shikosh pastaj.

— Rri, a lumëmadhe! Asaj s'po i bën dot gjë doktori, e ti thua të marr një hoxhë.

— Pse, more, një ma bëke doktorin me perëndinë ti?

Atë natë Sezaiu u kthye shumë vonë në shtëpi. Kollën e Merushes e ndjeu që te porta.

Pas tringëllimës së ziles në derë s'doli njeri, kurse në dhomën e burrave s'kishte llambë të ndezur.

Priti një çast në oborr, po edhe pas kësaj pritjeje

në derë prapë s'doli njeri. U mat të kthehej një herë e ta tundte përsëri zilen, po shpërthimi i ri i kollës së Merushes e bëri të kthente mendje. U nis me një hap të pavendosur për në dhomën e zjarrit.

Dera e dhomës së zjarrit u hap me rrëmbim.

Që andej doli Hysua me një peshqir në dorë.

Hapi kapakun e gjymit dhe lagu peshqirin.

— Hysa! — i thirri Sezaiu.

— Mirë që erdhe. Hajde shpejt! Merushja s'është mirë!

— Ç'pati??

— Hajde, hajde! — dhe hyri në dhomën e zjarrit. Pas tij hyri dhe Sezaiu.

Merushja dergjej e mekur mbi stromat e bardha.

— Merushe! — ai vetëm sa lëvizi buzët, kurse në tërë qenien e tij kjo fjalë kumboi si një klithnië.

Atij iu prenë gjunjët.

Havaja i mbloindi grykën Merushes me peshqirin e lagur në ujë të vakët.

— Shishe me ujë të ngrohtë te këmbët e te brinjët! Nxito! — i tha Sezaiut. — Unë ika për doktorin — dhe doli me nxitim.

Rexhua kishte mbushur oxhakun me bujashka ulliri e po i frynte zjarrit që të valonte sa më shpejt kusia me ujë.

Sezaiu i vajti pranë. Ajo dergjej në krahët e një agonie të plotë. Vetëm në qafën e holluar herë pas here rrihte një damar.

Zjarri u ndez dhe flakët iu mbështollën kusisë me ujë.

Rexhua e Sezaiu i vunë shishet me ujë të ngrohtë te këmbët dhe ijeve të saj.

Havaja me cepin e peshqirit lagte buzët e Me-

rushes e s'i largonte sytë nga damari që i ulej e ngrihet në qafë.

Mbi ballin e zbetë të Merushes dolën bulëzat e para të një djerse tërë avull...

Kur erdhë doktori, ajo i kishte hapur sytë.

“Doktor, m'kam qëndrueshëm

## XVII

### KU JANË PARATË E MIA

Vargu i mbartësve me koshat të ngarkuar në kurriz shkarkonte ullinj në vaskën e brumit. Ullinjtë derdheshin drejt e nën mokrat gjigante e ato të tria, duke u rrotulluar rëndë-rëndë nëpër vaskë, linin pas vetes brumë ulliri.

Mbartësit zbraznin koshat dhe ktheheshin në depo për t'i mbushur përsëri. Rruga e tyre i ngjante një rrotullimi të pafund, që kishte filluar që në orën pesë të mëngjezit. Fasliu nuk i kishte lejuar të pushonin as për të ngrënë mëngjezin.

Ata e kishin si rregull që pas prebatjes së brumit të parë të uleshin e të hanin mëngjezin, po kësaj dite, pas brumit, një pjesë e tyre u mörën me mbushjen e napave të presës, kurse pjesa tjetër, pa i hequr vegjat e meshinta të koshave nga supet, filluan rimbushjen e vaskës.

Motori i mullirit të Vero beut gjëmoi përsëri.

Mokrat e gurta të fashuara nëpër anët me tiranta metalike, u rrokullisën përsëri mbi pirgun e ullinjeve.

Midis gjëmimeve të motorit Sezaiu dëgjoi të thërrisin emrin e tij. Pa e ndalur hapin, ktheu kokën dhe përgjoi. Thirrja u përsërít edhe disa herë të tjera, kurse ai në ato thirrje dalloi zérin e Fasliut.

Shkoi te vaska, zbrazi koshin dhe u kthyte andej nga vinte zéri.

Fasliu hyri duke sharë e duke mallëkuar tërë zemërim.

— Ç'ke, more?! — nyeti Sezaiu, po në vend të përgjegjes mori një goditje me grusht. U pengua në pirgun e napave dhe u rrökullis matanë tyre.

Ngriti kokën.

Fasliu si bishë, rrinte mbi kokën e tij.

Një fjollë e hollë gjaku iu derdh nëpër biskun e mustaqeve e që andej sikur u piks aty nën skajin e buzëve.

Dang-dang gjëmonte motori i mullirit të Vero beut.

Gjëmonte më fort se herët e tjera.

Sezaiu u ngrit ballë për ballë Fasliut..

Motori i mullirit vazhdonte të gjëmonte.

— Ç'pate? — shqeu sytë nga habia Sezaiu.

— Hajdut! — thirri Fasliu.

— Hajdut!? — shqeu sytë nga habia Sezaiu.

— Hajdut! Hajdut! Hajdut!

— Unë hajdut?! — shqeu sytë nga habia Sezaiu.

— Ti, po kush, unë?! — shqeu sytë nga habia Sezaiu.

— Mos, more! Mos më njolloz, se s'e kam përsoj!

— Po këta? Çfarë janë këta? Ullinj? — dhe zgjati përvrat një grusht ullinj.

— Ullinj — pohoi Sezaiu.

— Ç'kërkojnë këta në trastën tënde?

— Ku the, more?!

- Në sytë që të të pëlcasin!  
 — Këtë nuk e kam bërë unë.  
 — Ti!  
 — Jo! — ia preu rreptë Sezaiu. — Unë nuk di të vjedh!  
 — Qërrahu që këtej dhe mos të ta shikoj më surratin!

Sezaiu shtangu në vend.

- Përjashta, të thashë!  
 Të tjerët ndërprenë punën. Ai hodhi sytë nga ata. Ata ulën kokët të pikëlluar.

'Ai e kuptoi së atytré u erdhi keq pér të, po nuk mori vesh se si i vajti mendja tek ai Saliu me ata argatët e tjerë aty nën hijen e tri selvive, te sheshi i xhamisë Tabakhanë.

Dang-dang, gjëmontë motori i mullirit të Vero beut.

- Bën mirë t'i kthesh prapa ato që më the!  
 — tha prerë Sezaiu.  
 — Dy punëtorët, që udhëhiqnin vargunte mbartësve, lëshuan koshat e ullinjeve në shesh.  
 — Vazhdoni punën ju! — u dëgjua i rreptë zëri i Faslliut.

Sezaiu u ngrit përballë Faslliut.

— Tërhiqe atë që më the dhe më jep dyzet e pesë lekët që më takojnë!

Faslliut rrahu çizmet me kamzhikun e meshintë.

— Tërhiqe atë që më the dhe më jep dyzet e pesë lekët që më takojnë! — tha pér herë të tretë Sezaiu, duke u afruar më oranë Faslliut.

Faslliut, që e ndjeu se nuk do të shkonte mbarë ky muhabet, u têrhoq një hap më pas dhe rrahu shuplakën e dorës së majtë me kamzhikun e meshintë.

— Lëshoni koshat! — thirri dikush prapa krahëve të tyre.

— Vazhdoni punën ju! — thirri Faslliu, po koshat me kohë ishin lëshuar dhe mbartësit qenë mbledhur të gjithë mu aty pas krahëve të Sezaiut.

— Lårgohuni nga rruga ju! — iu kërcënu Sezaiu të tjerëve dhe, pasi e mbështolli me krahun e djathtë njërin prej tyre, e shtyu prapa me tërë forcën. — Kam të tjera hesape me ju!

— Bën mirë të mos e zgjatësh këtë mesele, zotrote! — e ledhatoi Fasllinë një zë pak i ngjiru aty mbi kokën e tij.

Faslliu ngriti kokën. Tjetri kishte kryqëzuar duart në gjoks.

— Dëgjo këtu ti, bir bushtre! — i tha Sezaiu Faslliut dhe e mbërtheu fort për jake.

— Pëllëmbë si ajo, që më dhe ti, kam ngrënë edhe herë të tjera unë, po ajo jotja më rëndoi më shumë, se ishte për vjedhje. Pëllëmbëve të tjera do t'u vijë koha, po kjo jotja do larë që tam.

— I kapi kamzhikun, e flaku tutje çimentos, e mbërtheu nga jaka dhe, ndërsa Faslliu po mundohej t'u shpëtonte krahëve të tij, Sezaiu qëlloi aq fort me gjithë shpatulla, sikur t'i binte me sëpatë një trungu të ngjeshur lisi.

Ai u këput si presh e u përplas përdhe, po u ngrit përnjëherë, veç një goditje e dytë e përplasi përsëri mu aty në çimenton e mullirit, që nxinte nga zhumarja. U mundua të ngrihej prapë, po faqja e opingës, që iu ngjesh turinjve, ia preu vrullin. Mbi çimenton e nxirë nga zhumarja u zmadhua një njollë gjaku. Sezaiu e kapi nga flokët dhe ia ngriti kokën lart.

— Jam apo s'jam hajdut? — e pyeti. — Këta tē tjerët duhet tē dinë tē vërtetën.

— Unë nuk di gjë — tha me zë tē venitur Fasliu. — Ullinjtë atje i gjeta.

— Kush i vuri ullinjtë në trastën time?

— Nuk e di. Unë atje i gjeta.

— Kush tē tha se në trastën time kishte ullinj?

— Ptfu! — dhe ktheu kokën nga vendi ku pak më përpara kishte flakur kamzhikun. Sezaiu mori kamzhikun nga këmbët e mbartësve, i shqepi do-rezën dhe u mundua ta copëtonte. E tërroqi kamzhikun e meshintë fort në tē dyja anët, aq fort, sa i kërcyen damarët e fytyrës, po ai vetëm sa kërciti kërr-kërr e u tendos ca, se për t'u këputur nuk u këput. Si e pa që nuk ia arriti dot qëllimit, e mblo-dhi lëmsh në pëllëmbën e dorës tërë kallo dhe e flaku tutje, matanë pиргут me kosha.

— Tani më jep paratë që më takojnë! Çohu, çohu! Mjaft më nusërove! — dhe e ngriti më këmbë.

Fasliu rrufiti hundët, pështyu rremba gjaku dhe fshiu mustaqet në tē prapën e dorës.

— Ku janë paratë e mia?

Pasi fshiu tē prapën e gjakosur tē dorës në shajakun e pantallonave, Fasliu futi dorën në xhepin e brendshëm tē xhaketës, nxori prej andej një tok kartmonedhash dhe numroi dyzet e pesë lekë. Pa ngritur kokën ia zgjati Sezaiut.

Ai i mori paratë, i numroi, i futi në shubekun e duhanit dhe u kthye nga mbartësít:

— Ju falem nderit, vëllezër!

Dikush midis tyre i buzëqeshi e u nis i pari për te koshat e mbushur me ullinj që kishin mbetur aty

mbi çimenton e mullirit që nxinte nga zhumarja e zezë.

Sezaiu ktheu krahët dhe doli duke përplasur derën me vërtik.

Zhurmën e përplasjes e rrëmbeu dangdangu i motorit të mullirit të Vero beut, e mbështollë në gjirin e tij dhe e fluturoi lart në hapësirën e kaltër të qellit.

Nga mulliri i Vero beut Sezaiu shkoi drejt e në hanin e Rexho Nallbanit.

— S'të shikoj mirë! — i tha Rexhua i habitur.

— Ç'e ke atë gjak në buzë?!

— Donin të më bënин hajdut!

— Faslliu?

Sezaiu shtrëngoi tëmthat e tundi kokën në shenjë pohimi.

— Të rrahën?

— Nuk donte të më jepte paratë dhe më sikerisi nga puna. Po unë nuk ia përtova. Edhe paratë i mora, edhe këtë gjak e shpërbleva mirë.

— Jo, more?! Ke rrähur njeri?

— Fasllinë. U bë nuse pastaj.

— Ikë shpejt në shtëpi, dhe mos dil pa ardhur unë!

## XVIII

### ZOTI MUSTAFE

... Kur arriti Rexhua në shtëpi, Sezainë e kishin marre xhandarët.

Nëpër korridorin e errët, të ngushtë e pa dritare, që mbante erë myk, e futën në një dhomë të vogël.

Uji, që pikonte nga tavani, ta mbushtë mendjen se korridori i ngushtë dhe dhomëza e vogël, që mbante erë myk, ndodheshin nën dhe.

Ajri i ftohtë dhe i lagësht iu fut deri në palcë, kurse ai, pasi u lodh duke ecur nga njëra anë e dhomëzës në tjetrën, vajti e u mbështet të cepi i murit. Në fillim në shesh, pastaj, kur të ftohtët e cimentos së dyshemësë e bëri të teshintë, u ngrit në bisht e mbështollë gjunjët midis krahëve.

Donte të përfytyronte se çmund të ndodhë me të, po trurin ia kishte pushtuar një plogështi e çuditshme e ai jepte e merrte që të shpëtonte prej saj, por pa dobi.

«Le të bëjnë ç'të duan! — i tha së fundi vetes.  
— Unë e bëra timen», po aty i vajti mendja te

paratë. «Të paktën paratë i mora. Të marr ilaçet e Merushes, pa me mua ujë të zi le të nxjerrin», dhe mbështeti kokën te muri e mylli sytë...

... Zjarri ishte ngarkuar me bujashka ulliri.

Ata shikonin flakën të tretur në mendime.

Merushja dremiste mbi çarçafët e bardhë.

Sezaiu ngriti kokën e hodhi sytë nga Rexho Nallbani. Edhe Rexhua ashtu bëri.

Të dy burrat po shiheshin sy më sy.

— Xha Rexho, ke dëgjuar për Rusinë ti? — e pyeti fare papritur Sezaiu.

— Për Rusinë?... Posi, more! Kam dëgjuar nja dy herë djemtë. Mblidhen ndonjëherë këtu ata. Bëhen tre-katër shokë dhe bisedojnë shtruar.

— Po — aprovoi Sezaiu, po mendjen e kishte tek ato që po bluante në kokë. — Thomai më pat thënë se atje jetojnë e punojnë të gjithë njësoj.

— Ashtu kam dëgjuar edhe unë.

— Që s'ka shtypës e të shtypur, apo jo?

— Ehë! Ashtu është — pohoi Rexha.

— Po me paranë, si ta kenë bërë? Ta kenë hequr fare, apo ta kenë mbledhur dhe ta kenë ndarë barabar?

— Ku e di unë.

— As unë nuk e di.

— ...

— Po si dreqin e bënë ata? — pyeti Sezaiu, i nervozuar me paافتësinë e tij për të gjetur çelësin me të cilin do të hapte shtegun e mendimit të vërtetë e do të dilte në rrugën e asaj së vërtete që kërkonte. — Si e bënë? Nga e filluan?

Në dhomë ra heshtja. Një heshtje e turbullt, e çoroditür.

Një bujashkë ulliri e thekur mbi shpuzë mori

flakë. Flaka e saj u ngrit përpjetë oxhakut.  
Bujashka digjej në gjirin e flakës me ca kërcitje të shpeshta.

Të dy burrat ia ngulën sytë flakës, sikur aty, në gjirin e flakës do të gjenin përgjegjen pér pyetjet që i mundonin.

Flaka rritej e rritej duke përhapur nëpër dhomë një afsh të ngrohtë e një dritë të kuqërrremtë.

— S'po ia dal dot — tha Sezaiu dhe u ngrit, kurse Rexhua trazoi bujashkën e ndezur me mashë. Një tufë shkëndijash mörën përpjetë oxhakut.

Aty te musëndra, me shpatullat të mbështetura në kanatën e drunjtë dhe me duart të kryqëzuara në gjoks, Sezaiu dukej si një statujë e kuqërrremtë e përflakur.

— Tani ta kishim Hyson — tha ai.

— Do të vonohet sonte. Do të vonohet shumë, kështu më tha.

Në derë hyri Havaja me djalin e Sezaiut në krahë, të mbështjellë me një çarçaf të bardhë.

— Hapini vënd djalit, se mos më ftohet! — dhe e shtyu derën me këmbë.

— E lava? — pyeti Rexhua.

— E lava, e lava, po përpushe pak shpuzën! Ti, Sezai, merr një çikë aty në sepete peshlinë dhe pantallonat e lara! — dhe e uli djalin në shilte me kurriz nga zjarri. Vetë u ul në gjunjë para tij dhe nisi t'i fërkonte kokën me çarçafin e bardhë.

— Ke ftohtë, more?

— Jo, jo! Nuk kam ftohtë — u përgjegj vogëlushi.

— Bjere peshlinë! — dhe zgjati dorën nga Sezaiu. Koka e vogëlushit me flokët të përpushur doli nga çarçafi i bardhë. — Ngriji duart lart!

Ai u bind, kurse ajo filloi t'i fshinte sqetullat dhe brinjët.

— O-o-o-oho-ho-ho!

— Ç'ke, more? — e pyeti Havaja duke qeshur.

— Jo aty, jo aty! Më guxhulise! Oho-ho-ho!

— Hë, qerrata, mbaje veten, se je goxha burrë!

— Po mos më guxhulis prapë ti!

— Hajde, hajde! Lëri fjalët dhe fute dorën këtu!

Sezaiu qëndronte më këmbë prapa krahëve të Havasë dhe rrrotullonte pantallonat e të birit nëpër duar.

— Ulu, Sezai! — i tha Rexhua.

— Jo, jo! — e kundërshtoi Havaja. — Në se-pete, jo nga të bardhat, këtej nga ana tjetër ke trikonë. Ma jep pak, se s'e lë dot në të hollat.

— E qepë ti, nëno Havaja? — e pyeti vogëlushi.

— E qepa, të keqen nënoja, e qepa!

— Nuk e gris më unë.

— 'Ashtu, të keqen! Të bëhesh djalë i mirë! Baba Rexhua do të të dërgojë edhe në shkollë. Pa do të rritesh e do të mësosh edhe zanat, se s'të lë Hysua ty. Do të të bëjë mekanik si veten ai.

— Pse, babi, mekanik do të bëhem unë?

— Çfarë të dojë Hysua.

— Ku di unë të bëhem mekanik?

— Të mëson Hysua, të keqen nënoja!

— Eeeee!

— Të shikosh ti. Do të të mësojë apo jo??

— Jo, moj, jo! S'dua mekanik unë!

— Jo more??

— Unë dua të bëj shtëpi.

— Shtëpi??

— Ehë! — Murator, ë?

Merushja shikonte ed gëzuar.

— Ehë. Pse, nuk e bëra djë shtëpinë unë, po ma q prishi Murrua mënë zinxhir. Po edhe unë, amë, par bukë e lashë përkrekë.

— Mirë ia bëre qenit! — tha Rexho Nallbani duker munduar të përbante të qeshurit.

Merushja buzëqeshi.

Havaja i veshi trikon, kurse ai u shkreh në gaz nga gudulisjet.

— Qesh shtëpia kur qeshin fëmijët. — tha Rexhua duke kthyer kokën nga Sezaiu. — Vetëm të mës vuajë si po vuajmë ne!

— Nuk do të vuajë, jo! — tha me bindje Sezaiu. — Përderisa neve po na rëndon shumë e sotmja, do të bëjmë dika që statij t'i pëlqejë nesërmja.

Havaja trazoi prushin në vatër dhe flaka e purpurt përhapi një afsh të ngrohtë që depërtoi nëpër tërë atmosferën e dhomës.

Përplasja e këmbëve mbi kokën e tij e shkëputi Sezainë nga këto kujtime të embla.

Hapi sytë.

Errësira e lagështira ia ngjethën mishtë.

Ai u ngrit më këmbë dhe ferkoi shuplakat,

Lart, mbi kokën e tij, kishte lëvizje. Herë dëgjoheshin hapa në tavanin e dhomëzës ku e kishin futur, herë korridori sillte hungrima të mbytura fjalësh, që ai i dëgjonte vetëm si zëra. Futidorën në xhepin e pantallonave. Dora kapi shubekun e duhanit, ku Seza... kishte futur paratë.

«Hej, bela!» — tha i shqetësuar, kur mendoi se paratë mund t'ia merrnin. «Jo, ore, jo! U marrin

të keqen parave ata, se i kam fituar me djersë unë!»

Hoqi opingat, zhveshi çorapet dhe futi në to paratë, në dy pjesë! Një pjesë i futi në çorapen e parë, pjesën tjeterin në çorapen e dytë. Mbathi opingat e përsëri nisi të vinte poshtë e lart nëpër dhomëzën që mbante derë myk. Nuk vonoi shumë dhe nëpër korridori, dëgjuani hapa që po afroheshin.

«Erdhën!» — tha me vete.

Saq U hapi dera dhëni dhomëzën që mbante erë myk u derdh drita e zbetë e fenerit.

— Tundui laneti! Marsh përjashta! — tha xhandari, që mbante fenerin, kurse tjetri, që rrinte të dera, e kapi nga krahu dhe e nxori në korridor. Nëpër korridorin e ngushtë atë ecnin sup më sup, kurse nëpër shkallët e gjitej midis dy xhandarëve. Në katin e dytë, në korridorin që ndriçohej nga një llambë elektrike e mbërthyer në faqen në fund të korridorisë, thanëtë priste.

Nuk priti shumë së, nga dera që hapi xhandari, që mbante ende fenerin e ndezur në dorë, doli një burrë rja dy metra i gjatë e aq i gjerë, sa me shpatullat e tij puthiste plotësisht hapësirën midis dy aneve të derës.

— Hiu! — u qudit zdapi i gjatë që kishte dalë në dëre. — Po ky paška kenë glasë pulë, mor ty të marritë Mustafa të ligat!

Sezaiu e pa që nën vetullë atë burrë që kishte puthitur derën me shpatullat e tij e bëri cudi kur vranë mendjen të kuptonte se «si për gjithë atë binë burri të ishtë gjetur ai palo zë si zë cinxurri.»

— Po ti, c'më shikon ashtu, mor burri i dheut?! Ule, mör, atë koke, se po më shemb tavanin! — po

kësaj radhe Mustafa kishtë shtypur një akord tjetër e i doli një goxha zë si zë kaū! — Aaaä?! —  
thue se s'po më njef, a? — Po ti mos u mërzit, mofë  
burrë, se ja ta shpëtua rrëfen Mustafa ty. Po hyjmë  
mbrenda, po bajmë do dekika muhabet e ke më që  
bindë se s'më ka vu kota Naltmadhnia e tij! Tëpë  
këlysh magjypit! — Klithi Mustafai — psë nuk ridej  
rove, kur përmenda Naltmadhnine e tij? — Dhë e  
gëditi aq fort me i pëllëmbë, sa Sezainë nuk e  
mbajtë dot këmbët, po u përplas praptaz në dyshe  
menë prej cimentoje të korridorit. Mustafai iu vërt  
sul si i tërbuari, engriti për Jake me të dyja duart  
dhe i klithi edhe një herë: — Në Ndero! — Ndero!  
— Ndero! — ia mori dorën dhe ta çoi  
në gjoks. — Jashtu, pra, he burrë! — Dhë e shtyur  
brënda në dhomë.

Sezai u përplas me supin e majte në kanaten  
e derës dhe duke përplasur këmbët nëpër dyshe  
menë prej cimentoje, nga vrulli i shtytjes së Mus-  
tafës u gjendi në mës të dhomës, ballë përfshirë ballë me  
Faslinë.

Fasliu, me një xhüngë të bishti i jetullës dhe  
me mollëzën e injerës, laqet të njepur, mbështetur  
mbi dy këmbët të hapura pak anësh e menduari të  
kryqëzuara në gjoks po e shikonte me ca sytë,  
çakarritur nga inati.

— Anjifenja? — pyeti me një nërgeshje të  
shtitur Mustafa dhe shkoi ul mbi tryezën, e  
tij në këndin e dhomës. Tryza kërciti nëpër pe-  
shën e trupit të tij.

— Më ra me të pabesë, qeni! — e prishi i  
pari Fasliu heshtjen, që plakosi pas pyetjes së  
Mustafait.

— Po pse, mor kurban hasmi, ashtu godet bu-  
rri, a? Heu! Mbylle atë kamare e mos e gil pa lejën  
time, mor ta hangshin shtatëqind dreqën fenë tate!  
— i thirri Mustáfa Sezaiut, që u mat të fliste. —  
Ti vetë e ke pas fajin, — dhe, pasi ndau me noçkën  
e gishtit tregues verigat e mustaqeve kuqaloshe në  
të dyja anët e buzëve të holla, me një ton të butë  
e, èmbël-èmbël vazhdoi: — Po pse, more burra,  
a s'ka punë tjetër Msutáfa thoni ju, a, veç me da  
sherret tueja, a? Të bante vaki me u marrë Mustáfa:  
tanë kohën me kësi budallalliqesh, pasha të madhin  
zot, po e hajsha qyl fare bukën e Naltmadhnisë së  
tij. Ndero! Mos m'u mbaj njashtu si gjel gjiritit!  
Kopuk ferrash! C'kujojshe ti, se me vjedh ullinj  
asht punë e mirë, a? E Fasliu, që asht vu aty ta  
mam pér me ruejtë dembelët e hajdutët, do t'i tho-  
shte zotnisë sate: « — A, ke vjedhë ullinj, a? Ha-  
llall, të qofshin, mor burrë, se mall pa zot asht! » —  
këshfu a? — Ullinjtë i futi në korbë Fasliu.

— Heu!

— Gënjen, zoti Mustaf!

— Plaç tilë! Por paret, Fasliu t'i futi në xhep, a?  
— Paret ishin të miat! I kisha nxjerrë me  
djersë. Jo em qitxorda e oq asloq.

— M'i rrëmbeu!

— Mbylle atë zاغare ti, se, pasha të madhin  
zot, po e bén razi Mustafëni me t'i përkëdhelë ato  
mollaqe me do shkopinj të mirë!

— Këtu, ti! — i tha Sezaiut — a s'po na i  
kthen ato pare?

— Unë s'kam pare të tepërtë.

— Sa pare ishin, a?

— Dyzet e pesë lekë, zoti Mustaf, — u pér-  
gjegj Faslliu para Sezaiut.

— Ato ishin paret pér pesembëdhjetë ditë  
— punë.

— M'i jep, m'i jep mue paret!

— S'kam pare pér tē tē dhënë!

— Po ti mos m'u baj çun xanxar, mor burrë!  
Mustafa po tē lutet si birit tē vet. Ti, zoti mos e  
dhashtë, nuk do tē kesh ndonji dërrasë mangut,  
prandaj mos baj xanxa e zbrazu ashtu si i ka hije  
nji burri, tē ndershëm... A?... A?... Hala?... Hala  
s'po bindesh?.. Bukur boll, pér besë! — dhe u  
bëri shenjë dy xhandarëve.

— Sezaiu u mundua t'u shpëtonte krahëvet tē tyre,  
po qdo mundim i vajti kot, se ata e kishin mbër-i  
thyer mirë, kurse Fasliut, që u sul t'u ndihmonte,  
Mustafa iu hakërrua: — Jo! Atyrit! Mendon se s'asht e mjaftuesh-  
me forca e Mbretnisë me nënshtreue nji këlysh bush-  
tret? Marsh në vendin tat!

Sezainë e lidhën dhe pak e nga pak e zhveshën  
plotësisht. Si i gjetën paret, me një ndjenjë kre-  
narie pér aftësitë e tyre, duke buzëqeshur, shkuant  
pranë tryezës së Mustafait dhe i lëshuan mbi sypri-  
nën e saj.

Fasliu u nis t'i merrte, po vështrimi kërcë-  
nuas i Mustafës e bëri tē kthehej nga rruga.

— Ja, ashtu, he burrë! — i tha Mustafai, kur  
Fasliu u kthye në vendin e tij. Këto pare s'janë  
ma as tē këtij e as tuejat. Janë tē mbretnisë — dhe,  
duke i mbështjellë paret me shuplakën e dorës, i  
hodhi në sirtarin e tryezës së tij. Pastaj urdhëroi,  
duke dreituar shikimin nga Sezaiu: — Merreni

atë dhe i jepni bakshish njiqind shkopinj! Pesëdhjetë përrrahjën e pesëdhjetë përparet. . .  
Një gjysmë ore më vonë atë e nxorën nga dhomëza e përrahjës që mbante erë myk, e têrroqën zvarrë-zvarrë nëpër korridorin e ngushtë e tê errët si labirint tê xhandarmërisë dhe ashtu, tê humbur midis dhembjeve dhe gjakut, e përplasën në rrugë. . . Duke recurrrugës, Sezaiu përsëriste me vete, me grushtet e nofullat shtrënguar si i kërcisin dhëmbët: «Do tê hakmerrem! . . . Do tê hakmerrem!» Atij i bëhej edhe sikur dëgjonte zërin e vet tek buçiste sa dridhej edhe dheu: «Do tê hakmerrem!»

Në një cep rruge i dolën përpëra pa pandehur, si tê kishin mbirë nga dheu, Hysua dhe një shoku i tij pritur. U panë një sekondë sy më sy tê dy palët. Një sekondë qe, por që i thanë shumë shoshoqit. Hysua dhe shoku i tij e vunë në mës Sezainë, e kapën tê dy nga krahët dhe u panë sy më sv: «Do tê hakmerrem!»

Sosire e libri është bask e das bask e shveshpeni. Si i jetën bask me të shtëpëritë këto unës pëllishtë e tive, qëndre pustëdëshim, shikuan duke rrethës se Muzafatit dhe i fëmijëtët që përfunduan.

— — — — —  
Lezallin e lështë, që këtu është që mortati, që do të kthehet ne atë kthelje që iu ka  
Lëzallin e Muzafatit e përfundua është Këto basë e lështë — që  
Lëzallin e kthja është që vjenën e kthja. Këto basë e lështë — që  
që e as është kthja e as tjetria. Tashë që mprehet e — që  
që e as është kthja e as tjetria. Tashë që mprehet e — që  
që e as është kthja e as tjetria. Tashë që mprehet e — që  
që e as është kthja e as tjetria. Tashë që mprehet e — që  
që e as është kthja e as tjetria. Tashë që mprehet e — që  
që e as është kthja e as tjetria. Tashë që mprehet e — që  
që e as është kthja e as tjetria. Tashë që mprehet e — që

Redaktor: MOISI ZALOSHNA

Kopertina nga: ROLAND KARANXHA

Tirazhi 4.000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

---

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike

Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1974